

Fjala e Guvernatorit.

Ekonomia shqiptare në dhjetëvjeçarin e parë të tranzicionit ka shfaqur zhvillime që kanë marrë formën e një cikli. Zbalancimet makroekonomike të viteve '91-92 e '97 janë pasuar me përpjekje për reforma dhe për rivendosjen e ekuilibrave. Si rrjedhojë e zbatimit të këtyre programeve të stabilizimit ekonomia shqiptare ka njohur ritme relativisht të larta zhvillimi, reduktim të deficitit buxhetor dhe qëndrueshmëri në çmime. Inflacioni mesatar vjetor për periudhën '98-02 prej 3.5 është ndjeshëm më i ulët sesa inflacioni mesatar vjetor i vendeve të Europës Lindore e Qendrore.

I. Ekonomia shqiptare në vitin 2002.

I.1. Zhvillimet në prodhim.

Ritmet e rritjes së ekonomisë shqiptare në periudhën 1998-2002 konsiderohen të larta. Megjithatë, ato kanë shfaqur një tendencë rënëse përgjatë gjithë periudhës. Banka e Shqipërisë vlerëson se ngadalësimi i normës së rritjes së ekonomisë është pasojë e:

- kryerjes jo të plotë të reformave strukturore;
- nivelit të ulët të investimeve të huaja;
- konjunkturave të pafavorshme ndërkombëtare pas ngjarjeve të 11 shtatorit 2001;
- qetësimit disi të aktivitetit ekonomik pas rritjes mjaft të lartë në vitet '98-'99.

Rritja ekonomike në Shqipëri për vitin 2002, prej 4.7 për qind, rrjedhojë e zgjerimit të sektorit privat, u mbështet kryesisht nga aktiviteti në degët e transportit, të shërbimeve dhe të ndërtimit. Sektori publik po tkurret vazhdimisht.

Megjithatë, rritja ekonomike e vitit 2002 është më e ulëta në krahasim me periudhën 1998-2002 dhe me devijim 1.3 pikë përqindjeje prej synimit të shpallur në fillim të vitit (6 për qind). Pothuaj të gjitha degët e ekonomisë kanë manifestuar ritme rritjeje më të ulëta se parashikimi, sidomos bujqësia dhe industria. Struktura e ekonomisë shqiptare, gjithashtu, po ndryshon. Është zbehur pesha e bujqësisë dhe e blegtorisë, sektorë të cilët tradicionalisht kanë mbështetur zhvillimin ekonomik, dhe po rritet kontributi i degës së tregtisë dhe të shërbimeve. Këto ndryshime strukturore janë në harmoni me zhvillimin që duhet të marrë një vend, i cili ka për objektiv integrimin në Bashkimin Europian, por vërehet që ende nuk ka rol të rëndësishëm dega e industrisë. Për të mbështetur rritje të qëndrueshme afatgjatë të ekonomisë, mendojmë se ka rëndësi që autoritetet qeveritare të shohin me përparësi nxitjen e prodhimit industrial.

Prodhimi bujqësor për vitin 2002 u rrit me 2.1 për qind. Prej kohësh bujqësia nuk kontribuon më me 50 për qind në ekonominë e vendit, por ndjeshëm më pak. Duket se ritmi i rritjes së kësaj dege nuk mund të mbështetet vetëm në

aspektin ekstensiv të saj. Është e nevojshme që në këtë sektor të bëhen rregullime, të cilat do të çojnë në rritje të produktivitetit. Problemet në bujqësi kanë të bëjnë me: copëzimin e tokës dhe me konfliktet lidhur me pronësinë mbi të, gjë që nuk lejon investimet afatgjata në këtë sektor; mungesën e investimeve në teknologji; infrastrukturën e pazhvilluar rurale dhe disnivelet e konsiderueshme nga një rajon i vendit në një tjetër; aftësitë e kufizuara konservuese të produkteve bujqësore dhe blegtorale; si dhe mbështetjen jo të mjaftueshme me financime të këtij sektori. Përveç këtyre problemeve, sektori i bujqësisë vuajti edhe nga përmbytjet e vjeshtës të vitit 2002. Në këtë sektor, zhvillimi disi më i mirë i blegtorisë dhe i agroindustrialisë po kompenson problemet e degës së bujqësisë.

Prodhimi industrial për vitin 2002 u rrit me 2 për qind duke patur ritmin më të ulët të rritjes në krahasim me degët e tjera. Industria, më shumë se çdo degë tjetër, ka vuajtur problemet me energjinë elektrike, të cilat janë të pranishme prej të paktën tre vjetësh. Tashmë është e qartë për të gjithë, që zgjidhja e këtij problemi është jetike për zhvillimin e vendit. Por, më duhet të theksoj që situata është edhe më shqetësuese. Nga vrojtimet që Banka e Shqipërisë ka bërë periodikisht pranë bizneseve të degës së industrisë, është theksuar se situata energjitike e vendit ka çuar në zbehje të optimizmit të zhvillimit të bizneseve për të ardhmen, që do të thotë se mund të vihet në rrezik qëndrueshmëria e rritjes ekonomike.

Dega e transportit vlerësohet të jetë rritur me 10.1 për qind duke patur ritmin më të lartë të rritjes në krahasim me degët e tjera. Ndoshta, ky sektor do të ishte rritur sa parashikimi prej 11 për qind, nëse gjatë vitit 2002, do të ishin realizuar në nivel më të mirë investimet. Investimet janë realizuar në masën 79.4 për qind të atyre të planifikuara dhe kryesisht si pasojë e intensifikimit të tyre në tremujorin e fundit të vitit.

Dega e ndërtimit vazhdon të ruajë ritme të larta rritjeje. Për vitin 2002 vlerësohet që prodhimi i kësaj dege të jetë rritur me 9.1 për qind. Megjithatë, ndërtimi po shfaq një tendencë ngadalësimi në zgjerimin e aktivitetit. Kjo është një prirje e natyrshme si pasojë e ndërtimeve të reja të shumta në 10 vitet e kaluara dhe e plotësimit të kërkesave. Por, në periudhë afatshkurtër do të ndikojnë edhe përpjekjet për formalizimin e aktivitetit të ndërtimit.

Në tërësi, rritja më e ulët ekonomike për vitin 2002 ka qenë pasojë edhe e një niveli më të ulët të investimeve të huaja dhe e tkurrjes së shpenzimeve kapitale, por edhe e zhvillimeve politike të cilat u shoqëruan me ndryshime disi të shpeshta në qeveri. Investimet e huaja direkte kanë rënë me 31 për qind në krahasim me vitin 2001. Duke patur parasysh që situata politike dhe makroekonomike e vendit është e ngjashme me atë të një viti më parë, rënia e investimeve të huaja i dedikohet mungesës të privatizimeve të objekteve strategjike, sidomos Bankës së Kursimeve dhe Albtelekomit. Nga ana tjetër, shpenzimet kapitale janë realizuar në nivele më të ulëta. Konkretisht, në vitin 2002 u kryen rreth 73 për qind e shpenzimeve kapitale të planifikuara, kundrejt 96 për qind një vit më parë. Shpenzimet kapitale faktike për vitin 2002 janë ulur me 13.8 për qind krahasuar me vitin e kaluar.

Në fund të vitit 2002 numri i të punësuarve arriti në 921 mijë vetë. Në përputhje me zhvillimin e ekonomisë dhe me ndryshimin strukturor të saj ka ndryshuar edhe struktura e punësimit në vend. Kështu, të punësuarit në sektorin bujqësor përbëjnë 57 për qind të të punësuarve gjithsej nga 71.5 për qind një vit më parë. Lëvizjet drejt qyteteve si dhe zgjerimi i sektorit privat kanë thithur pjesë të konsiderueshme të kësaj fuqie punëtore. Kështu, punësimi në sektorin privat jobujqësor zë rreth 23 për qind të punësimit gjithsej nga 11 për qind një vit më parë. Megjithatë, Shqipëria ende ka një normë të lartë papunësie prej 15.8 për qind. Zgjerimi i aktivitetit privat dhe investimet publike ende nuk janë në ritme të tilla që të gjenerojnë vende të mjaftueshme pune.

Sidoqoftë, fakti që ekonomia shqiptare ka siguruar rritje ekonomike për të pestin vit rradhazi, ka bërë që të ardhurat për frymë po ashtu të rriten. Për vitin 2002, të ardhurat për frymë të llogaritura si PBB e shprehur në dollarë, në raport me popullsinë e vendit vlerësohen mesatarisht 1500 dollarë amerikanë. Megjithëse ky nivel të ardhurash mbetet ndër më të ulët të rajonit, përsëri mund të themi që zbatimi i Strategjisë për Zhvillim Ekonomik dhe Social po jep efekte. Dërgesat e emigrantëve vazhdojnë të jenë një burim i rëndësishëm të ardhurash për familjet shqiptare. Për vitin 2002 ato kanë arritur në 606.8 milionë dollarë duke siguruar mbulimin prej 52.5 për qind të deficitit tregtar.

Ecuria e ekonomisë shqiptare në vitin 2002 ka pasqyruar edhe ndikimin e ngadalësimit të përgjithshëm të rritjes së ekonomisë botërore, sidomos të problemeve që kanë shoqëruar ekonominë e rajonit dhe të partnerëve kryesorë tregtarë.

1.2. Zhvillimet në sektorin e jashtëm të ekonomisë dhe në kursin e këmbimit.

Konkurrueshmëria e ekonomisë shqiptare si në tregun e vendit ashtu edhe në atë të huaj është ende e ulët. Deficiti tregtar ka ardhur në rritje në tre vitet e fundit. Për vitin 2002, deficiti tregtar rezulton sa 24.6 për qind e PBB-së. Thellimi i deficitit tregtar është pasojë e rritjes më të lartë të importeve krahasuar me eksportet.

Vëllimi i eksporteve shqiptare u rrit në 330.2 milionë usd. Rieksportet zënë peshën kryesore të eksporteve shqiptare, prej 74 për qind, ndërsa eksportet nga prodhimi i brendshëm mbeten në nivele të ulëta. Eksportet shqiptare janë të kufizuara në prodhim lënde të parë si pasojë e moszgjerimit të kapaciteteve përpunuese në vend. Në këtë mënyrë, eksportet nga prodhimi i vendit nuk kanë mundur të shoqërohen me zgjerim investimesh dhe me krijim vendesh të reja pune. Përsa i përket rieksporteve, duket që ato kontribuojnë disi në punësim duke shfrytëzuar krahun relativisht të lirë të fuqisë punëtore në Shqipëri. Ky aktivitet përfaqëson edhe investimet më të rëndësishme prej dy shteteve fqinje: Italisë dhe Greqisë, në Shqipëri. Megjithatë, mbetet ende e paqartë nëse të tilla investime janë shoqëruar me investime në teknologji të përparuar gjë që do të shërbente si premisë për të rritur produktivitetin.

Vëllimi i importeve shqiptare arriti në 1.5 miliardë usd. Importet përfshijnë si mallra të konsumit ashtu edhe makineri e pajisje. Importi i makinerive e pajisjeve përbën rreth 16 për qind të importeve ose rreth 5 për qind të PBB-së. Tërthorazi ky tregues na orienton se ka patur rritje të investimeve private.

Deficiti korent u përkeqësua, duke regjistruar nivelin 9.5 për qind të PBB-së nga 6.1 për qind një vit më parë. Përkeqësimi i deficitit korent erdhi si pasojë e thellimit të deficitit tregtar. Financimi i llogarisë korente është mundësuar kryesisht nga të ardhurat e emigrantëve si dhe nga aktiviteti i turizmit. Deficiti korent, i cili shënon nivelin 447.6 milionë usd është financuar nga flukset hyrëse të kapitalit në masën 75 për qind. Peshën kryesore në financimin e tij e zënë investimet e huaja direkte (143 milionë usd) dhe borxhi i jashtëm (142.7 milionë usd).

Zhvillimet jo shumë të favorshme në sektorin e jashtëm të ekonomisë përsëri nuk kanë ushtruar presione të forta për nënçmimin e monedhës së vendit. Gjatë vitit 2002, kursi i këmbimit të lekut ndaj valutave kryesore ka ndjekur kryesisht prirjet sezonale të faktura edhe në vitet e mëparshme, si edhe ecurinë e valutave kryesore në tregun ndërkombëtar të këmbimit. Krahasuar me një vit më parë mesatarisht leku u nënçmua me 3.03 pikë përqindjeje në raport me euron dhe u mbiçmua 2.32 pikë përqindjeje në raport me dollarin amerikan. Si faktor i rëndësishëm për nënçmimin e lekut konsiderohet paniku bankar i periudhës mars-prill, që u shoqërua me lëkundje besimi në monedhën vendase dhe rritje të parasë në qarkullim. Por, janë zhvillimet në tregjet ndërkombëtare ato të cilat përcaktojnë lëvizjen e monedhës së vendit. Ecuria e kursit euro/usd në tregun ndërkombëtar përcaktoi edhe nënçmimin e lekut kundrejt euros.

Në varësi nga këto zhvillime, gjatë vitit 2002, Banka e Shqipërisë ka ndërhyrë në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore, në dy periudha: mars-prill-maj dhe dhjetor. Kahu i ndërhyrjes ka qenë i ndryshëm për të dyja periudhat. Në periudhën e parë janë shitur gjithsej 4.94 milionë dollarë amerikanë, me një nivel mesatar të kursit të këmbimit prej 145.02 lekësh, si edhe 0.4 milionë euro me një nivel mesatar të kursit të këmbimit prej 131.4 lekësh. Në muajin dhjetor, janë blerë 1.8 milionë dollarë amerikanë me një nivel mesatar të kursit të këmbimit prej 133.74 lekësh dhe 0.2 milionë euro me një nivel mesatar të kursit të këmbimit prej 136.2 lekësh.

II. Inflacioni dhe politika monetare.

Norma vjetore e inflacionit për fundin e vitit 2002 arriti në 2.1 për qind. *Zhvillimet në çmimet e konsumit* gjatë vitit 2002, shfaqën një tendencë të ndryshme nga një vit më parë. Nëse në vitin 2001 inflacioni mbeti në nivele relativisht të ulëta dhe brenda objektivit, presionet për inflacion më të lartë u rritën në dy muajt e fundit të tij, duke bërë që norma e inflacionit në fund të vitit të arrinte 3.5 për qind. Viti 2002 filloi me norma të larta inflacioni, gati sa dyfishi i kufirit të sipërm të objektivit. Normat më të larta se objektivi ishin të pranishme pothuaj gjatë gjithë vitit dhe u ulën ndjeshëm në dy muajt e fundit të tij. Në përgjithësi, inflacioni për periudhën afatmesme ka shfaqur një

tendencë rritëse. Norma mesatare vjetore e inflacionit është rritur nga 0.4 dhe 0.1 për qind në vitet 1999 dhe 2000, në 3.1 dhe 5.4 për qind përkatësisht në vitet 2001 dhe 2002 ai pasojë e një ambienti ekonomik më inflacionist gjatë vitit 2002.

Në vitin 2002 kanë vepruar një sërë faktorësh të cilët kanë diktuar zhvillimet në çmimet e konsumit. Këta faktorë kanë vepruar në të dy krahët: të kërkesës dhe të ofertës. Veprimi në raporte të caktuara i këtyre faktorëve si dhe fakti që faktorët e kahut të kërkesës vepruan në vijim të njëri-tjetrit duke dhënë ndikime më afatgjata bënë që Banka e Shqipërisë të reagonte me maturi.

Ndër faktorët më të rëndësishëm që vepruan në ecurinë e inflacionit mund të përmenden:

- rritja e parasë jashtë bankave tej parashikimeve në periudha të caktuara të vitit dhe rritja e peshës së agregatit më likuid, M1 në ofertën monetare, në gjysmën e parë të vitit;
- nënçmimi i monedhës së vendit, gjithashtu në gjysmën e parë të vitit;
- rritja e çmimeve të produkteve ushqimore në tregjet prej nga importon Shqipëria dhe një inflacion më i lartë se objektivi në Eurozonë;
- rritja e çmimit të energjisë elektrike në dhjetor të vitit 2001, e cila u mbart në çmimet e mallrave të konsumit, sidomos në gjysmën e parë të vitit. Gjithashtu, situata energjitike e pastabilizuar veproi si një faktor i rëndësishëm për çmime më të larta;
- kushtet klimaterike, si moti i ftohtë i fillimvitit dhe përmbytjet e vjeshtës, ndikuan më tepër rritjen e çmimeve të transportit dhe për rrjedhojë të produkteve ushqimore;
- rritja spekulative e çmimeve, sidomos në prag të festave të fundvitit.

Megjenëse intensiteti i veprimit të këtyre faktorëve ishte më i fuqishëm në gjysmën e parë të vitit atëherë edhe normat e inflacionit rezultuan më të larta në këtë periudhë dhe erdhën duke u zbutur më pas. Në reduktimin e inflacionit ndikuan edhe kujdesi në kryerjen e shpenzimeve buxhetore, reduktimet e çmimeve në grupin “komunikim”, si pasojë e gjallërimit të shërbimit të telefonisë celulare në Shqipëri si dhe fushata që vetë Banka e Shqipërisë ndërmori në fund të vitit, për të zbutur fenomenin e spekulimit me çmimet.

Politika monetare e ndjekur nga Banka e Shqipërisë në vitin 2002, gjithashtu ishte disi e ndryshme krahasuar me vitet '98-00. Në përgjithësi, politika monetare e zbatuar në vitet e fundit ka patur karakter zbutës. Në vitin 2001, në përgjigje të presioneve për inflacion më të lartë, politika monetare ishte neutrale, ndërsa në vitin 2002 kaloi në politikë shtrënguese në pjesën më të madhe të vitit. Jo vetëm kaq, por në ndryshim nga historia dhjetëvjeçare e veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë, për rreth tre muaj iu dha prioritet ruajtjes së qëndrueshmërisë së sistemit bankar. Me këtë vendim, Banka e Shqipërisë shmangu përhapjen e panikut bankar dhe shtrirjen e tij për një periudhë kohe më të gjatë. Ruajtja e qëndrueshmërisë së sistemit bankar, megjithëse në pamje të parë duket sikur kërcënoi arritjen e objektivit të inflacionit, në fakt i shërben qëndrueshmërisë afatgjatë të çmimeve. Zhvillimet

deri në fund të vitit 2002 provuan se Banka e Shqipërisë mori vendimet e duhura.

Në tërësi, politika monetare në vitin 2002 ka qenë politikë e shtrënguar në përgjigje të presioneve për norma më të larta inflacioni. Por, ajo nuk ka qenë njëtrajtësisht e shtrënguar gjatë gjithë vitit. Në përputhje me ecurinë e inflacionit dhe të zhvillimeve monetare, politika monetare e Bankës së Shqipërisë gjatë vitit 2002 mund të ndahet në tre periudha:

- ***Në muajt janar-shkurt u ndoq një politikë monetare neutrale.***

Normat e larta të inflacionit në fillim të vitit 2002, të ndikuara nga faktorë të kahut të ofertës nuk bënë të nevojshme rritjen e normës së interesit. Në tërësi, treguesit monetarë u përmirësuan dhe likuiditeti pati një kthim të shpejtë në sistem. Banka e Shqipërisë tërhoqi likuiditetin e tepërt nëpërmjet ankandëve të repos. Ajo nuk financoi deficitin buxhetor. Normat e interesit kanë qenë përgjithësisht të qëndrueshme.

- ***Në muajt mars-shtator u ndoq një politikë monetare shtrënguese.***

Tërheqja e depozitave nga dy bankat më të mëdha të sistemit bankar shqiptar, që filloi në mes të muajit mars 2002, ndryshoi rrjedhën e zhvillimeve monetare dhe krijoi presione shtesë për inflacionin. Përhapja e panikut ishte një fenomen i paparashikuar. Të paktën ajo nuk u shkaktua prej situatës së sistemit bankar. Bankat në Shqipëri, megjithë disa probleme që shfaqin, të cilat mbikëqyren prej Bankës së Shqipërisë, por i bëhen të njohura edhe publikut nëpërmjet deklaratës së kërcënimit për sistemin financiar, paraqisnin situatë të shëndoshë financiare. Sistemi bankar shqiptar nga viti në vit ka ardhur duke u konsoliduar. Pra, paniku nuk mund të kishte nxitje apo bazë në situatën e sistemit bankar. Paniku u vlerësua se u shkaktua prej acarimit të situatës politike në atë periudhë, keqinterpretimit të ligjit “Për sigurimin e depozitave” si dhe informimit të pamjaftueshëm të depozituesve. Për pasojë, nga sistemi bankar u tërhoqën 23.4 miliardë lekë depozita, 73 për qind e të cilave përfaqësonin tërheqjen e depozitave në lekë. Këto tërheqje përfaqësonin 8.3 për qind të depozitave të vendosura në sistemin bankar shqiptar. Tërheqja e depozitave krijoi vështirësi për likuiditetin afatshkurtër të bankave dhe për financimin e deficitit buxhetor nëpërmjet tregut primar të bonove të thesarit. Kjo vështirësi u rëndua edhe më tepër në kushtet kur u bë e qartë se procesi i privatizimit në vitin 2002 nuk do të ecte me ritmet e parashikuara. Treguesit monetarë devijuan prej programit. Paraja jashtë bankave në këtë periudhë u rrit me 16.4 miliardë lekë. Vetëm në muajin prill norma vjetore e rritjes së këtij treguesi ishte 35.6 për qind, që është norma më e lartë e rritjes gjatë pesë viteve të fundit. Nga ana tjetër, leku u nënçmua kundrejt dy valutave kryesore dhe njëkohësisht u forcuan presionet për rritjen e inflacionit. Për pasojë, sistemi bankar kaloi në mungesë likuiditeti nga pozicioni me tepëri prej 1.6 miliardë lekësh në muajin shkurt.

Strategjia e Bankës së Shqipërisë për të kapërcyer situatën konsistoi në:

- lejimin e devijimit prej programit monetar dhe plotësimin e nevojave të bankave me likuiditet. Duke injektuar likuiditetin e nevojshëm në treg

bankat patën mundësi të plotësonin kërkesat për tërheqje të depozituesve dhe në këtë mënyrë kjo shërbeu si masë për të frenuar përhapjen e panikut. Përveç kësaj, duke patur likuiditet bankat vepruan normalisht në tregun primar të bonove të thesarit;

- financimin e Qeverisë për të siguruar vijueshmëri normale të shpenzimeve. Por, duke qenë se presionet për inflacion ishin forcuar, Banka e Shqipërisë kërkoi dhe gjeti mirëkuptimin e Qeverisë Shqiptare për të qenë maksimalisht e kujdesshme në kryerjen e shpenzimeve. Objektivat sasiorë fiskalë u respektuan rigorozisht. Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë mori vendimin që Qeveria të financohej deri në 8 për qind të të ardhurave mesatare buxhetore për tre vitet e fundit. Por, përmirësimi i situatës më shpejt sesa pritej nuk e bëri të nevojshëm këtë zbatimin e kësaj mase;
- rritjen e normës bazë të interesit me 1.5 pikë përqindjeje për të nxitur rritjen e normave të interesit për depozitat. Kjo masë siguroi fitime reale më të larta për depozituesit dhe i nxiti ata për të kthyer paratë në banka. Përveç kësaj, u synua thellimi i diferencës me interesat në valutë me qëllim që të ushtrohej presion për të mos lejuar nënçmimin e lekut;
- sqarimin e publikut për gjendjen reale të sistemit bankar si dhe efektet dhe dobitë e ligjit “Për sigurimin e depozitave” me qëllim që të zbutej efekti psikologjik negativ që u krijua.

Masat e marra siguruan shuarjen e tërheqjes së depozitave në fund të qershorit 2002 dhe rekuperimin e plotë të situatës brenda vitit 2002.

- ***Në muajt tetor – dhjetor u ndoq një politikë monetare neutrale.***

Duke marrë parasysh kthimin e likuiditetit në sistem, i cili solli një përmirësim të kushteve monetare, një qëndrueshmëri relative në normat e interesit dhe zbutjen e presioneve inflacioniste, Banka e Shqipërisë ka zbatuar një politikë monetare të kujdesshme, me tendencë zbutëse, në dy muajt e fundit të vitit. Në muajin nëntor, ajo adoptoi një qëndrim neutral ndaj normave të interesit. Në muajin dhjetor, karakteri neutral i qëndrimit të politikës monetare u përforcua më tej me ndryshimin e formës së ankandit, nga ankand me shumë të përcaktuar në ankand me shumë të papërcaktuar dhe me normë interesi fikse. Ky ndryshim përfaqëson një ulje të ndjeshme në koston e huamarrjes së bankave.

Për pasojë, objektivat sasiorë të detyrueshëm për zbatim nga Banka e Shqipërisë u respektuan. Mjetet e brendshme neto rezultuan 7.97 miliardë lekë më pak se objektivi i sipërm i tyre; mjetet valutore neto rezultuan 3.55 milionë dollarë më shumë se kufiri i poshtëm objektiv. Në përputhje me regjimin aktual të politikës monetare, Banka e Shqipërisë synon kontrollin e likuiditetit në ekonomi, duke e parë atë të lidhur ngushtë me nivelin e çmimeve. Gjendja e likuiditetit dhe e treguesve monetarë në ekonomi kontrollohet nëpërmjet respektimit të këtyre objektivave sasiorë.

III. Financat publike.

Ecuria e treguesve të buxhetit për vitin 2002 u kushtëzua nga mungesa e të ardhurave të privatizimit; nga tërheqjet e depozitave si dhe nga ulja e parashikimit për rritjen ekonomike gjë që do të thoshte më pak të ardhura për buxhetin. Prandaj, për të ruajtur ekuilibrin e këtyre treguesve dhe për të respektuar objektivat sasiorë, u veprua me një kontroll rigoroz në kryerjen e shpenzimeve.

Deficiti buxhetor arriti 6.2 për qind ndaj PBB-së ose 2.4 pikë përqindjeje më i ulët se një vit më parë. Konsolidimi i financave të Shtetit Shqiptar ka rezultuar në përvijimin e një tendence të pastër të reduktimit të deficitit buxhetor për periudhën 1999-2002.

Reduktimi i deficitit buxhetor u sigurua prej rritjes së të ardhurave me ritëm më të lartë se shpenzimet. Të ardhurat buxhetore u rritën me 11.4 për qind krahasuar me një vit më parë. Megjithatë, niveli i planifikuar u realizua në masën 95 për qind. Shpenzimet u rritën me 3.2 për qind krahasuar me një vit më parë dhe niveli i realizimit të planit ishte 90 për qind.

Niveli i realizimit të planit të të ardhurave buxhetore është ndikuar prej realizimeve në masën 92 e 91 për qind të planit të të ardhurave tatimore dhe doganore. Niveli i realizimit të të ardhurave buxhetore është e qartë që mbetet ende i ndikuar negativisht nga evazoni fiskal, nga niveli i korrupsionit dhe i kontrabandës në vend. Për këtë arsye, forcimi i masave kundër këtyre fenomeneve është i lidhur drejtpërdrejt me përmirësimin e pozicionit fiskal.

Përsa i përket shpenzimeve, vërehet që shpenzimet kapitale janë realizuar në masën 73 për qind ndërkohë që shpenzimet korente zunë 81 për qind të shpenzimeve gjithsej, nga 74.6 për qind që ishte parashikuar.

Viti 2002, gjithashtu, nuk i shpëtoi dot fenomenit të zakonshëm të përqendrimit të shpenzimeve në muajin dhjetor. Niveli i shpenzimeve të muajit dhjetor tejkaloi planin buxhetor. Të paktën prej vitit 1997 po ruhet e njëjta situatë gjë që bën të nevojshëm shtimin e vëmendjes në harmonizimin e ritmit të shpenzimeve.

IV. Zhvillimet në sistemin bankar.

Gjendja e sistemit bankar shqiptar për vitin 2002 vlerësohet e shëndetshme. Aktiviteti i sistemit bankar është zgjeruar me rreth 21 miliardë lekë ose 3.4 për qind në terma realë. Fitimi i rezultuar është 3.9 miliardë lekë. Pozicioni i kapitalit është forcuar më tej dhe norma e mjaftueshmërisë së kapitalit ka arritur në 31.5 nga 12 për qind që është norma minimale e lejuar.

Sistemi bankar shqiptar është zgjeruar me subjekte të reja dhe ka shtrirë më tej rrjetin e tij. Në vitin 2002 iu dha licenca Bankës së Kreditit të Shqipërisë. Aktualisht, veprojnë 14 banka tregtare, të cilat e zgjeruan rrjetin e tyre me 9

degë dhe 1 agjenci të reja. Përveç bankave, po krijohen dhe licencohen edhe subjekte të reja financiare, të cilat do të ndikojnë në zhvillimin e sistemit financiar në Shqipëri dhe do të çojnë në reduktimin e peshës së sistemit bankar në të. Kështu, në vitin 2002 janë licencuar 1 subjekt financiar jobankë; 20 zyra këmbimi valutor; 113 shoqëri të kursim-kreditit dhe 2 unione të këtyre shoqërive.

Rritja e numrit të subjekteve financiare dhe zgjerimi i aktivitetit të tyre do të rrisë shkallën e ndërmjetësimit financiar në Shqipëri. Megjithë zhvillimet pozitive në vitet e fundit, përsëri ndërmjetësimi financiar është në nivele të ulëta, madje më të ulëta sesa rajoni. Raporti i depozitave me afat është rreth 40.1 për qind të PBB-së nga rreth 50 për qind që është niveli mesatar për vendet e Europës Lindore e Qendrore. Ndërkohë, kredia e brendshme është rreth 35.1 për qind e PBB-së, por kredia për ekonominë është vetëm 7.2 për qind nga rreth 40 për qind mesatarisht në vendet e Europës Lindore dhe Qendrore. Diferenca midis treguesit të kredisë së brendshme dhe kredisë për ekonominë, përfaqëson kreditimin e sektorit bankar për Qeverinë. Kërkesa ende e lartë në raport me nivelet e vendeve më të zhvilluara, e Qeverisë Shqiptare për të financuar deficitin buxhetor mban disi të deformuar dhe aktivitetin kreditues. Megjithatë, zhvillimet në vitet e fundit kanë qenë pozitive. Reduktimi i vazhdueshëm i deficitit buxhetor ka rritur mundësinë e bankave për të kredituar ekonominë. Raportet e kredisë së brendshme dhe të kredisë për ekonominë ndaj PBB-së një vit më parë kanë qenë 45 dhe 4.6 për qind përkatësisht.

Pozitiv është fakti që zgjerimi i aktivitetit bankar është pasojë e një aktiviteti më intensiv të bankave private dhe të atyre me kapital të përbashkët. Në këtë mënyrë, po krijohen premisa edhe për reduktimin e vazhdueshëm të pozicionit dominues të Bankës së Kursimeve.

Megjithatë, në krahasim me një vit më parë, ritmet e zgjerimit të aktivitetit bankar dhe treguesit e rentabilitetit kanë një përkeqësim të lehtë. Të ardhurat neto të shprehura në raport me aktivet mesatare dhe fondet e veta të bankave, për vitin 2002, kanë rezultuar 1.2 dhe 19.1 për qind nga 1.5 dhe 21.6 për qind që ishin një vit më parë. Kjo situatë pasqyron ndikimin që pati në sistemin bankar paniku i shkaktuar në muajt mars – prill të vitit 2002. Për pasojë, Banka e Shqipërisë konkludon që sistemi bankar është i shëndoshë, por qëndrueshmëria e tij mbetet ende e brishtë.

Me ritme të kënaqshme është zhvilluar *aktiviteti i kreditimit të bankave* për ekonominë e vendit. Kredia e re e lëvruar nga bankat ka qenë 62.6 miliardë lekë nga 40.6 miliardë lekë në vitin 2001. Teprica e kredisë për sistemin bankar, në fund të vitit 2002, rezulton 47.4 miliardë lekë ose 16.6 për qind e depozitave të këtij sistemi. Në tërësi, treguesit e kredisë janë përmirësuar. Në periudhën 1993-2000 sistemi bankar ka dhënë kredi në masën 79.5 miliardë lekë. Për vitet 2001-2002, kredia e re e dhënë arrin në 103.2 miliardë lekë. Kjo do të thotë që kreditimi mesatar vjetor për këto dy vite është rreth 5 herë më shumë sesa për periudhën 1993-2000. Zgjerimi i rrjetit të bankave dhe i aktivitetit të tyre na bën të jemi optimistë për rritjen e kreditimit në të ardhmen.

Përveç bankave, zgjerimi i skemave të mikrokredive dhe institucioneve financiare jobankare është një tjetër zhvillim i dobishëm, i cili do të çojë në rritje të kreditimit të ekonomisë. Vlerësohet se prej këtyre institucioneve janë dhënë rreth 4 miliardë lekë kredi gjatë vitit 2002. Skemat e mikrokredive kanë përparësinë se shtrihen edhe në zona ku nuk ka degë bankash, sidomos në zonat rurale të vendit si dhe krijojnë mundësi kreditimi për biznesin e vogël. Këto janë dhe arsytet që në tërësi vlerësohet se kreditimi joformal po vjen duke u tkurrur.

Kredia e dhënë nga sistemi bankar edhe në vitin 2002 ka ruajtur karakteristikat e saj strukturore. Kështu, ajo është 67 për qind në valutë; 100 për qind për sektorin privat dhe 71 për qind afatshkurtër. Përveç kësaj sektori i tregtisë vazhdon të jetë i preferuar në kreditim.

Aktiviteti kreditues i bankave, pavarësisht nga përshpejtimi në vitet e fundit, nuk është shoqëruar me përkeqësim të cilësisë së portofolit të kredive. Kreditë me probleme përfaqësojnë 5.6 për qind të portofolit të kredive nga 6.9 për qind që ishte ky tregues një vit më parë. Gjithashtu, struktura e kredive me probleme nuk ka pësuar ndryshime duke mos shfaqur shqetësime për rritje të kategorisë me rrezik më të lartë, që është kategoria e huave të klasifikuara si të humbura.

V. Mbikëqyrja bankare.

Funksioni i mbikëqyrjes bankare përbën shtyllën e dytë të rëndësishme të veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë. Misioni i Bankës së Shqipërisë si autoritet rregullator është:

- të sigurojë qëndrueshmërinë e sistemit bankar dhe të mbrojë interesat e depozituesve dhe të publikut të gjerë;
- të sigurojë një sistem bankar të shëndoshë, aktiviteti i të cilit të jetë transparent dhe i udhëhequr drejt ekonomisë së tregut;
- të rrisë besimin e investuesve dhe të depozituesve nëpërmjet mbështetjes së zhvillimit të industrisë bankare dhe efikasitetit të saj.

Objektivi kryesor strategjik është ai i shpallur nga Komiteti i BIS Bazelit për mbikëqyrjen bankare: ***“Asnjë njësi të mos i shpëtojë mbikëqyrjes dhe mbikëqyrja të jetë e mjaftueshme”*** si dhe respektimi i 25 parimeve bazë të këtij Komiteti për mbikëqyrje bankare të kujdesshme.

Aktiviteti i mbikëqyrjes bankare, në vitin 2002, është përqendruar në plotësimin dhe rishikimin e kuadrit rregullativ, në analizimin dhe në inspektimin e aktivitetit të bankave dhe të subjekteve të tjera që mbikëqyren prej Bankës së Shqipërisë. Në kuadrin rregullator u hartuan një sërë rregullash të reja, të cilat synojnë të mos lënë jashtë mbikëqyrjes aktivitete të subjekteve të caktuara.

Gjatë vitit 2002 u realizuan 13 inspektime të plota dhe 11 të pjesshme dhe u vu re se:

- Zgjerimi i aktivitetit kreditues është shoqëruar me një përmirësim të portofolit të kredisë, ndonëse evidentohen akoma disa mangësi si: fillimi i aktivitetit kreditues pa siguruar më parë një ekip të përgatitur; mosmbështetja në politika dhe procedura të plota dhe të sakta.
- Është rikthyer besimi i publikut në sistemin bankar pas panikut që mbizotëroi në muajt mars – prill 2002.
- Drejtimi i lartë i bankave, në përgjithësi, ka reaguar pozitivisht ndaj problemeve të ngritura në ekzaminimet e kryera, por nuk ka treguar kujdesin e duhur për: përmirësimin e politikave dhe të procedurave të aktivitetit të bankës; plotësimin e kuadrit rregullativ të aktivitetit të bankës; zbatimin e planbiznesit të bankës.

Gjatë inspektimeve të kryera janë konstatuar shkelje të natyrave të ndryshme. Në tërësi, këto shkelje janë vlerësuar jo të rëndësishme dhe me pasoja jo të rënda për bankat. Në varësi të shkeljeve të evidentuara, janë përcaktuar masat korrektuese ose ndëshkimore, mbështetur në dispozitat e ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe në aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë si: rekomandime apo sugjerime për të korrigjuar parregullsitë e vogla; kërkesa për të paraqitur në Bankën e Shqipërisë një program masash për rregullimin e gjendjes së bankës, në rast të ndeshjes së parregullsive, duke përcaktuar edhe afatet përkatëse; masa ndëshkuese ndaj administratorëve që kanë të bëjnë me shkeljet e konstatuara ndaj kuadrit ligjor dhe rregullativ në fuqi.

Duke patur parasysh rëndësinë që ka funksioni i mbikëqyrjes bankare, në bashkëpunim me Bankën Botërore, është hartuar plani i zhvillimit afatmesëm të mbikëqyrjes bankare me efekt deri në vitin 2004. Zbatimi i këtij plani ka për qëllim të rrisë shkallën e sigurisë së sistemit bankar në Shqipëri, nëpërmjet zbatimit me efikasitet të standardeve për një veprimtari bankare të shëndoshë dhe të sigurtë.

Forcimi i aftësive mbikëqyrëse është konsideruar si një detyrë e rëndësishme me qëllim që të parandalohen problemet dhe të minimizohen rreziqet kundrejt të cilave ekspozohet sistemi bankar. Rëndësia e kësaj ndërmarrjeje rritet edhe më shumë përballë përpjekjeve dhe zbatimit të masave për liberalizimin e mëtejshëm të ekonomisë dhe për rritjen e shkallës së integritetit të saj.

VI. Situata financiare e Bankës së Shqipërisë.

Për vitin 2002, opinioni i kontrollorëve të pavarur është se pasqyrat financiare të Bankës së Shqipërisë paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Bankës dhe rezultatet e aktiviteteve të saj, ndryshimeve në kapitalin e vet dhe të fluksit të parasë për fundin e vitit janë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit.

Totali i bilancit të Bankës së Shqipërisë rezultoi 213 miliardë lekë ndërsa fitimi neto arriti në 9.7 miliardë lekë ose 8.9 për qind më i lartë se një vit më parë. Rreth 70 për qind e këtij fitimi është siguruar prej të ardhurave neto nga interesat, nga komisionet dhe nga rivlerësimi i letrave me vlerë nga veprimet me rezidentët. Këto të ardhura janë rritur rreth 29 për qind krahasuar me vitin 2001. Faktori kryesor ka qenë ndryshimi i kahut të operacioneve monetare dhe rritja e normës bazë të interesit nga Banka e Shqipërisë.

Të ardhurat në valutë janë realizuar më shumë nga plani, kryesisht për efekt të rritjes së rezervave valutore. Të ardhurat nga veprimet për qeverinë rezultojnë me tejkalim për arsye të rritjes së portofolit të letrave me vlerë, nga konvertimi në borxh të tregtueshëm i kredisë direkte, për 5.8 miliardë lekë dhe të rritjes së *yield*-it të bonove të thesarit.

Shpenzimet ndaj detyrimeve në lekë janë realizuar më pak nga parashikimi, duke reflektuar ngjarjet e periudhës mars–prill të tërheqjes jo të zakonshme të depozitave, ndërsa ishte parashikuar thithja e likuiditeteve të tepërta në sistem, për një shumë monetare mbi 4 miliardë lekë, kryesisht nëpërmjet marrëveshjeve *repo*. Shpenzimet administrative janë realizuar më pak nga parashikimi, pothuajse në të gjithë përbërësit. Në këtë kuadër, Banka e Shqipërisë ka në vëmendje që të jetë më e kujdesshme në drejtim të zbatimit të planit të shpenzimeve, sidomos të atyre shpenzimeve të cilat kanë lidhje të drejtpërdrejta me rritjen e efikasitetit të punës së punonjësve të saj.


Rezerva valutore përbën një burim të rëndësishëm të të ardhurave në valutë për Bankën e Shqipërisë. Në fund të vitit 2002, rezerva valutore arriti në 838.9 milionë dollarë amerikanë ose 13.8 për qind më shumë se një vit më parë.

KAPITULLI I: EKONOMIA BOTËRORE

I.1. ZHVILLIMET NË EKONOMINË BOTËRORE GJATË VITIT 2002.

Gjatë vitit 2002 ekonomia botërore ka përjetuar rritje të ulët. Pas ngjarjeve që tronditën botën, në gjysmën e dytë të vitit 2001, parashikimet për ecurinë e ekonomisë botërore janë luhatur midis rritjes modeste dhe ngadalësimit të theksuar. Fillimi i vitit 2002 dha sinjale pozitive të cilat u zbehën gradualisht me shpërthimin e skandaleve financiare në SHBA¹. Ky zhvillim iu shtua situatës jo të favorshme ekonomike, duke bërë që tregjet aksionare të dobësoheshin vazhdimisht dhe duke çuar në një nënçmim të dollarit amerikan. Në këto kushte, financimi për tregjet në zhvillim erdhi duke rënë. Në mes të vitit 2002, u vlerësua se parashikimet e bëra për rritjen ekonomike botërore gjatë viteve 2002 dhe 2003, ishin më optimiste nga ç'premtorin zhvillimet e fundit. Në këtë moment, pasi shqetësimet për inflacionin si në Eurozonë ashtu edhe në SHBA u sheshuan, u vlerësua se politikat makroekonomike do të ishin akomoduese për një periudhë më të gjatë nga ç'ishte parashikuar fillimisht. Zbutja e politikës monetare u zgjodh si mënyra kryesore për të siguruar nxitjen e ekonomisë.

Grafik 1: Rritja ekonomike për periudhën 1999-2001 dhe vlerësimet për vitin 2002.



¹Referenca: World Economic Outlook, IMF, shtator 2002.

I.1.1. EKONOMIA EUROPIANE.

Ekonomia e Eurozonës, gjatë vitit 2002 u zhvillua me ritme më të ngadalëta nga ato të parashikuara². Kjo pasqyron kryesisht pasigurinë e madhe që ka karakterizuar ambientin ekonomik dhe atë politik. Tensionet gjeopolitike me pasojat në çmimet e naftës, zhvillimet në tregjet financiare, rritja e ngadaltë ekonomike në mbarë botën janë faktorë që kanë ndikuar dhe po vazhdojnë të ndikojnë negativisht mbi besimin. Këta faktorë kanë efekte negative në konsumin e Eurozonës, në investimet e kryera në këtë zonë si edhe në tregjet e punës.

Ecuria e çmimeve ka reflektuar zhvillime të tilla si efektet e rritjeve të mëparshme të çmimeve të naftës apo të ushqimeve si edhe një ndikim të kufizuar nga kalimi në euron fizike. Rritja e vazhdueshme e pagave ka qenë gjithashtu, një faktor që ka luajtur rol në ecurinë e inflacionit. Si rezultat, norma vjetore e inflacionit ka qëndruar mbi nivelin 2 për qind përgjatë pjesës më të madhe të vitit.

Tabelë 1: Inflacioni dhe papunësia, në për qind.

	Inflacioni-dhjetor		Papunësia-dhjetor	
	2001	2002	2001	2002
Francë	1.4	2.3	8.8	9.1
Gjermani	1.7	1.1	9.6	10.1
Itali	2.4	2.8	9.3	8.9
Eurozonë	2.0	2.3	8.1	8.5

Burimi: "The Economist", muajt janar, shkurt 2003.

I.1.2. EKONOMIA E SHBA.

Muajt e fundit të vitit 2002 dëshmuar se rigjenerimi i plotë ekonomik i SHBA ka akoma rrugë për të bërë. Faktorët që kanë ndikuar pozitivisht mbi ekonominë amerikane si kërkesa e fortë e konsumatorëve, inflacioni i ulët dhe produktiviteti në rritje duket se kanë përballuar efektin e faktorëve negativë si rritja e ngadaltë e punësimit dhe ecuria jo e kënaqshme në sektorin e prodhimit.³

Kërkesa e konsumatorëve gjatë vitit 2002, ashtu si edhe gjatë tremujorit të fundit të vitit 2001, ka vazhduar të përfaqësojë motorin më të fuqishëm të rritjes ekonomike, pavarësisht nga tensionet ushtarake, nga paralizimi i pjesëshëm i tregut të punës dhe nga skandalet e korporatave.

Viti 2002 është karakterizuar nga inflacion i ulët dhe i qëndrueshëm. Inflacioni bazë (në të cilin nuk përfshihet kostoja e ushqimit dhe e energjisë) ka ardhur në rënie që nga viti 2001 dhe po qëndron në nivelin 2.2 për qind, duke rezultuar ndjeshëm më i ulët nga ai i vitit të kaluar (2.6 për qind).

² Buletini i Bankës Qendrore Europiane – Dhjetor 2002.

³ Burimi: U.S. Economy, National Update, Dhjetor 2000, <http://www.dallasfed.org/eiy/usecon/0212update.html>.

Një faktor prapa rritjes modeste të ekonomisë së SHBA, gjatë vitit të kaluar, ishte nevoja e firmave për të përtërirë fitimet e tyre, të cilat ranë dukshëm përpara dhe gjatë recesionit të fundit. Nevoja për përtëritjen e përfitimeve detyroi shumë firma të pakësonin shpenzimet për investimet si edhe të shkurtonin vendet e punës. Si rezultat i këtyre zhvillimeve, papunësia në SHBA ka arritur në nivelin më të lartë të tetë viteve të fundit.

Tabelë 2: Ritmet e rritjes për përbërësit kryesorë të rritjes ekonomike në SHBA.

	2000	2001	T1-02	T2-02	T3-02	T4-02
Rritja ekonomike	3.8	0.3	5.0	1.3	4.0	1.4
Konsumi personal	4.4	2.5	3.1	1.8	4.2	1.5
Investim jorezidencial	7.8	-5.2	-5.8	-2.4	-0.8	2.5
Investim rezidencial	1.1	0.3	14.2	2.7	1.1	9.4
Eksporte mallrash dhe shërbimesh	9.7	-5.4	3.5	14.3	4.6	-4.4
Importe mallrash dhe shërbimesh	13.2	-2.9	8.5	22.2	3.3	7.2
Konsumi qeveritar	2.7	3.7	5.6	1.4	2.9	4.9

Burimi: Bureau of Economic Analysis, të dhëna makroekonomike- <http://www.bea.gov/bea/glance.htm>.

I.1.3. VEPRIMET E BANKAVE QENDRORE ME NORMAT E INTERESIT.

Dy bankat qendrore⁴ më të rëndësishme në botë, Rezerva Federale dhe BQE kanë vepruar vetëm një herë me normat e rifinancimit gjatë vitit 2002. Rezerva Federale ishte ajo që veproi e para, në 6 nëntor, duke ulur normën e rifinancimit me 0.5 pikë përqindjeje (nga 1.75 në 1.25 për qind). Vendimi i Rezervës Federale për uljen e normës erdhi pas një serie të gjatë zhvillimesh jo të favorshme ekonomike. Në deklaratën që shpalli uljen e normës së interesit, u theksua se ekonomia amerikane kishte arritur në një pikë ku shpenzimet, prodhimi dhe investimet ishin kufizuar nga pasiguria dhe, në mënyrë të veçantë, nga kërcënimi i luftës me Irakun.

Ndryshe nga ç'mund të pritej, reagimi i BQE nuk ishte i menjëhershëm. BQE, pavarësisht se shprehu shqetësim për rritjen e ngadalësuar ekonomike të Eurozonës, dërgoi sinjalin se nxitja e rritjes ekonomike nuk është detyrë e politikës monetare. Vendimi i BQE-së për të mos ndryshuar normën në nëntor u justifikua me shqetësimin për inflacionin. Ky i fundit përcaktohet në mandatin e BQE-së dhe synohet të mbahet midis niveleve 0 dhe 2 për qind. Në tetor inflacioni vjetor, nën ndikimin e një rritjeje të theksuar të ofertës monetare, u rrit në krahasim me shtatorin. Pavarësisht nga kjo, BQE në fillim të dhjetorit iu "dorëzua" presionit për të ulur normën me 0.5 pikë përqindjeje (nga 3.25 në 2.75 për qind), nisur kryesisht nga shqetësimi për ekonominë gjermane dhe për pamundësinë e saj për të kryer reformat e nevojshme strukturore.


⁴ Për përgatitjen e materialit janë shfrytëzuar faqet e Rezervës Federale dhe të Bankës Qendrore Europiane si edhe revista "Economist", 7 nëntor 2002.

I.1.4. ZHVILLIMET NË KURSIN E KËMBIMIT.

Për vitin që sapo kaloi euro llogaritet të jetë mbiçmuar rreth 20 për qind, krahasuar me monedhën amerikane. Tre janë momentet kryesore të lëvizjes së çmimit të euros të shprehur në dollarë amerikanë.

Euro e filloi vitin 2002 në nivelin 0.87 usd/euro. Pas këtij niveli ajo vazhdoi të rritej në terma dollari, për të arritur pikun në muajin korrik, me nivelin 1.01 usd/euro. Shkak për nënçmimin e monedhës amerikane në këtë periudhë të vitit ishin skandalet financiare lidhur me praktikat kontabël të disa shoqërive, kryesisht, në SHBA. Si rrjedhim, pasiguria që përfshiu tregjet aksionare amerikane bëri që investitorët të drejtoheshin më shumë nga Europa. Pas këtij momenti, kursi i këmbimit të euros me dollarin u lëkund në nivelin e

Grafik 2: Kursi i këmbimit euro/usd për vitin 2002 në tregun ndërkombëtar.



Burimi: www.x-rates.com.

barazisë, për të vazhduar më tej, në muajin tetor, me mbiçmimin e dollarit amerikan në nivelin 0.97 usd/euro. Mbiçmimi i monedhës amerikane u mbështet nga investimet në tregjet e aksioneve dhe lajmet jo të mira lidhur me deficitin buxhetor të Zonës së Euros. Më pas, ndërroi përsëri kahu i lëvizjes së monedhave, sipas të cilit, euro vazhdoi të forcohej për të arritur, në fund të vitit 2002, nivelin 1.06 usd/euro. Nënçmimi i monedhës amerikane në fund të vitit ishte produkt i një sërë faktorëve në SHBA, të tillë si: skandalet financiare, acarimi i marrëdhënieve me Irakun, deficitin i lartë i llogarisë korente, pasiguria, rritja e ulët ekonomike dhe normat e ulëta të interesit.

I.1.5. ÇMIMET E NAFTËS.

Viti 2002 është karakterizuar nga një tendencë në rritje e çmimeve të naftës⁵, me disa rënie të lehta përgjatë tij. Në fund të vitit çmimi i naftës shënonte nivelin 33 euro për fuçi ose një rritje prej 22 për qind krahasuar me muajin janar. Tensionet politike në Lindjen e Mesme, gjatë pjesës së parë të vitit 2002, ushtruan presion në tregjet e naftës, duke çuar në rritjen e çmimeve. Pas një stabilizimi të tyre deri në fillim të muajit gusht, me rishfaqjen e tensioneve gjeopolitike (konflikti SHBA-Irak) rifilloi një rritje tjetër e çmimeve të naftës, që në muajin tetor arriti rreth 32 euro për fuçi. Gjatë muajit nëntor, falë një përmirësimi të lehtë të kuadrit ndërkombëtar, çmimi i naftës ra në nivelin 27 euro për fuçi. Kontratat e të ardhmes, duke reflektuar ulje të tensioneve ndërkombëtare, parashikuan një ulje graduale të çmimeve të naftës për vitin 2003. Në ndryshim nga kjo, muaji dhjetor u karakterizua nga një ritensionim i marrëdhënieve ndërkombëtare dhe nga rritja e gjasave për një luftë të mundshme me Irakun. Kjo si dhe greva e përgjithshme në Venezuelë, e cila ndaloi eksportet e naftës, bënë që çmimi i naftës në fund të vitit të arrinte nivelin 33 euro për fuçi.

I.2. EKONOMITË E RAJONIT.

Pothuajse në të gjitha ekonomitë në tranzicion të rajonit, gjatë vitit 2002 “janë shëruar” pasojat e krizave të ndodhura gjatë vitit 2001. Shifrat, në përgjithësi, tregojnë për një tendencë pozitive në ecurinë e PBB-në. Ndërmarrja e reformave të ndryshme si dhe dalja nga krizat kanë bërë që objektivi kryesor të jetë qëndrueshmëria ekonomike dhe ajo e çmimeve.

I.2.1. TURQIA.

Rritja ekonomike⁶ për tremujorin e tretë arriti nivelin 7.9 për qind, duke e çuar në 6.5 për qind normën e rritjes së PBB-së për gjithë nëntëmujorin. Ndërkaq, norma 8.8 për qind e rritjes së prodhimit industrial për 10 muajt e parë të vitit si dhe tendenca rritëse në normën e përdorimit të kapitaleve (80.6 për qind në muajin tetor nga 73.3 për qind në tetorin e vitit 2001), tregojnë që ekonomia turke do të rikuperohet me një normë rritjeje 5.5 për qind në vitin 2002 krahasuar me kontraktimin 7.4 për qind në vitin 2001.

Inflacioni dhe pritjet për të, vazhdojnë të ulen si rrjedhojë e politikës së shtrënguar monetare të ndjekur nga Banka Qendrore e Turqisë. Inflacioni vjetor në nëntor arriti shifrën 31.8 për qind, ndërsa inflacioni kumulativ për të 11 muajt e vitit arriti shifrën 27.1 për qind, duke nënkuptuar se vlera e inflacionit në fund të vitit do të jetë mjaft poshtë nivelit të synuar prej 35 për qind.

⁵ Burimi: www.dansercontainerline.com/oil02.htm.

⁶ Burimi: National Bank of Greece, South Eastern Europe and Mediterranean Emerging Market Economies, Bulletin, December 2002.

I.2.2. F.Y.R.O.M.

Aktiviteti ekonomik në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë ka shënuar një rritje të moderuar gjatë vitit 2002. Zgjedhja e qeverisë së re në muajin tetor dhe stabilizimi i situatës politike mendohet se do të ndikojnë pozitivisht në ekonominë e vendit. Prodhimi industrial për vitin 2002 llogaritet të jetë përmirësuar shumë pak pas rënies së fortë të tij në vitin 2001. Duke iu referuar të dhënave më të fundit⁷, norma e rritjes shënon nivelin -9.5 për qind, nga -10.6 për qind në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Përsa i përket nivelit të inflacionit, rritja kumulative gjatë dhjetë muajve të parë të vitit shënon 2 për qind. Nisur nga ky fakt, vlerësohet se ecuria e inflacionit është brenda objektivit 3.5 për qind për fundin e vitit. Rritja e inflacionit ka qenë kryesisht rezultat i rritjes së pagave dhe të pensioneve në muajin qershor të vitit 2002. Për t'u shënuar është rikthimi i besimit të publikut maqedonas në monedhën kombëtare dhe ulja e deficitit të llogarisë korente.

I.2.3. SERBIA & MALI I ZI.

Serbia dhe Mali i Zi vazhduan përsheptimin e reformave. Rritja ekonomike mendohet se do të arrijë nivelin 4.1 për qind nga 5.9 për qind në vitin 2001. Ndërmarrja e reformave të ristrukturimit ekonomik ka bërë që kontributi i prodhimit industrial në PBB të jetë zero, ashtu si në vitin 2001.

Inflacioni vazhdon të shënojë rënie nga viti në vit. Në fund të vitit inflacioni mendohet të qëndrojë në brezin 15-17 për qind, nga 39 për qind në vitin 2001 dhe 114 për qind në vitin 2000.

I.2.4. KROACIA.

Prodhimi i brendshëm bruto për vitin 2002 vlerësohet të jetë rritur me ritëm më të ulët se në vitin 2001. Kështu, në dhjetë muajt e parë të vitit, rritja kumulative e prodhimit industrial arriti nivelin 4.6 për qind, nga 6.1 për qind në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Inflacioni në fund të vitit mendohet se do të arrijë nivelin objektiv 3-4 për qind. Për njëmbëdhjetë muajt e parë të vitit, niveli kumulativ i inflacionit qëndroi në nivelin 2.3 për qind, por aplikimi i një sistemi të ri matjeje të energjisë elektrike dhe dimri më i ftohtë, mendohet se do të sjellin rritje të inflacionit.

⁷ Të dhënat për prodhimin industrial i referohen fundit të nëntëmujorit.

I.2.5. ITALIA.

Të dhënat paraprake tregojnë se ekonomia italiane vazhdoi të zhvillohej ngadalë gjatë tremujorit të tretë të vitit 2002. Një ndër problemet që vazhdoi të shqetësonte këtë ekonomi ishte organizimi i grevave nga një prej sindikatave më të mëdha të vendit. Lëvizja dhe bashkëpunimi i sindikatave u rigjallërua si pasojë e vendimit të shoqërisë Fiat për të shkurtuar 8100 vende pune në një fabrikë të madhe në Itali. Sindikatat kanë kritikuar buxhetin e qeverisë për vitin 2003 pasi sipas tyre, ai nuk është i mjaftueshëm për të ulur papunësinë, e cila në pjesën jugore të vendit arrin deri në 18 për qind. Besimi i biznesit në vend erdhi duke u rritur me afrimin e festave të fundvitit, por megjithatë, analistët nuk presin një rimëkëmbje të plotë deri në gjysmën e dytë të vitit 2003.

I.2.6. GREQIA.

Vendimi⁸ i Eurostatit për të ripërkufizuar llogaritjen e borxhit publik ka cënuar bazat e ekonomisë greke. Sipas përkufizimit të ri, borxhi publik i Greqisë arrin nivelin 107 për qind të PBB-së (nga 99.6 për qind), duke i kthyer në deficite, suficitet e propozuara për buxhetin në periudhën 2001-2004. Performanca e Qeverisë Greke tashmë ka rënë në nivelet përpara hyrjes së Greqisë në Bashkimin Monetar Europian. Inflacioni mbetet në nivele të larta krahasuar me inflacionin e Eurozonës, 2.3 për qind. Niveli i çmimeve parashikohet të bjerë gjatë dy viteve në vazhdim, megjithatë diferenca mes Greqisë dhe partnerëve në Eurozonë pritet të zgjerohet. Ky zhvillim po ndikon negativisht konkurrencialitetin e Greqisë, duke e bërë të vështirë për prodhuesit të eksportojnë dhe të ruajnë pozicionin e tyre të tregut brenda vendit. Deficiti aktual i llogarisë korente pritet të jetë rreth 6.2 për qind e PBB-së në vitin 2002. Përpara hyrjes në Bashkimin Monetar Europian ky deficit do të kishte kërkuar kontrolle mbi importet apo zhvlerësim të monedhës. Kjo gjë nuk do të ndodhë tani, pasi deficiti i llogarisë korente në Greqi përbën më pak se 2 për qind të deficitit të Eurozonës dhe nuk ka influencë të ndjeshme në kursin këmbimit të euros. Gjithësesi, ky deficit pritet të ketë efekt mbi papunësinë, e cila mbetet e lartë (10 për qind) me gjithë shpenzimet e mëdha qeveritare për ta ulur atë.

⁸Burimi: <http://www.invgr.com/indicators.htm>.

KAPITULLI II: EKONOMIA SHQIPTARE

II.1. KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME

Ekonomia e vendit, për vitin 2002, u rrit me 4.7⁹ për qind në krahasim me një vit më parë. Ky është viti i pestë që aktiviteti ekonomik është vlerësuar në rritje. Por, kjo është rritja më e ulët në serinë kohore të periudhës 1998-2002 (madje me devijim të dukshëm nga niveli i parashikuar për të prej 6 për qind).

Tabelë 3: Tregues të përgjithshëm ekonomikë.

	1996**	1997	1998	1999	2000	2001*	2002*
Rritja reale e PBB-së (në %)	9.1**	-7.0	8.0	7.3	7.8	6.5	4.7*
PBB (çmime korente, në milionë lekë)	315835.0	333071.0	425356.0	488611.0	551282.0	590237.0	658062.0*
PBB (çmime korente, në milionë usd)	3022.5	2236.5	2824.4	3548.4	3836.3	4113.7	4695.4*
PBB (në usd për frymë)	920.6	672.9	842.1	1052.0	1128.0	1332.6	1521.0
Numri i të punësuarve (në mijë)	1116.0	1107.0	1103.0	1081.0	1068.0	1065.0	921.0
Përqindja e papunësisë	12.4	14.9	17.8	18.0	16.9	14.6	15.8
Përqindja e inflacionit (v/v)	17.4	42.1	8.7	-1.0	4.2	3.5	2.1
Deficiti i buxhetit (në % të PBB-së)	-11.4	-13.2	-11.3	-11.9	-9.1	-8.6	-6.2
Borxhi i brendshëm (në % të PBB-së)	30.7	36.2	35.1	36.3	41.0	40.9	38.7(Q3-02)
Llogaria korente (në % të PBB-së)	-2.1	-11.3	-2.3	-3.7	-4.3	-5.3	-9.5
Borxhi i jashtëm (në % të PBB-së)	29.2	35.6	26.5	25.8	29.2	28.2	24.6*
Kursi mesatar i këmbimit, lek/usd	104.5	148.9	150.6	137.7	143.7	143.48	140.15

Shënim: * Të dhënat janë vlerësime të Ministrisë së Financave dhe FMN-së.

** Të dhënat për PBB dhe rritjen reale të saj për vitet 1996-2000 janë të INSTAT –it.

Burimi: INSTAT, Ministria e Financave, Banka e Shqipërisë dhe vlerësime të FMN-së.

Analizat e deritanishme kanë treguar se rritja i dedikohet në pjesën më të madhe zgjerimit të mëtejshëm të sektorit privat të ekonomisë, ndërkohë që roli i atij shtetëror në PBB po vjen duke u reduktuar.

⁹ Sipas vlerësimeve të FMN-së, janar 2003.

Tabelë 4: Rritja reale e PBB-së dhe sipas sektorëve për vitin 2002 në krahasim me vitin 2001, në për qind.

Rritja reale e PBB-së sipas sektorëve	Parashikimi në fillim të vitit 2002	Realizimi
PBB	6.0	4.7
Industria	5.0	2.0
Bujqësia	3.0	2.1
Ndërtimi	11.5	9.1
Transporti	11.0	10.1
Shërbimet	6.5	5.5

Burimi: Ministria e Financave, mars 2003.

Rritja e PBB-së do të kishte qenë më pranë vlerës së parashikuar, nëse sektorë të tillë si industria, bujqësia dhe ndërtimi, nuk do të kishin manifestuar ritme më të ulëta rritjeje se ato të programuarat.

Nga ana tjetër, struktura e PBB-së po i largohet në mënyrë të vazhdueshme profilit të theksuar bujqësor e blegtoral të viteve të kaluara, duke u përqendruar në shërbimet, transportin dhe ndërtimin. Banka e Shqipërisë vlerëson se, prirjet e reja strukturore, do të ishin më eficiente nëse ato do të vëreheshin edhe në sektorin e industrisë, i cili mund të mbështesë një rritje ekonomike më të qëndrueshme për periudha afatgjata.

Tabelë 5: Ecuria e kontributit të sektorëve ekonomikë.

Struktura e PBB-së (në %)	1992	2001	2002
PBB	100.0	100.0	100.0
Industria	16.9	13.2	12.8
Bujqësia	54.2	34.2	33.3
Ndërtimi	7.6	10.3	10.8
Transporti	3.0	10.1	10.6
Shërbimet	18.3	32.2	32.5

Burimi: Ministria e Financave, mars 2003.

Tashmë është theksuar se reduktimi i ndjeshëm i kontributit të bujqësisë në PBB lidhet, në pjesën më të madhe, me problemet serioze të sektorit bujqësor.

Rënia e theksuar e prodhimit industrial për vitin 2002 në krahasim me një vit më parë dhe me parashikimet, shpreh përballjen e drejtpërdrejtë të këtij sektori me faktorin e “mungesës së energjisë elektrike”.

Nga ana tjetër, nuk mund të anashkalohen problemet e tjera të zhvillimit të këtij sektori që lidhen me:

- ekzistencën e një efience ende të ulët të përdorimit të faktorëve kryesorë të prodhimit: të burimeve njerëzore dhe të kapitaleve prodhuese;
- praninë e një klime shpeshherë të pafavorshme për biznesin, që në pjesën më të madhe lidhet me problemet e sistemit legjislativ, gjyqësor, të transparencës së administratës shtetërore dhe të zhvillimit të marrëdhënieve të bashkëpunimit;

- ekzistencën e njëfarë paqëndrueshmërie në aktivitetin e biznesit shqiptar, sidomos të atij prodhues gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2002, e krijuar nga paqartësitë në zhvillimet politike të vendit;
- ekzistencën e vështirësive të mëdha në gjetjen e tregjeve, brenda dhe jashtë vendit.

II.1.1. PRODHIMI BUJQËSOR.

Vlerësimet më të fundit tregojnë që rritja e bujqësisë është rreth 2.1 për qind apo afër 1 pikë përqindjeje më poshtë sesa parashikimi për këtë sektor.

Ndër faktorët kryesorë që vazhduan të pengojnë rritjen e dëshiruar të prodhimit bujqësor e blegtoral edhe gjatë vitit 2002 mund të përmenden:

- niveli i ulët organizativ në këtë sektor, që shprehet në praninë e fenomenit të copëzimit të tokës në ngastra gjithnjë e më të vogla, në shkallën ende të prapambetur të mekanizimit dhe të teknologjisë bujqësore; në mungesat e theksuara të organizimit të marketingut të produkteve të vendit;
- infrastruktura e pazhvilluar e zonave rurale, sidomos në pjesën veriore të vendit;
- kapaciteti i ulët i aftësive konservuese të produkteve bujqësore dhe blegtorale;
- lënia në hije e këtij sektori nga ana e sistemit bankar, që pasqyrohet në një mbështetje mjaft të ulët me burimet e nevojshme financiare.

Veç faktorëve të mësipërm, viti 2002, evidentoi edhe atë natyror, me përmbytjet e periudhës gusht – shtator.

Në kushtet e ekzistencës së informacionit statistikor mjaft të kufizuar, vlerësohet se të paktën prodhimi në degën e agroindustrialë, është një ndër elementet që ka ndikuar pozitivisht në rritjen e sektorit të bujqësisë. Konkretisht, në fund të vitit 2002, u regjistrua një rritje prej afro 13 për qind në industrinë agroushqimore.

Box 1: METODOLOGJIA E MATJES SË PBB-së.

Pak histori mbi matjen e PPB-së.

Llogaritja e treguesit të prodhimit, deri në fillimin e viteve '90, bazohej në vlerësimin sipas metodës së Sistemit të Prodhimit Material (SPM). Periudha në vijim, 1990-1992, shënoi kalimin nga vlerësimi sipas SPM-së në atë të Kontabilitetit Kombëtar. Nga ky transformim në sistemet e llogaritjeve, treguesi i të Ardhurave Kombëtare u konvertua në atë të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB). Që prej vitit 1991, PBB-ja është vlerësuar nga njësia makroekonomike, pranë Ministrisë së Financave. Ndërkohë që INSTAT, me asistencën e FMN-së, realizoi për herë të parë llogaritjen e PBB-së mbi baza statistikore, për periudhën 1996-2000.

Metoda e përdorur.

Rezultati përfundimtar i aktivitetit të prodhimit të njësive prodhuese rezidente përfaqësohet nga PPB-ja. Llogaritjet e PPB-së përfshijnë të gjitha prodhimet dhe shërbimet aktuale të destinuar për tregti dhe ato të prodhuara për konsum vetiak nga të gjitha njësitë rezidente që veprojnë në territorin të cilësuar "ekonomik" të Republikës së Shqipërisë. INSTAT ka aplikuar metodat e prodhimit dhe të shpenzimeve me çmime korente dhe konstante, bazuar në Sistemin e Llogarive Kombëtare të Kombeve të Bashkuara, të vitit 1993. Ai vlerëson se metoda e prodhimit shpreh më realisht PPB-në, duke e mbështetur këtë gjykim mbi faktin se informacionet që shfrytëzohen në aplikimin e kësaj metode, aktualisht, janë më të besueshme dhe më të plota.

Metodologjia e re:

- e sjell shifrën e PBB-së, mbi bazën e matjeve statistikore, ndërkohë që metodologjia paraardhëse mbështetej vetëm në vlerësimet mbi tendencat e aktivitetit ekonomik në vend;
- i bën matjet për kontributin e secilit sektor në PBB mbi bazën e tetë sektorëve të ekonomisë, ndërkohë që vlerësimet paraardhëse mbështeteshin vetëm mbi pesë të tillë.

Rezultatet e kësaj metode tregojnë se për periudhën 1996-2000 rritja reale vjetore e PBB-së dhe kontributi i sektorëve kryesorë ekonomikë në PBB paraqesin një ecuri me ndryshime të dukshme, krahasuar me metodologjinë vlerësuese. Kështu, pesha e bujqësisë ka rënie të ndjeshme, ndërkohë që është rritur kontributi i sektorit të shërbimeve.

Tabelë 6: Matjet e rezultuara sipas dy metodologjive për periudhën 1996 – 2000.

Treguesit	Vitet									
	1996		1997		1998		1999		2000	
Metodologjitë	I*	II**	I	II	I	II	I	II	I	II
Rritja reale vjetore e PBB-së krahasuar me vitin e mëparshëm (në %)	9.1	9.1*	-7.0	-10.3	8.0	12.7	7.3	8.9	7.8	7.7
Kontributi i sektorëve ekonomikë në PBB (në %)										
1. Bujqësia, gjuetia dhe pyjet	51.5	30.8	56.0	31.2	54.4	30.7	37.2	28.5	35.9	28.1
2. Industria - nxjerrëse - përpunuese	12.2	15.5 1.1 14.4	12.4	13.8 1.0 12.8	12.0	11.4 0.7 10.7	13.5	11.4 0.8 10.6	13.2	11.7 0.8 10.9
3. Ndërtimi	11.2	4.6	11.2	4.3	12.6	4.1	8.9	4.9	9.7	6.1
4. Tregtia, hotelet dhe restorantet		24.3		20.8		21.2		23.2		21.3
5. Transporti	3.2	5.4	2.7	6.0	3.0	8.8	9.0	8.9	9.5	7.9
6. Posta dhe komunikacioni		1.0		1.6		1.4		2.0		2.0
7. Shërbime të tjera	21.9	21.1	17.7	25.9	18.0	27.9	31.4	25.9	31.8	26.4
8. Shërbime të ndërmjetme financiare të matura indirekt		-2.7		-3.6		-5.5		-4.9		-3.8

Shënim: *Metodologjia vlerësuese; **Metodologjia e matjes statistikore; ***Sipas vlerësimit të bërë nga Ministria e Financave.

Devijimet më të dukshme ndërmjet rezultateve të të dyja metodave, vihen re në:

- treguesin e rritjes ekonomike të vitit 1998;
- ndryshimet e theksuara në strukturën e sektorëve të bujqësisë dhe të ndërtimit gjatë gjithë periudhës 1996-2000.


Burimi: 1) INSTAT, Produkti i Brendshëm Bruto, 1996-2000, janar 2003.

2) Banka e Shqipërisë, Raporti Statistikor, dhjetor 2002 dhe janar 2003.

II.1. 2. PRODHIMI INDUSTRIAL.

Indeksi i shitjeve. Ritmika e indeksit të shitjeve, gjatë vitit 2002, ka shënuar një tendencë të lehtë në rënie, nga njëri tremujor në tjetrin, për ekonominë në tërësi. Tendencë më theksuar në rënie është manifestuar në sektorët “Transport dhe telekomunikacion”, “Industri” dhe “Tregti, hotele dhe restorante”. Ndërsa një ecuri me luhatshmëri të dukshme ka manifestuar indeksi për sektorët e ndërtimit dhe të “Energjisë elektrike, ujë dhe gazit”. Nga një ritëm në rënie në tremujorin e tretë në krahasim më të dytin, që mund të jetë shkaktuar edhe për shkak të kushteve të pazakonta të motit me rreshje të shumta, tremujori i katërt shënoi një rritje prej afro 29.5 për qind në krahasim me tremujorin paraardhës. Në këtë kthesë të tendencës nuk mund të përjashtohet ndikimi që jep shlyerja e “kësteve” të cilat përqendrohen në fundvite si edhe lidhja e kontratave të reja me firmat ndërtuese. Nga ana tjetër, duke ditur që indeksi i kushtimit në ndërtim shënoi përsëri rritje, duket që rritja e indeksit të shitjeve për sektorin e ndërtimit të jetë ndikuar edhe nga ky fakt.

Grafik 3: Ritmika e indeksit të shitjeve për disa sektorë ekonomikë gjatë vitit 2002 (në për qind).




Burimi: INSTAT, Konjuktura, mars 2003.

Sektorin e ndërtimit vlerësohet se është rritur me 9.1 për qind. Ky sektor mbetet ndër më dinamikët e ekonomisë shqiptare. Megjithatë, formalizimi i aktivitetit të ndërtimit dhe ngopja graduale e kërkesës së tregut për ndërtime ndikojnë në ngadalësimin e këtij sektori. Indeksi i kushtimit të ndërtimit ka shënuar një rritje prej 2.8 për qind krahasuar me vitin e kaluar. Ky ndryshim ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së zërit “shpenzime plotësuese” indeksi i të cilit,

krahasuar me një vit më parë, ka ecur në drejtim rritës gjatë gjithë vitit. Ndërkohë, ndryshimi vjetor i “shpenzimeve direkte” ka qenë negativ gjatë gjithë tremujorëve të vitit, me përjashtim të tremujorit të katërt. Në tremujorin e katërt, rritjen kryesore të shpenzimeve direkte e kanë dhënë shpenzimet për materiale ndërtimi, ato për pagat dhe makineri. Një tendencë rënëse shfaq zëri “ndërtim kantieri”. Gjatë tre viteve të fundit, 2000-2002, indeksi i tij arriti vlerën më të lartë në tremujorin e katërt të vitit 2001 dhe ka vijuar në rënie gjatë vitit 2002. Por, është e qartë që statistikat e këtij sektori vuajnë ende nga mungesa e evidentimeve të sakta dhe të plota.

Grafik 4: Ndryshimi vjetor i indeksit të kushtimit të ndërtimit, në për qind.



II.1.3. SEKTORI I TRANSPORTIT.

Ndryshe nga viti i kaluar, kur sektori i transportit u karakterizua nga nivele të larta investimesh me qëllim përmirësimin e infrastrukturës së vendit, gjatë vitit 2002 kjo tendencë ka rënë ndjeshëm. Krahasuar me një vit më parë, investimet në sektorin e transportit janë ulur me 31.2 për qind. Niveli i realizimit të tyre sipas planit rezultoi 79.4 për qind, ndërkohë që një vit më parë, investimet shënuan një tejkallim prej afro 17.5 për qind. Theksojmë se ecuria e investimeve gjatë tre tremujorëve të parë ka qenë në nivele të ulëta duke bërë që edhe realizimi i tyre krahasuar me planin të jetë i ulët për këtë periudhë (65 për qind). Ndërkohë, në tremujorin e katërt vihet re një gjallërim i investimeve që ka rezultuar në një tejkallim prej 19.5 për qind të planit për këtë tremujor. Një shpërndarje e tillë e investimeve, në mospërputhje me parashikimet e bëra më parë lë shteg të mendosh për një administrim jo eficient të tyre, i diktuar deri-diku edhe prej situatës së likuiditetit në gjysmën e parë të vitit 2002.

Tabelë 7: Investimet sipas burimeve, në milionë lekë.

Treguesi	1998	1999	2000	2001	2002
Investimet gjithsej	8,269	13,129	15,997	13,653	9,400
Investime buxhetore	1,969	4,447	5,977	4,423	4,077
Investime me kredi/ndihma të huaja	6,300	8,682	10,020	9,231	5,323


Në sektorin e ngarkim-shkarkimit, vihet re një rritje e aktivitetit të hekurudhave, ndonëse ato kontribuojnë 8 për qind të vëllimit total të ngarkim-shkarkimit, ndërsa pjesa tjetër mbulohet nga portet detare. Mendohet që me vënien në funksionim të linjës hekurudhore Bajzë-Kufi (Mal i Zi) dhe më pas të asaj Shkodër-Bajzë, pesha e hekurudhave në vëllimin e ngarkim-shkarkimit të rritet.

II.1.4. KURSIMET DHE INVESTIMET.

Viti 2002, ashtu si dy-tre vitet e fundit, është karakterizuar nga një ritëm më i shpejtë rritjeje i investimeve kundrejt kursimeve të brendshme. Për rrjedhojë, diferenca e krijuar midis tyre është financuar nga kursimet e huaja, të cilat vlerësohen deri në 8.9 për qind të PBB-së.

Kursimet e brendshme¹⁰ për vitin 2002 gjenden në nivelin 10.3 për qind të PBB-së nga 13.1 për qind në vitin 2001. Ndërkohë, investimet paraqesin një rënie 0.4 për qind kundrejt vitit të kaluar, duke qëndruar në nivelin 19 për qind të PBB-së.

Grafik 5: Ecuria e kursimeve dhe e investimeve në % ndaj PBB-së.




Gjatë vitit 2002 financat publike u konsoliduan më tej, si në drejtim të mbledhjes së të ardhurave ashtu edhe të disiplinimit të shpenzimeve. Megjithatë, mosrealizimi i të ardhurave nga privatizimi mendohet si një nga shkaqet që kanë ndikuar në uljen e kursimeve të brendshme dhe të investimeve në vitin 2002 kundrejt vitit 2001.

Kursimet e brendshme, i atribuohen kryesisht sektorit privat me 11.1 për qind të PBB-së, ndërkohë që sektori publik paraqet një nivel negativ kursimesh në masën -1 për qind të PBB-së. Nga ana tjetër, investimet e sektorit publik vlerësohen në nivelin 6.5 për qind të PBB-së, ndërsa ato të sektorit privat që mbajnë dhe peshën kryesore, llogariten në 12.5 për qind të PBB-së.

¹⁰ Të dhënat për kursimet dhe investimet i referohen vlerësimeve të FMN.

Investimet publike ashtu siç parashikohet në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit Ekonomik dhe Social, kryesisht, janë përqendruar në sektorët parësorë të ekonomisë si në shëndetësi, në arsim e në infrastrukturë. Mjaft të rëndësishme për këtë të fundit janë financimet e huaja, kontraktimi i të cilave gjatë vitit 2002 u përqendrua në rehabilitimin e KESH-it dhe në përmirësimin e infrastrukturës rrugore.

Grafik 6: Ecuria e investimeve sipas sektorëve në % ndaj PBB-së.



Rritja e investimeve përbën një element të rëndësishëm të rritjes ekonomike. Gjithashtu, rritja e kursimeve të brendshme, vlerësohet po aq e rëndësishme pasi pasqyron potencialet e ekonomisë për investime të mëtejshme e për rrjedhojë për qëndrueshmëri në rritjen e PBB-së. Tërheqja e kursimeve të huaja, nëpërmjet investimeve të huaja mbetet gjithashtu, një nga prioritetet e autoriteteve shqiptare, si faktor thelbësor në mbështetjen e programeve të investimeve.

Box 2: PRIVATIZIMI.

Gjatë vitit 2002 nuk u bë e mundur të përfundonte privatizimi i Bankës së Kursimeve dhe i shoqërisë së telefonisë fikse Albtelekom, si pjesë e reformave strukturore. Shitja e Bankës së Kursimeve, e planifikuar të fillonte në shtator të vitit 2001 nuk pati sukses si rrjedhojë e tenderit të papërshtatshëm. Vetëm tre banka shprehën interes për blerjen e saj në shtator të vitit 2001. Por, kjo përpjekje dështoi si pasojë e turbullirave në Maqedoni, e krizës financiare në Turqi dhe e ngjarjeve të 11 shtatorit në SHBA. Kështu, shitja e aksioneve të Bankës së Kursimeve, minimalisht 35 për qind në fillim dhe 49 për qind më vonë u shty për në muajin qershor të vitit 2002.

Përpjekja e dytë në muajin qershor për të shitur të paktën 35 për qind të aksioneve të Bankës së Kursimeve dështoi përsëri. Dy banka italiane, SanPaolo IMI dhe IntesaBCI ishin në garë për blerjen e Bankës së Kursimeve. Bank Austria, pjesë e grupit HVB u tërhoq nga procesi i tenderimit. Dy bankat italiane u tërhoqën për shkak të problemeve që paraqiste ristrukturimi i plotë i Bankës së Kursimeve si dhe për shkak të angazhimeve të tyre në procese të tjera privatizimi në Europën Juglindore. Sipas tyre Banka e Kursimeve kishte nevojë për një rinovim të thellë e tërësor. Banka e Kursimeve dominon tregun e depozitave duke zënë 60 për qind të tij. Për të lehtësuar procesin e privatizimit, në muajin maj, Kuvendi Shqiptar lejoi përjashtimin e Bankës së Kursimeve nga ligji për konkurrencën, i cili ndalon që shoqëritë e ndryshme të kontrollojnë më shumë se 40 për qind të tregut. Shitja e Bankës së Kursimeve është elementi bazë për të krijuar një sektor financiar më dinamik.

Për të lehtësuar procesin e privatizimit, autoritetet shqiptare janë angazhuar në rishikimin e strategjisë së privatizimit të Bankës së Kursimeve, pasi vonesat në këtë proces mund të ngrenë probleme të mëtejshme për financimin e buxhetit. Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore po japin ndihmën e tyre në këtë proces.

Privatizimi i operatorit të telefonisë fikse Albtelekom, gjithashtu, nuk rezultoi i suksesshëm në vitin 2001. Investitori strategjik i Albtelekom, do të blinte 51-76 për qind të shoqërisë, duke lënë një pjesë të konsiderueshme në duart e shtetit. Kushti i tenderimit kërkonte një investitor strategjik me vlerë 300 milionë usd dhe kapital të paguar 150 milionë usd.

Operatori i telefonisë fikse Albtelekom, nuk arriti të bëhej tërheqës për investitorët e huaj, megjithëse afati u shty për në qershor të vitit 2002. Vonesa në këtë privatizim i atribuohet ngadalësimit në tregun global të telekomunikacionit dhe çështjeve të pazgjidhura midis Albtelekom dhe palëve të treta. Pas këtij momenti, vështirësi tjetër paraqiti marrja e përgjegjësisë institucionale për privatizimin e Albtelekom. Përsa i përket Albtelekomit, bilanci i tij është i mbushur me një sërë problemesh financiare, të cilat kërkojnë zgjidhje për të rritur vlerën e shoqërisë përpara privatizimit, që pritet të bëhet gjatë vitit 2003.

Në muajin maj, Kuvendi miratoi gjithashtu, formulën e modifikuar të privatizimit të Shoqërisë së Sigurimeve INSIG, duke lejuar institucionet financiare ndërkombëtare të blejnë pjesë të aksioneve dhe të administrojnë kompaninë për rreth 3 vjet përpara privatizimit. Qeveria ka vendosur të shesë deri në 40 për qind të aksioneve të INSIG, Shoqërisë Financiare Ndërkombëtare të Bankës Botërore (IFC) ose Bankës Europiane për Rindërtim e Zhvillim, dhe një vit më vonë do t'i ofrojë një shoqërie private sigurimesh të paktën 51 për qind të paketës së INSIG-ut. Pritet që procesi i privatizimit të fillojë në vitin 2003.

II. 2. TREGU I PUNËS.

Të dhënat për tregun e punës në vitin 2002 pasqyrojnë jo vetëm thjesht zhvillimet e këtij tregu por edhe disa ndryshime që erdhën si rezultat i Regjistrimit të Përgjithshëm të Popullsisë dhe Banesave.

Ndryshimet kryesore kanë të bëjnë me reduktimin e forcave të punës si dhe ndryshimi i strukturës së punësimit. Në vitin 2002, për herë të parë, u vërejt një shifër në ulje për numrin e përgjithshëm të të punësuarve në sektorin privat bujqësor, prej 526 mijë vetë. Kjo shifër është 235 mijë vetë më e ulët në krahasim me fundvitin 2001, prej 761 mijë vetë. Numri i të punësuarve në sektorin privat jobujqësor, si rezultat i migrimit të popullsisë fshatare drejt zonave urbane, është rritur me rreth 90-95 mijë persona.

Diferenca ndërmjet ndryshimeve në këta dy sektorë (atë bujqësor dhe jo bujqësor), prej rreth 140 mijë persona, ka ulur numrin e forcave të punës gjatë këtij viti dhe ka rritur shkallën e papunësisë, megjithëse në vlera absolute papunësia ka pësuar rënie gjatë gjithë vitit. Pra, rritja e punësimit në sektorin privat jobujqësor nuk ka qenë e mjaftueshme të kompensojë plotësisht forcën e lirë të punës që u krijua në sektorin privat bujqësor.

Box 3: NDRYSHIMET NË STATISTIKAT E PUNËS.

Viti 2002 shënoi disa ndryshime në matjen e treguesve të tregut të punës si rezultat i Regjistrimit të Popullsisë dhe Banesave i prillit vitit 2001. Ndryshimet më kryesore ishin:

Për punësimin në sektorin privat bujqësor të dhënat në vitin 2002 bazohen në rezultatet e Regjistrimit të Popullsisë dhe Banesave. Të dhënat deri në vitin 2001 janë bazuar në regjistrimin e përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore të vitit 1998. Regjistrimi i Popullsisë dhe Banesave solli disa ndryshime në strukturën e popullsisë. Sipas vendbanimit raporti i popullsisë urbane dhe rurale i vitit 1998, 39.8 për qind me 60.2 për qind lëvizi në 42.2 për qind dhe 57.8 për qind në vitin 2001. Kjo, solli si pasojë uljen e numrit të njësive ekonomike bujqësore të vrojtuar në vitin 1998. Për rrjedhojë, numri i të punësuarve erdhi në ulje nga rreth 761 mijë në 526 mijë.

Për punësimin në sektorin privat jobujqësor, të dhënat merren nga Inspektoriati Shtetëror i Punës pranë Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, kur më parë ato siguroheshin nga të dhënat e regjistrimit të ndërmarrjeve INSTAT.

Tabelë 8: Treguesit e tregut të punës¹¹

Treguesi	2001				2002			
	Tr.I	Tr.II	Tr.III	Tr.IV	Tr.I	Tr.II	Tr.III	Tr.IV
Forcat e punës gjithsej (në mijë)	1277	1263	1256	1247	1096	1093	1094	1094
A) Të punësuar gjithsej (në mijë)	1072	1071	1069	1065	918	917	919	921
a) në sektorin shtetëror	195	194	192	191	189	188	187	187
b) në sektorin privat jobujqësor	116	116	116	113	203	203	206	208
c) në sektorin privat bujqësor	761	761	761	761	526	526	526	526
B) Papunësia (në mijë)								
Të papunë gjithsej	205	192	187	182	178	176	175	173
Përfitojnë pagesë papunësie	21	18	16	15	13	13	12	11
Shkalla e papunësisë (në %)	16.0	15.2	14.9	14.6	16.211	16.1	16.0	15.8

Burimi: "Konjuktura", INSTAT, mars 2003.

Forcat e punës në fund të vitit 2002 ishin 1.1 milionë vetë, ndërsa në fund të vitit 2001, ishin 1.2 milionë vetë. Kjo përbën 36 për qind të numrit të përgjithshëm të popullsisë në Republikën e Shqipërisë.

Në fund të vitit 2002, vihet re se ndryshimet e forcave të punës, në krahasim me fillimin e vitit, janë tepër të vogla, duke shënuar një ulje me 2 mijë vetë. Ulja e mëtejshme e forcave të punës, në fund të vitit 2002, tregon se akoma forca të rëndësishme pune, duke përfshirë edhe ata që futen për herë të parë në tregun e punës, emigrojnë ose përfundojnë në tregun joformal të punës.

Në fund të tremujorit të katërt të vitit 2002 në krahasim me fillimin e vitit 2002, treguesi i punësimit shënon rritje prej 3 mijë vetash.

Rritja e treguesit të punësimit është rezultat kryesisht i rritjes së të punësuarve në sektorin privat jobujqësor. Kjo rritje arrin në 5 mijë vetë në fund të vitit 2002 në krahasim me fillimin e tij.

Një tregues i rëndësishëm brenda këtij sektori është edhe treguesi i punësimit në tregtinë me pakicë. Kjo për faktin se tregtia me pakicë ose tregtia e vogël siç njihet, vazhdon të mbizotërojë në sektorin privat jobujqësor, i cili zë rreth 22.5 për qind të të punësuarve. Ky nënsektor mendohet se punëson një pjesë të mirë të forcave të punës në sektorin privat të vogël, si atë tregtar edhe atë të shërbimeve. Punësimi në tregtinë me pakicë, gjatë vitit 2002, është rritur me 2.9 për qind në krahasim me fundin e vitit 2001.

¹¹ Llogaritjet pasqyrojnë ndryshimet në statistikat e tregut të punës.

Treguesit e papunësisë gjatë vitit 2002 janë pozitivë duke u karakterizuar nga ulja e vazhdueshme e papunësisë nga njëri tremujor në tremujorin pasardhës. Në fund të vitit 2002, në krahasim me fillimin e vitit, papunësia u ul me rreth 5 mijë persona, duke arritur në 173 mijë të tillë.

Gjatë vitit 2002 tregues pozitivë janë shënuar edhe në numrin e personave që përfitojnë pagesë papunësie. Në fund të këtij viti e përfituan këtë pagesë rreth 4 mijë persona më pak se në fund të vitit 2001. Kjo mendohet se ka ardhur si rezultat i ripunësimit të një pjese të këtyre personave (duke qenë se ata kualifikohen ose rikualifikohen gjatë periudhës kur regjistrohen si të papunë në zyrat e punës), sepse pagesa për këtë kategori njerëzish është shumë e ulët dhe e bën të pamundur jetesën vetëm me këto të ardhura.

II.3. ZHVILLIMET NË SEKTORIN FISKAL.

II. 3. 1. KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME.

Synimi për konsolidimin fiskal ka qenë në qendër të programit ekonomik të qeverisë gjatë vitit 2002. Ky konsolidim do të arrihej nëpërmjet zgjerimit të bazës tatimore dhe rritjes së aftësisë së autoriteteve përkatëse për mbledhjen e tatimeve, për reduktimin e shpenzimeve buxhetore dhe për rritjen e efektshmërisë së tyre.

Një zhvillim i rëndësishëm në politikën ekonomike të vendit këtë vit ishte vendosja e objektivave fiskalë të qeverisë për një periudhë afatmesme duke synuar që deficitin buxhetor të vendit të arrijë nivelin 5.8 për qind të PBB-së në fund të vitit 2005.

Viti 2002 regjistroi një deficit buxhetor më të ulët se parashikimi rreth 6.2 për qind të PBB-së, duke vijuar tendencën në rënie të tij gjatë viteve të fundit. Të ardhurat dhe shpenzimet për vitin 2002 priteshin të ishin përkatësisht 23.4 dhe 31 për qind të PBB-së, ndërkohë që për to u arrit një raport përkatësisht 22.9 dhe 29.1 për qind.

Tabelë 9: Tregues fiskalë në përdindje ndaj PBB-së.

	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002
Të ardhurat	24.1	23.4	16.3	17.02	22.0	22.0	21.9	23.0	22.9
nga këto: të ardhura tatimore	16.0	13.2	10.7	9.8	12.3	12.9	15.6	15.6	15.7
Shpenzimet	33.1	33.6	31.3	27.7	30.2	33.3	30.9	31.5	29.1
Shpenzime kapitale	3.4	8.3	4.9	4.2	5.7	5.8	6.6	7.4	5.6
Deficiti buxhetor	-9.0	-10.2	-11.4	-13.2	-11.3	-11.9	-9.1	-8.6	-6.2
Financim i brendshëm	8.6	6.5	9.0	11.3	6.5	6.9	5.4	4.8	3.2
Financim i jashtëm	0.4	3.7	2.4	1.9	4.8	6.2	3.7	3.8	3.0

Të ardhurat buxhetore në vlerë absolute u rritën 11.4 për qind krahasuar me një vit më parë, por realizimi i tyre sipas planit ishte 95 për qind. Mosrealizime të shifrave të planifikuara në planin buxhetor vërehen si përsa i përket mbledhjes së të ardhurave nga doganat ashtu edhe nga ato të tatimeve. Nga ana tjetër, qeveria është treguar e kujdesshme në mbajtjen nën kontroll të shpenzimeve buxhetore. Krahasuar me një vit më parë, ato u rritën vetëm me 3.2 për qind në vlerë absolute, ndërsa realizimi i tyre sipas planit buxhetor ishte 90 për qind.

Tabelë 10: Realizimi i treguesve fiskalë sipas planit, në për qind.

	2001	2002
Të ardhura gjithsej	96	95
Tatimore	96	92
Jotatimore	91	107
Kontribute shoqërore	97	98
Shpenzime gjithsej	95	90
Korente	99	98
Kapitale	96	73
Deficiti buxhetor	92	77

II.3.2. TË ARDHURAT BUXHETORE.

Të ardhurat buxhetore për vitin 2002 rezultuan pothuajse në të njëjtin raport ndaj PBB-së sikurse edhe një vit më parë. Ndonëse, sipas planit buxhetor ishte parashikuar që të ardhurat nga tatimet e Qeverisë qendrore dhe pushtetit lokal të siguronin 71 për qind të të ardhurave totale, ky zë arriti vetëm 68.5 për qind të të ardhurave. Niveli i realizimit të tyre këtë vit pësoi një rënie të lehtë duke arritur në 92 për qind, prej 96 për qind vitin e kaluar.

Tabelë 11: Struktura e të ardhurave buxhetore, në për qind.

	1998	1999	2000	2001	2002
Të ardhurat në total	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0
Të ardhurat nga tatimet dhe doganat	59.9	60.0	68.6	66.2	66.7
TVSH	30.8	27.7	31.6	30.4	30.6
Tatim mbi fitimin	4.6	5.6	6.7	7.6	8.1
Akcizat	5.3	6.5	7.6	7.0	6.2
Tatim mbi biznesin e vogël	1.0	1.1	1.4	1.5	1.7
Tatim mbi të ardhurat personale	1.2	2.9	3.8	4.6	4.1
Taksa nacionale	3.3	3.7	4.8	5.1	6.7
Taksa doganore	13.5	10.7	11.2	9.4	8.9
Taksë solidariteti	0.2	1.8	1.5	0.6	0.5
Të ardhura nga pushteti lokal	0.8	0.8	1.1	1.5	1.8
Kontribute	16.9	16.9	16.6	16.6	17.0
Të ardhura jotatimore	22.2	22.1	13.7	15.6	14.6

Vihet re se pesha e të ardhurave nga doganat ka rënë krahasuar me vitet e kaluara. Për vitin 2002, këto të ardhura janë 91 për qind e atyre të planifikuara.

II.3.3. SHPENZIMET BUXHETORE.


Shpenzimet buxhetore në përqindje ndaj PBB-së janë ulur nga 31.5 për qind në vitin 2001 në 29.1 për qind në vitin 2002. Shpenzimet korente zunë rreth 81 për qind të shpenzimeve në total, ndërkohë që sipas planit buxhetor ky raport parashikohej 74.6 për qind. Pjesa tjetër e buxhetit do të përdorej për shpenzime kapitale. Në fakt, këto të fundit zunë vetëm 19.4 për qind të shpenzimeve në total duke shënuar një normë realizimi në masën 73 për qind. Krahasuar me një vit më parë, shpenzimet kapitale janë ulur me 13.8 për qind.

Tabelë 12: Struktura e shpenzimeve buxhetore, në për qind.

	1998	1999	2000	2001	2002
Shpenzimet në total	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0
Shpenzime korente	82.9	79.1	78.1	76.0	80.6
Personeli	20.0	18.8	19.5	22.2	21.9
Mirëmbajtje	13.1	12.1	11.3	13.5	10.7
Subvencione dhe sig. shoqërore të tjera	17.2	20.5	21.9	23.6	24.2
Interesa	25.3	21.1	17.3	13.0	12.9
Të tjera	5.7	5.0	5.0	4.7	4.5
Shpenzime kapitale	17.1	20.6	21.3	23.2	19.4
Rikonstruktim të bankës	-	0.3	0.6	0.8	-


Qeveria reduktoi shpenzimet buxhetore për të siguruar respektimin e objektivave sasiore fiskale. Ky reagim u diktua nga mungesa e të ardhurave të privatizimit dhe vështirësia për financimin e deficitit buxhetor, si rezultat i situatës së likuiditetit të krijuar në tregun bankar.

Grafik 7: Norma e ndryshimit vjetor të shpenzimeve buxhetore.



Muaji dhjetor ishte periudha e vetme kur niveli i shpenzimeve mujore ishte mbi atë të parashikuar në planin buxhetor. Niveli më i lartë i shpenzimeve buxhetore në muajin dhjetor krahasuar me muajt e tjerë të vitit është një nga tiparet e këtij treguesi. Vihet re se pas vitit 1997, pesha e shpenzimeve në muajin dhjetor ndaj shpenzimeve vjetore është pothuajse e njëjtë në çdo vit.


Grafik 8: Pesha e shpenzimeve buxhetore në muajin dhjetor ndaj totalit të shpenzimeve vjetore.



II.3.4. DEFICITI BUXHETOR DHE FINANCIMI I TIJ.

Deficiti buxhetor në vitin 2002 rezultoi 19.4 për qind më i ulët sesa ai për vitin e kaluar dhe 1.3 pikë përqindjeje më poshtë sesa parashikimi për të. Ky tregues arriti shifrën 40.8 miliardë lekë, 12.2 miliardë lekë nën nivelin e parashikuar për të në planin buxhetor. Kjo rënie është në vazhden e një tendence të reduktimit të deficitit buxhetor gjatë viteve të fundit.

Grafik 9: Niveli i deficitit buxhetor (në miliardë lekë) dhe ndryshimi vjetor, në për qind.




Përsa i përket financimit të deficitit buxhetor, rreth 51.4 për qind e tij është mbuluar nga burime të brendshme dhe pjesa tjetër nga burime të huaja. Niveli i financimit të brendshëm është 1.4 miliardë lekë mbi atë të parashikuar në planin buxhetor, ndërsa financimi i jashtëm është rreth 12 miliardë lekë nën shifrën e planifikuar për të. Në total, borxhi i brendshëm i qeverisë në vitin 2002 është rritur me 9.6 për qind krahasuar me një vit më parë, kur një pjesë e financimit të brendshëm (financimi i brendshëm në vitin 2001 ishte 56.3 për qind e deficitit buxhetor) u mbulua nga të ardhurat nga privatizimi.

Mungesa e të ardhurave nga privatizimi, bëri që barra kryesore për mbulimin e deficitit buxhetor me mjete të brendshme t'i mbetej sistemit bankar. Por, në muajin mars, tërheqja masive e depozitave nga bankat tregtare solli mungesë likuiditeti në sistem dhe si rrjedhim, edhe ndryshim në strukturën e financimit të brendshëm të deficitit buxhetor. Për të ruajtur stabilitetin e sistemit financiar në vend, Banka e Shqipërisë ndryshoi orientimin e objektivit kryesor të saj, ruajtjen e stabilitetit të çmimeve. Ajo siguroi likuiditet të mjaftueshëm në treg dhe për më tepër, u pozicionua si huadhënësia kryesore e qeverisë gjatë gjysmës së parë të vitit. Financimi ishte në formën e kredisë direkte dhe blerjes me të drejta të plota të bonove të thesarit. Në fund të gjashtëmujorit të parë, financimi i Bankës së Shqipërisë arriti në 6 miliardë lekë duke qenë pranë kufirit të lejuar nga ligji, prej 6.06 miliardësh¹².

¹² Sipas ligjit "Për Bankën e Shqipërisë", kufiri i lejuar për financimin e deficitit buxhetor është niveli 5 për qind i të ardhurave mesatare buxhetore për tre vitet e fundit.

Grafik 10: Financimi i brendshëm i deficitit buxhetor me bono thesari, në miliardë lekë.¹³



Tabelë 13: Tregues përmblendhës të buxhetit (në miliardë lekë).

Treguesit	2000	2001	2002	Plani 2002
Të ardhurat në total	120.6	135.5	150.9	159.4
- të ardhura tatimore	84.1	91.8	103.3	112.8
- kontribute të sigurimeve shoqërore	20.0	22.5	25.6	26.1
- të ardhura jotatimore	16.5	21.2	22.0	20.5
Shpenzimet në total	170.6	185.9	191.7	212.3
- shpenzime korente	133.3	141.0	154.6	158.5
- shpenzime kapitale	36.3	43.0	37.1	50.8
- rikonstruktim i bankës	1.0	1.9	-	-
Deficiti buxhetor	-50.0	-50.4	-40.8	-52.9
- financim i brendshëm	18.5	28.3	21.0	20.7
- financim i huaj	17.5	22.1	19.8	32.1

II.4. ZHVILLIMET NË INFLACION DHE POLITIKA MONETARE.

II.4.1. INFLACIONI NË SHQIPËRI NË VITIN 2002.


Viti 2002, u mbyll me një normë vjetore për inflacionin 2.1 për qind, duke siguruar respektimin e objektivit të Bankës së Shqipërisë, brenda intervalit të dëshiruar 2-4 për qind. Megjithatë, inflacioni mesatar vjetor në vitin 2002 shënoi një shifër më të lartë prej 5.4 për qind.

¹³ Burimi i të dhënave: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 14: Norma vjetore e inflacionit.

	1999	2000	2001	2002
Janar	6.0	-1.3	2.2	6.5
Shkurt	3.5	-1.3	1.5	7.7
Mars	2.0	-2.1	2.9	7.6
Prill	0.4	-1.4	3.0	6.6
Maj	-0.1	-0.1	2.5	4.6
Qershor	-0.6	0.1	4.0	3.8
Korrik	0.1	-1.3	5.6	4.3
Gusht	-0.6	-0.7	4.1	5.5
Shtator	-1.9	0.9	3.5	5.4
Tetor	-1.8	1.8	1.8	6.1
Nëntor	-1.2	1.9	2.8	4.1
Dhjetor	-1.0	4.2	3.5	2.1
Inflacioni mesatar	0.4	0.1	3.1	5.4

Grafik 11: Norma vjetore e inflacionit, objektivi dhe norma mesatare e tij, në për qind.



Muajt e parë të vitit 2002 manifestuan norma të larta inflacioni në bazë vjetore, madje më të larta sesa objektivi i Bankës së Shqipërisë. Në muajt janar- prill inflacioni vjetor lëvizi në vlera vjetore 6.5-7.7 për qind. Inflacioni i kësaj periudhe vazhdoi të ndikohet nga grupi “qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” kryesisht si rezultat i rritjes së çmimit të energjisë elektrike në dhjetorin e vitit 2001. Tremujori i dytë u karakterizua nga një tendencë e pazakontë rënëse e normës mujore dhe vjetore të inflacionit. Inflacioni në këtë tremujor arriti vlerën mesatare prej -1.06. Banka e Shqipërisë ka vlerësuar se faktori sezonal, që historikisht ndikon në kahun rënës të inflacionit gjatë periudhës së verës, në vitin 2002, u zhvendos rreth një muaj më përpara në kohë. Rënia e ndjeshme e çmimeve në muajt maj dhe qershor shpjegohet me ndikimin e efektit sezonal të grupit të mallrave ushqimorë, që u ndje më shpejt sesa zakonisht.

Edhe në tremujorin e tretë inflacioni shënoi një devijim nga sjellja historike, duke shënuar vlera më të larta sesa ato të viteve të kaluara. Në mënyrë të veçantë u rritën çmimet e shërbimeve dhe të mallrave ushqimorë të nëngrupit “restorante dhe hotele”. Në tremujorin e katërt të vitit 2002, norma e inflacionit pati një zhvillim pothuajse normal. Rritja e tarifave të reja arsimore në sektorin publik dhe privat bëri që gjatë muajit tetor norma mujore e inflacionit të ishte më e lartë se norma mujore e inflacionit të muajit tetor 2001. Muaji dhjetor i vitit 2002 u karakterizua nga një normë e inflacionit më e ulët se dy vitet paraardhës, prej 3.2 për qind, duke e sjellë atë më pranë mesatares historike prej 2.43 për qind, por ndjeshëm më e lartë se gjithë muajt e tjerë të vitit 2002.


Duhet theksuar se dy vlerat, dukshëm të ulëta, të normave mujore të inflacionit, në muaj maj dhe nëntor, përkatësisht -1.6 dhe 0.0, ndikuan edhe në kthesat rënëse të inflacionit vjetor.

II.4.2. ZHVILLIMET E INFLACIONIT SIPAS GRUPEVE KRYESORE.

Ecuria e inflacionit total edhe gjatë vitit 2002 është përcaktuar nga ecuria e çmimeve të grupit të mallrave të tregtueshëm, ku peshën kryesore e zënë grupet e mallrave ushqimorë.


Brenda grupit të mallrave ushqimorë, grupi që dha ndikimet më të forta në vlerat e inflacionit ishte grupi “ushqim dhe pije joalkolike”.

Grafik 12: Norma vjetore e inflacionit e dy nëngrupeve kryesore të grupit “ushqim dhe pije joalkolike”.




Grupi tjetër më i rëndësishëm, bazuar në peshën që zë në shportën e indeksit të çmimeve të konsumit, është “qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji”. Peshë e këtij grupi në shportën e re u rrit së tepërmi, si rezultat i shtimit në këtë grup të konceptit të “qirasë së imputuar”. Rritja e çmimit të energjisë në dhjetorin e vitit 2001, u reflektua në rritjen e indeksit të çmimit të të gjithë grupit. Megjithatë, gjatë këtij viti ky grup është karakterizuar nga çmime të qëndrueshme, ndërkohë që për nëngrupe të veçanta, si ai i qirasë, u pa një rënie e vazhdueshme pas një rritjeje të dukshme në fillim të vitit.

Grafik 13: Norma vjetore e inflacionit të grupit “ qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji”.



Ndër grupet e tjera që kanë dhënë ndikim në normën vjetore gjatë vitit 2002, vlen të përmenden edhe grupi “hotele, kafene dhe restorante”, “komunikim” dhe “shërbim arsimor”. Ndikimin më të madh këto tre grupe e patën sidomos në tremujorin e tretë. Në rritjen e indeksit të çmimeve të këtyre grupeve ndikuan, gjithashtu, edhe grupet “hotele, kafene dhe restorante”, si rezultat i shtimit të turistëve të huaj (kryesisht nga Kosova) dhe emigrantëve që kthehen në atdhe për të kaluar pushimet, fakt i cili çoi në rritjen e çmimeve të shërbimeve dhe mallrave të nëngrupit “restorante dhe hotele”. Vlen të përmendet fakti që grupi “shërbim arsimor”, ndonëse me peshë jo të madhe në shportën e IÇK-së, manifestoi një rritje të ndjeshme në periudhën e fillimit të vitit shkollor, si pasojë e rritjes së çmimeve në arsimin shtetëror dhe privat. Kalimi i kësaj periudhe bëri që çmimet në këtë grup, në muajin dhjetor, të stabilizohen. Inflacioni i grupit “komunikim” u reduktua gjatë gjithë vitit 2002 si pasojë e paketave promovuese të ofruara nga operatorët e telefonisë celulare.

Grafik 14: Norma vjetore e inflacionit të grupeve “komunikim”, “shërbim arsimor” dhe “hotele, kafene dhe restorante”.



II.4.3. FAKTORËT QË NDIKUAN NË ECURINË E INFLACIONIT.

Periudha 2000-2002, në përgjithësi ka patur prirje për rritje të presioneve inflacioniste, e shfaqur jo vetëm në rritje të inflacionit vjetor mesatar, por edhe me vlerat më të larta të muajve. Këto presione ishin më të dukshme gjatë vitit 2002. Prej fillimit të vitit u identifikuan disa faktorë që mund të rrezikonin objektivin e inflacionit si:

Faktorë që ndikojnë kërkesën:


- rritja e parasë në qarkullim dhe e agregatit M1;
- shtimi i shportës së monedhave të huaja, me një monedhë të re;
- çmimet më të larta të importit;
- festat e fundvitit;
- pasiguria në ecurinë e kursit të këmbimit.

Faktorë që ndikojnë ofertën:

- situata energjitike, e cila vazhdonte të ishte e pasigurtë;
- vendosja e taksave të reja;
- moti i keq.

Përveç këtyre faktorëve, i veçantë për vitin 2002 ishte edhe fakti se indeksi i çmimeve të konsumit, filloi të llogaritej me shportën e re të mallrave dhe shërbimeve. Efekti statistikor i përfshirjes së artikujve të rinj në shportë, ndikoi në kahun zbritës për gjysmën e parë të vitit 2002 dhe në kahun rritës për gjysmën e dytë, me një rezultat vjetor të vogël rritës prej 0.3 pikë përqindjeje.

Grafik 15: Norma mujore e inflacionit me peshat e reja dhe të vjetra, në për qind për vitin 2002.



Box 4: SHPORTA E RE PËR MATJEN E INDEKSIT TË ÇMIMEVE TË KONSUMIT.

Indeksi i çmimeve të konsumit, duke filluar nga muaji janar 2002 u llogarit me shportën dhe peshat e reja të mallrave dhe shërbimeve, bazuar në rezultatet e anketës së Buxhetit të Familjes së kryer në Shqipëri gjatë vitit 2000. Në shportën e re të IÇK-së numri i përgjithshëm i artikujve të zgjedhur shkoi në 262 nga 221 artikuj që kishte shporta e mëparshme. Indeksi i ri llogaritet mbi bazën e 12 grupeve kryesore nga 8 të tilla që ekzistonin në shportën e vjetër. Grupi kryesor në shportën e mëparshme “ushqim, pije dhe duhan” u nda në tre grupe: “ushqim dhe pije joalkolike”, “pije alkolike dhe duhan” dhe “hotele, kafene dhe restorante”.

Tabelë 15: Struktura e peshave në shportën e vjetër dhe të re, në për qind.

		E vjetër	E re
1	Ushqime dhe pije joalkolike	69	43
2	Pije alkolike dhe duhan	3	3
3	Veshje dhe këpucë	3	4
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	6	24
5	Pajisje shtëpiake, mobilim dhe mirëmbajtje	8	5
6	Shëndeti	1	2
7	Transport	4	5
8	Komunikim	1	1
9	Argëtim dhe kulturë	3	3
10	Shërbim arsimor	1	1
11	Hotele, kafe dhe restorante	1	7
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	0	2

Indeksi ka një zgjedhje qytetesh të ngjashme me strukturën zyrtare të prefekturave të përdorura nga qeveria për raporte të tjera statistikore në nivelin urban. Duke patur parasysh këtë fakt, gjatë vitit 2002 **shporta e re**, mendohej se do të pasqyronte një strukturë të ndryshuar të konsumit mesatar të familjeve shqiptare.

Në realitet, ecuria e inflacionit total edhe gjatë vitit 2002 është përcaktuar nga ecuria e çmimeve të grupit të mallrave të tregtueshëm, ku peshën kryesore e zënë grupet e mallrave ushqimorë.

Grupi tjetër më i rëndësishëm, bazuar në peshën që zë në shportën e indeksit të çmimeve të konsumit, është “qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji”. Pësja e këtij grupi në shportën e re u rrit së tepërmi, duke bërë që ky grup të jetë përcaktues në ecurinë e indeksit të përgjithshëm. Kjo rritje erdhi si rezultat i shtimit në këtë grup të konceptit të “qirasë së imputuar”. Qiraja e imputuar është një shpenzim potencial që kryhet nga ana e konsumatorit shqiptar për qira banimi. Ndër arsyt kryesore të përfshirjes në shportën e re të mallrave dhe të shërbimeve të “qirasë së imputuar”, përmenden:

- nga anketa e buxhetit të familjeve u vërejt se shpenzimet për këtë nëngrup të shportës zinin një peshë të madhe në shpenzimet mesatare të konsumatorit shqiptar;
- rreth 93 për qind e qytetarëve shqiptarë rezultuan pronarë të shtëpive të tyre, fakt që i shndërron ata në qiradhënës potencialë të shtëpive të tyre në çdo moment të muajit. Pamundësia për ta matur këtë zë të konsumit, në çdo muaj, zgjidhet me anë të zërit “qira e imputuar”.

Gjykohet se informacioni për inflacionin, i matur mbi shportën e re, është më realist. Ky fakt është i dukshëm po të studiojmë luhatjen e indeksit mujor të inflacionit të matur me peshat e vjetra dhe me peshat e reja. Matja e re ka sheshuar luhatjet sezonale duke shtuar mundësinë për të bërë parashikime më të sakta.


Ndër faktorët më të rëndësishëm që ndikuan në normën vjetore të inflacionit për vitin 2002 mund të përmendim:

1. Zhvillimet monetare


Qëndrueshmëria financiare e vendit pësoi tronditje në gjysmën e parë të vitit 2002. Sistemi bankar u përball me një tërheqje të ndjeshme depozitash, në periudhën mars-prill, gjë që bëri që paraja jashtë bankave të rritet me 15 për qind, duke rritur presionet inflacioniste në ekonomi.

Shtërngimi i politikës monetare ndikoi në normalizimin e treguesve monetarë në periudhën gusht-dhjetor dhe në përcaktimin e tendencës rënëse të inflacionit vjetor gjatë muajve të fundit të vitit 2002. Duke filluar nga muaji gusht, M1 real është poshtë tendencës historike. Raporti i parasë jashtë bankave ndaj ofertës monetare është ulur përgjatë gjithë kësaj periudhe në 31.4 për qind dhe në muajin dhjetor iu afrua objektivit për fundin e vitit prej 31 për qind.


Grafik 16: Ecuria e likuiditetit në ekonomi; norma vjetore e ndryshimit të M1 real.



Grafik 17: Raporti i parasë jashtë bankave ndaj M3.




Grafik 18: Norma e rritjes vjetore të parasë jashtë bankave.



2. Kursi i këmbimit

Ecuria e kursit të këmbimit paraqiti pasiguri në tremujorin e parë të vitit si rezultat i futjes së euros në treg. Gjithashtu, nënçmimi më i lartë i lekut ndaj dy monedhave në muajin maj, që vlerësohet të jetë shkaktuar kryesisht, nga momenti i vështirë nëpër të cilin po kalonte sistemi bankar, ndikoi në kahun rritës të inflacionit, deri në muajin korrik 2002. Pikërisht, në këtë muaj euro u barazua për herë të parë me dollarin amerikan. Periudha deri në fund të vitit, u karakterizua nga një sjellje pothuaj simetrike e kursit të këmbimit. Gjatë vitit 2002, euro kundrejt lekut u mbiçmua ndërsa dollari u nënçmua. Vlerësohet se sjellja e kursit të këmbimit (në terma mesatarë vjetorë) gjatë gjysmës së dytë të vitit 2002, të paktën nuk ndikoi në shtimin e presioneve inflacioniste.

Grafik 19: Ndryshimet vjetore të kursit të këmbimit lek/usd dhe lek/euro.



3. Shpenzimet buxhetore

Shpenzimet buxhetore janë mbajtur nën kontroll gjatë gjithë vitit 2002. Efekti i shpenzimeve buxhetore, është vlerësuar që vepron me rreth 5-6 muaj vonesë mbi normën e inflacionit. Kështu, shpenzimet e muajit qershor-korrik 2002 janë realizuar në masën 87 për qind të planit duke mos ndikuar në këtë mënyrë në rritjen e normës së inflacionit të fundvitit.

4. Inflacioni i importuar

Inflacioni i importuar mendohet të ketë ushtruar ndikim në rritje. Inflacioni në vendet e Eurozonës, rezultoi më i lartë sesa parashikimi prej 2 për qind në nivel vjetor. Kjo ndikoi në rritjen e çmimeve të mallrave të importuar. Një veçori e vitit që kaloi, ishte zhurma për rritjen e inflacionit si pasojë e futjes së euros fizike, në pothuajse të gjitha vendet e Bashkimit Europian.

Box 5: A ISHTE VITI 2002, VIT I RITJES DRASTIKE TË ÇMIMEVE NË EUROPËN E BASHKUAR?

Një vit pas hyrjes fizike në treg të euros, shumë konsumatorë vazhdojnë të shprehin se “ndiejnë” rritjen e shpejtë të çmimeve. Të shumta kanë qenë protestat e qytetarëve të Europës gjatë vitit të shkuar, të cilët ndihen të shqetësuar për këtë dukuri që ka prekur të gjitha vendet e Europës.

Nga ana tjetër, statistikatat zyrtare europiane flasin për një rritje të lehtë të normës vjetore të inflacionit, e cila kaloi me 0.2 pikë përqindjeje objektivin prej 2 për qind të Bankës Qendrore Europiane.

Në realitet, çmimet e shumë produkteve dhe shërbimeve u rritën në mënyrë të ndjeshme. Koha e keqe në shumë vende të Europës shkatërroi shumë produkte bujqësore. Taksat më të larta rritën ndjeshëm çmimin e duhanit dhe të mallrave të luksit. Çmimet e transportit urban u rritën në disa raste edhe me tre herë. Disa biznesmenë të pandershëm rritën çmimet vetëm duke bërë një “rumbullakosje” të thjeshtë në konvertimin e vlerës së monedhës vendase në euro, pa respektuar kursin e këmbimit përkatës.

Por, ekonomistët vërejtën se për çdo rritje të çmimeve të mallrave kryesisht ushqimorë, pati rënie të ndjeshme në mënyrë të veçantë për pajisjet elektronike dhe elektroshtëpiake. Gjithashtu, çmimi i energjisë elektrike ishte i qëndrueshëm, për shkak të mbiçmimit të euros kundrejt dollarit. Në Itali, ku u verifikua më tepër se në vendet e tjera kjo dukuri, vlerësohet se ajo ka ndikuar vetëm 0.2 pikë përqindjeje në rritjen e normës së inflacionit.

Ekonomistët janë të qartë tashmë se ndryshimi i madh ndërmjet perceptimit për çmimet nga ana e publikut me atë të nivelit real të tyre është thjesht **një dukuri psikologjike**. “Konsumatorët vërejnë se janë rritur çmimet e mallrave dhe të shërbimeve për të cilët ata paguajnë në *cash* ose i blejnë rregullisht, por ata nuk vërejnë se janë ulur ndjeshëm çmimet e blerjes të makinave apo të kompjuterave”.

Burimi: David Fairlamb; Gail Edmondson: Business Week, 16 shtator 2002.

Çmimet më të larta të mallrave ushqimorë në vendet partnere kanë dhënë ndikim rritës në normën e inflacionit në Shqipëri, ku struktura e shportës së indeksit të çmimeve të konsumit, në ndryshim nga vendet europiane, vazhdon të përbëhet në pjesën më të madhe të saj nga këto lloj mallrash. Ato, gjithashtu, kanë dhënë efekt negativ edhe në krijimin e **zhurmës për rritjen e çmimeve të referencës** nëpër dogana, të cilat në njëfarë mase mund të kenë dëmtuar ndikimin e pritshëm të fushatës për frenimin e faktorëve spekulativë në treg, në fund të vitit.

5. Faktorë specifike

Si disa faktorë specifike që kanë ndikuar në rritjen e inflacionit të vitit 2002 mund të përmendim:

- inflacioni i vitit që sapo mbyllëm, **vijoi të reflektojë rritjen e çmimit të energjisë elektrike, të aplikuar në dhjetor të vitit 2001**, në mënyrë të drejtpërdrejtë në sektorin e mallrave të patregtueshëm. Sipas vlerësimeve, kjo rritje është transmetuar gradualisht dhe tërthorazi edhe në sektorin e mallrave të tregtueshëm, pothuajse gjatë gjithë tremujorit të parë të vitit 2002;
- **situata energjitike e pastabilizuar**, konsiderohet si faktor që mbajti nën tension të vazhdueshëm ecurinë e çmimeve të konsumit, kryesisht në drejtimin rritës, sidomos në sektorin e shërbimeve edhe gjatë vitit 2002. Ndikimi ka qenë më i fortë gjatë muajve të parë të vitit, si edhe në periudhën e korrik-gushtit;
- **moti i ftohtë i fillimvitit si edhe përmbytjet e muajit shtator** ndikuan në rritjen e çmimeve të transportit dhe, për rrjedhojë, edhe të çmimeve të produkteve ushqimore;
- **situata e panikut e krijuar në sistemin bankar shqiptar.**

Box 6: SEKTORËT E MALLRAVE TË TREGTUESHËM DHE TË PATREGTUESHËM DHE INFLACIONET E TYRE.


Gjatë vitit 2002, në Bankën e Shqipërisë, studimi i inflacionit u thellua në drejtim të ekzaminimit të kontributit në inflacionin total të sektorit të mallrave të tregtueshëm dhe të patregtueshëm.

Sektorin e mallrave të tregtueshëm, është mjaft i ekspozuar ndaj konkurrencës. Ky fakt shpjegon një karakteristikë mjaft të dallueshme të çmimeve të mallrave që bëjnë pjesë në të: atë që devijimet ndërmjet çmimeve të tyre janë të vogla. Diferencat midis çmimeve të mallrave të tregtueshëm kanë tendencë të pastër rënëse: sa më shumë shtohen kërkesat për të siguruar dhe për të rritur fitimet nga rritja e produktivitetit. Është rritja e fortë dhe e shpejtë e produktivitetit në kushtet e një konkurrence të plotë, që realizon këtë tendencë.

Sektorin e mallrave të patregtueshëm apo sektorin “nën strehë”, siç mund edhe të quhet në mënyrë figurative për shkak të veçorisë që ai paraqet, është ai sektor në të cilin kostot shtesë që kontribuojnë në rritjen e produktivitetit, pasqyrohen shumë më dukshëm në rritjen e pagave dhe për pasojë, në atë të çmimeve.

Nëse do të krahasoheshin dy sektorët nga pikëpamja e kostove marzhinale që kontribuojnë në rritjen e produktivitetit, do të konkludohej se ato janë mjaft të ndryshme ndërmjet tyre: kostoja marzhinale në sektorin e mallrave të patregtueshëm është, në pjesën më të madhe të rasteve, disa herë më e lartë sesa ajo në sektorin e mallrave të tregtueshëm. Në termat e inflacionit, kjo do të thotë që një rritje kostojeje, me qëllim rritjen e produktivitetit, në sektorin e mallrave të patregtueshëm pasqyrohet më me intensitet dhe në madhësi më të lartë në rritjen e pagave në këtë sektor, pra çmime më të larta, për pasojë nivele më të larta inflacionesh në këtë sektor.

Grafik 20: Ndryshimet mujore të indeksit të çmimeve sipas sektorëve.



Në mënyrë empirike u konkludua se:

- për gjithë periudhën e studiuar 1994 - 2002, nëse krahasohen të dy sektorët, është sektori i mallrave të tregtueshëm ai që i jep tendencat kryesore të inflacionit total;
- inflacioni i sektorit të mallrave të patregtueshëm ka shpjeguar në masën 7.8 për qind atë të mallrave të tregtueshëm dhe kjo lidhje ka ardhur duke u forcuar në 4 vitet e fundit;
- periudha 1998 – 2002 ka evidentuar një sezonalitet relativisht të fortë në muajt dhjetorë për mallrat e tregtueshëm. Ai vlerësohet të rrisë inflacionin e këtij grupi me rreth 3.6 pikë përqindjeje mbi ecurinë mesatare të muajve dhjetorë. Inflacioni në fund të vitit, për shkak të faktorit sezonal, i dalë nga dy sektorët së bashku, vlerësohet të rritet mesatarisht me 2.5 pikë përqindjeje.

Nga ana tjetër, ndikimi i grupeve të veçanta tek njëri-tjetri dhe mbi inflacionin total, paraqet mjaft interes për të parë ndikimet në inflacionet aktuale dhe në ato të pritshme. Studimi tregoi se ka ardhur koha që inflacioni të mos ketë për objekt vetëm mallrat e tregtueshëm, por edhe ata të patregtueshëm. Rezultatet empirike mbështesin një model më të plotë për parashikimin e inflacionit duke u nisur nga përfundimet përkatëse për secilin sektor. Konkretisht, analizat regresive hedhin dritë për:

- parashikimin e inflacionit të sektorit të mallrave të tregtueshëm nëpërmjet ndryshimit të çmimeve të mallrave të importit. Për më tepër, ky përfundim vlen të konsiderohet, kur dihet që pesha e mallrave të tregtueshëm në importe vlerësohet të jetë ende e konsiderueshme;
- parashikimin e inflacionit të sektorit të mallrave të patregtueshëm nëpërmjet variablave të tillë si shpenzimet buxhetore dhe normat e interesit të depozitave të sistemit bankar.

Është shumë e rëndësishme që parashikimet të marrin parasysh rritjet e pritshme të çmimeve në sektorin e mallrave të patregtueshëm, në mënyrë që të vlerësohet si ndikimi mbi çmimet e mallrave të tregtueshëm, ashtu edhe mbi inflacionin total. Kjo bëhet më e evidente, sidomos, kur bëhet fjalë për rritje të pritshme të çmimeve të energjisë elektrike dhe të ujit, pa lënë mënjanë lëvizjet në çmimet e qirave.


Disa nga faktorët specifikë që ndikuan në zbutjen e presioneve inflacioniste gjatë vitit 2002 mendohet të kenë qenë:

- rritja e normave të interesit nga Banka e Shqipërisë në muajt mars dhe prill të vitit 2002 ka kontribuar në thellimin e diferencës midis interesave të lekut me monedhat e huaja kryesore të tregut, që ka çuar në norma

interesi reale të larta. Kjo ka ndikuar në vendimet investuese të individëve duke ndihmuar në zbutjen e presioneve inflacioniste;

- **situata e relativisht e qëndrueshme politike** sidomos në gjysmën e dytë të vitit 2002, gjithashtu, ka ndikuar në mbajtjen e inflacionit nën kontroll;
- një rol për uljen e inflacionit në muajin dhjetor luajti **fushata e nisur nga Banka e Shqipërisë** për të sensibilizuar konsumatorët dhe tregtarët për rritjen spekulative të çmimeve në pragfesta. Faktori sezonal spekulativ i muajit dhjetor, u zbut, duke u verifikuar vetëm në 90 për qind të vlerës historike të tij të katër viteve të fundit. Rritja mujore e inflacionit, në dhjetor të vitit 2002, ishte më e ulët se pritshmëria.

Grafik 21: Ecuria e normës mujore të inflacionit në muajin dhjetor dhe mesatarja historike, në për qind.



Box 7: FUSHATA PËR TË ZBUTUR FENOMENIN E SPEKULIMIT ME ÇMIMET.

Në periudhën 26 nëntor 2002 – 10 janar 2003, Banka e Shqipërisë organizoi për herë të parë fushatën për të ndikuar në zbutjen e fenomenit të spekulimeve me çmimet. Në dy-tre vitet e fundit rritja e kërkesës së konsumatorëve për disa produkte të caktuara shoqërohej me rritje të çmimeve të këtyre produkteve. Intensiteti i rritjes së çmimeve ishte i fortë në prag të festës së Vitit të Ri. Kjo rritje çmimesh ndodhte pavarësisht se muaji dhjetor shënon edhe importe më të larta në këto produkte. Kjo do të thotë që rritja e çmimeve shkactohej si pasojë e faktit që kërkesa konsumatore paraqitej joelastike. Burimi i kërkesës joelastike është tradita në festimin e festës së Vitit të Ri si dhe përqendrimi i disa festave në fund të vitit. Burimi i rritjes së çmimeve, edhe në kushtet e ofertës së shtuar, është natyra spekulative e tregjeve shqiptare, konkurrenca e dobët në to dhe mungesa e transparencës në vendosjen dhe publikimin e çmimeve. Rezultati i këtij fenomeni është paqëndrueshmëria në tregje dhe vënia e ecurisë së çmimeve nën ndikimin e ngjarjeve të rastit.

Fushata e Bankës së Shqipërisë vuri në qendër të saj konsumatorin për ta sensibilizuar në lidhje me këtë fenomen të tregut shqiptar dhe për të modeluar sjelljen e tij në prag festash me qëllim që të krijohet rezistencë ndaj rritjes së çmimeve. Përveç konsumatorëve, fushata mbuloi edhe bizneset shqiptare po me qëllimin e sensibilizimit të tyre. Sensibilizimi u siguroi nëpërmjet zhvillimit të fushatës publicitare. Krahas fushatës, Banka e Shqipërisë kërkoi bashkëpunimin e mediave dhe të autoriteteve qeveritare. Media ndihmoi në drejtim të transmetimit të mesazheve dhe të analizave tek publiku. Bashkëpunimi me autoritetet qeveritare ishte për të siguruar zgjidhjen e problemeve në afat të gjatë. Këto probleme kanë të bëjnë me:

- përmirësimin e legjislacionit në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve, nxitjen e konkurrencës dhe të raportimit të çmimeve;
- eliminimin në maksimum të atyre veprimeve që mund të favorizojnë rritjen spekulative të çmimeve siç janë veprimet me çmimet e referencës të doganave, angazhimi maksimal në fund të vitit për të siguruar të ardhurat dhe për të realizuar shpenzimet, gjë që çon në përqendrim të këtyre treguesve në muajin e fundit të vitit dhe ndikon në rritjen e parasë në qarkullim;
- rritjen e transparencës në publikimin e çmimeve.

Elementi i tretë i rëndësishëm i fushatës ishte ndjekja ditore e çmimeve të një grupi mallrash dhe zbulimi nëse rriten ose jo çmimet dhe cilat janë tregjet përgjegjëse për këtë. Ndjekja ditore e çmimeve u realizua nëpërmjet një rrjeti të ndërtuar dhe të financuar nga GTZ, fondacion i cili siguroi financimin e krejt fushatës. Analiza ditore e çmimeve raportohej çdo ditë për publikun. Për herë të parë në fushatat e saj, Banka e Shqipërisë shfrytëzoi gjerësisht botimin e informacionit në internet.

Në përfundim të saj u konkludua:

- fenomeni i spekulimit me çmimet është i pranishëm në tregun shqiptar;
- rritja e çmimeve është e lartë në prag të festës së Vitit të Ri. Festat e tjera kanë një ndikim gati të parëndësishëm duke konfirmuar natyrën tradicionale të këtij fenomeni;
- fushata publicitare pati efektet e veta gjë që u pasqyrua në vëmendjen që tërhoqi prej grupeve për të cilat ishte destinuar;
- fushata pati ndikimin e vet në inflacion në formën e zbutjes së efekteve sezonale që ndikojnë në rritje të inflacionit.

Në përfundim, Banka e Shqipërisë vlerësoi se ishte e dobishme të ndërmerrej kjo fushatë dhe është i nevojshëm vazhdimi i saj për të siguruar zbutjen në maksimum të fenomenit të spekulimit.

II.4.4. KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME MBI POLITIKËN MONETARE TË VITIT 2002.

Politika monetare e Bankës së Shqipërisë, qëndrimi ndaj normave të interesit dhe përcaktimi i kuadrit operacional, është orientuar nga respektimi i objektivit kryesor: ruajtja e stabilitetit të çmimeve. Kuadri i përgjithshëm i politikës monetare gjatë vitit 2002 është mbajtur pothuaj i pandryshuar nga ai i vitit 2001. Banka e Shqipërisë ka synuar kontrollin e rritjes së agregatëve monetarë në përputhje me kërkesën e ekonomisë për ta. Nga pikëpamja teorike, Banka e Shqipërisë e sheh ecurinë e çmimeve të lidhur ngushtë me sasinë e mjeteve monetare që qarkullojnë në ekonomi. Për këtë arsye, ajo vendos një objektiv të rritjes së ofertës monetare, në përputhje me parashikimet e saj për rritjen e ekonomisë. Nga pikëpamja operationale, Banka e Shqipërisë synon që nëpërmjet instrumenteve të saj, të ruajë në tregjet financiare një nivel normash interesi të përshtatshëm me objektivin e inflacionit.

Në përputhje me ecurinë e inflacionit dhe të zhvillimeve monetare, politika monetare e Bankës së Shqipërisë gjatë vitit 2002 mund të ndahet në tre periudha:

- ***Në muajt janar-shkurt u ndoq një politikë monetare neutrale.***

Në vijim të rritjes së normave të interesit në muajin gusht 2001, Banka e Shqipërisë ruajti një qëndrim neutral. Likuiditeti pati një kthim të shpejtë në sistem. Banka e Shqipërisë tërhoqi likuiditetin e tepërt nëpërmjet ankandëve të repos dhe nuk ka financuar deficitin buxhetor gjatë kësaj periudhe. Normat e interesit kanë qenë përgjithësisht të qëndrueshme.

Megjithatë, viti 2002 filloi me një nivel më të lartë inflacioni, mbi objektivin e Bankës së Shqipërisë. Inflacioni mesatar gjatë dy muajve të parë të vitit ishte 7.1 për qind, pothuaj dyfishi i kufirit të sipërm të objektivit të Bankës së Shqipërisë.

- ***Në muajt mars-shtator u ndoq një politikë monetare shtrënguese.***

Duke patur parasysh nivelin e lartë të inflacionit, Banka e Shqipërisë rriti me 0.5 pikë përqindjeje normën e interesit në muajin mars¹⁴. Megjithatë, kjo rritje ishte e pamjaftueshme në dritën e zhvillimeve monetare të muajve mars-prill. Sistemi bankar u përball me një tërheqje depozitash, e cila solli rritjen e likuiditetit në ekonomi. Tërheqja e depozitave solli rritjen e M1 mbi trendin e tij historik, duke treguar kështu qartë për presione inflacioniste gjatë pjesës më të madhe të vitit 2002, deri në muajin tetor.

E gjendur në një situatë të tillë, Banka e Shqipërisë u shmang përkohësisht nga kursi i programuar për përmbushjen e objektivit parësor të stabilitetit të

¹⁴ Në përputhje me ecurinë dhe me parashikimet e inflacionit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendosi të rritë me 0.5 pikë përqindjeje normën e interesit, në datën 20 mars 2002.

çmimeve dhe respektimin e objektivave të saj monetarë, duke përcaktuar me rëndësi prioritare ruajtjen e qëndrueshmërisë financiare të sistemit bankar. Ajo rriti më tej normat e interesit me 1 pikë përqindjeje në muajin prill, rishikoi kahun e operacioneve të saj dhe u detyrua të financojë deficitin buxhetor¹⁵.

- ***Në muajt tetor – dhjetor u ndoq një politikë monetare neutrale.***

Duke marrë parasysh kthimin e likuiditetit në sistem, i cili solli një përmirësim të kushteve monetare, një qëndrueshmëri relative në normat e interesit dhe zbutjen e presioneve inflacioniste, Banka e Shqipërisë ka zbatuar një politikë monetare të kujdesshme, me tendencë zbutëse, në dy muajt e fundit të vitit. Në muajin nëntor, ajo adoptoi një qëndrim neutral ndaj normave të interesit. Në muajin dhjetor, karakteri neutral i qëndrimit të politikës monetare u përforcua më tej me ndryshimin e formës së ankandit, nga ankand me shumë të përcaktuar në ankand me shumë të papërcaktuar dhe normë interesi fikse. Ky ndryshim përfaqëson një ulje të ndjeshme në koston e huamarrjes së bankave.

II.4.4.1. TËRHEQJA E DEPOZITAVE, MARS-PRILL 2002, NGJARJE E PAPANASHIKUAR.

Në periudhën mars-prill të vitit 2002, sistemi bankar u përball me tërheqje depozitash. Tronditja e besimit të publikut, e shoqëruar me tërheqjen masive të depozitave nga dy bankat kryesore të sistemit, u shkaktua nga spekulimi me ngjarjet e privatizimit të Bankës së Kursimeve, me keqinterpretimin e projekt-ligjit "Për sigurimin e depozitave" gjatë diskutimeve në Kuvend, me problemet që kishin dalë me pronarin e ri të Bankës Kombëtare Tregtare si dhe me situatën e rënduar politike. Mungesa e informacionit dhe asimetria e tij ndikuan në formimin e pritjeve jo të sakta të publikut për ngjarjet që po kalonte sistemi financiar.


Fenomeni u shfaq me intensitetin më të madh në dy javët e fundit të muajit mars dhe fillimisht u lokalizua në disa rrethe të vendit, kryesisht në pjesët rurale, si në Vlorë, në Fier e në Lushnjë. Nga sportelet e dy bankave më të mëdha të sistemit u tërhoqën 23.4 miliardë lekë depozita, nga të cilat 17.1 miliardë ishin depozita në lekë dhe 6.3 miliardë ishin depozita në valutë. Tërheqja e depozitave bëri që paraja jashtë bankave të rritet me 16.4 miliardë lekë gjatë këtyre muajve dhe sistemi bankar kaloi nga 1.6 miliardë lekë likuiditet i tepërt në muajin shkurt, në një mungesë të vazhdueshme likuiditeti përgjatë pjesës tjetër të vitit 2002. Gjatë kësaj periudhe u tërhoqën 8.3 përqind të depozitave gjithsej.

Kjo situatë përmban mjaft ngjashmëri me situatën e krijuar në vitin 1997. Tronditja e sistemit bankar shqiptar në pranverën e vitit 2002, ishte e dyta pas asaj që pësoi ky sistem në vitin 1997. Këto dy periudha evidentohen si momentet më të vështira në historinë e tij. Në këto raste Banka e Shqipërisë

¹⁵ Pasojat e tërheqjes së depozitave dhe politika monetare e Bankës së Shqipërisë në këtë periudhë trajtohen në pikën në vijim.

ka ndërhyrë për administrimin e situatave problemore. Ndërhyrja ka konsistuar si në rritjen e normave të interesit, ashtu dhe në injektimin e likuiditetit në treg. Kalimi në një qëndrim të tillë nga Banka e Shqipërisë u bë duke e konsideruar stabilitetin e sistemit bankar të domosdoshëm për stabilitetin më të gjerë makro të ekonomisë së vendit dhe për arritjen e normave të ulëta të inflacionit në një horizont kohor afatgjatë.

Grafik 22. Tërheqjet neto të depozitave në Bankën e Kursimeve dhe në Bankën Kombëtare Tregtare, në mijë lekë.



Ndërhyrjet në treg të Bankës së Shqipërisë si krijuese e likuiditetit, ndihmuan në zgjidhjen e nevojave imediate të bankave për likuiditete dhe në ruajtjen e besimit të publikut në këtë sistem.


Banka e Shqipërisë mori një sërë masash për administrimin e situatës.

- Rritja agresive e normës bazë të interesit u pa si instrumenti kryesor që do të ndihmonte në përmirësimin e situatës.
- Banka e Shqipërisë përdori mediat për të sqaruar publikun mbi situatën relativisht të shëndoshë të sistemit bankar.
- Banka e Shqipërisë u angazhua në plotësimin dhe lehtësimin e nevojave të sistemit bankar për likuiditet.
- Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi financimin e deficitit buxhetor brenda kufirit të lejuar nga ligji, 8 për qind të mesatares së të ardhurave normale buxhetore gjatë tre viteve të fundit. Në vlerë absolute ky limit është 9.7 miliardë lekë. Përmirësimi i gjendjes së likuiditetit gjatë muajve në vijim bëri që Banka e Shqipërisë të ulë pjesëmarrjen e saj në financimin e këtij deficiti. Në fund të vitit, financimi i deficitit ishte vetëm 1.8 miliardë lekë.
- Nga pikëpamja operacionale, Banka e Shqipërisë ndryshoi kahun e operacionit kryesor monetar, nga repo në repo të anasjellta duke u shndërruar në injektuese e likuiditetit në treg. Ajo përdori instrumentet e kredisë lombard, të repos së anasjelltë njëmujore, si dhe lehtësinë e kredisë njëditore për të injektuar përkohësisht likuiditet në treg. Injektimi i likuiditetit në sistem në kushte normale është shenjë e një

politike monetare liberale dhe, në pamje të parë, bie ndesh me rritjen e normës së interesit si një masë shtrënguese e politikës monetare. Megjithatë, ky qëndrim u kushtëzua nga nevoja e garantimit të besimit në sistemin bankar. Banka e Shqipërisë synonte të ruante stabilitetin dhe partneritetin e sistemit bankar në aplikimin e politikës monetare.

Treguesit monetarë, në muajin qershor, treguan se fenomeni i tërheqjes së depozitave nga sistemi ishte kapërcyer. Gjatë këtij muaji u vunë re shenjat e para të kthimit të parasë në sistem. Intensiteti më i lartë i kthimit të kursimeve në sistem u shënuar në muajin shtator dhe vazhdoi deri në fund të vitit 2002. Në fund të muajit shtator, niveli i depozitave gjithsej arrin të kalojë nivelin e fundit të vitit 2001. Ndërsa, në muajin nëntor në sistem u arrit të kthehej e gjithë sasia e depozitave në lekë të tërhequra gjatë periudhës mars - prill. Ky cikël, për depozitat në valutë, u plotësua brenda muajit gusht.

Grafik 23. Rënia e gjendjes së depozitave në periudhën mars-prill 2002 dhe rritja kumulative për periudhën maj – dhjetor 2002, në miliardë lekë.



Efektet e ndërhyrjeve të Bankës së Shqipërisë për rikuperimin e situatës u arrit më shpejt se në vitin 1997. Për vitin 1997, ndërhyrja e Bankës së Shqipërisë u zgjat në kohë për shkak të mosfunksionimit të shtetit në pjesën e parë të vitit. Efektet e politikës së saj që i pranishëm në gjysmën e dytë të vitit 1997. Rezultatet e para të ndërhyrjes u vërejtën të paktën gjashtë muaj nga fillimi i tronditjes së sistemit bankar. Ndërsa, ndërhyrja e Bankës së Shqipërisë ndaj tronditjes së sistemit bankar, në vitin 2002, u krye në kohën e duhur e me efektivitet duke vendosur dhe ruajtur qëndrueshmërinë financiare në vend, si dhe duke çuar në kapërcimin e shpejtë të situatës së vështirë të likuiditetit. Rezultatet e para të ndërhyrjes u vërejtën të paktën tre muaj nga fillimi i tronditjes së sistemit bankar. Kjo ndërhyrje që efektive pasi u bë në kushtet e një situatë të qëndrueshme makroekonomike dhe të një gjendjeje të shëndoshë të sistemit bankar.

KAPITULLI III: ZHVILLIMET MONETARE DHE TREGJET

III.1. PROGRAMI MONETAR DHE OBJEKTIVAT SASIORË.

Banka e Shqipërisë, në mbështetje të politikës së saj monetare, harton programin monetar për një horizont kohor njëvjeçar.

Banka e Shqipërisë e filloi vitin 2002 me një program, i cili bazohej në një ecuri normale të ekonomisë dhe të zhvillimeve monetare. Oferta monetare parashikohej të rritej me 11.3 për qind, afërsisht me të njëjtin ritëm të rritjes së PBB-së nominale. Oferta e parasë parashikohej të rritej me të njëjtin ritëm si dhe rritja reale e ekonomisë, duke qenë një premisë për kontrollin e inflacionit. Ritmet e rritjes së parasë jashtë bankave dhe të depozitave ishin parashikuar të ishin të njëjta. Kjo do të shërbente si një bazë e mirë për qëndrueshmërinë e normave të interesit, duke ndihmuar gjithashtu në respektimin e objektivit të inflacionit. Në përputhje me politikën monetare, tipari dallues i programit monetar për vitin 2002, ishte mosfinancimi i deficitit buxhetor nga Banka e Shqipërisë.

Zhvillimet monetare, gjatë tre muajve të parë të vitit ishin mjaft afër programit monetar. Paraja u kthye me ritme të shpejta në sistem. Kjo solli rritje të depozitave në lekë dhe e çoi sistemin bankar në një gjendje tepërce likuiditeti. Rritja e depozitave mundësoi kreditimin normal të ekonomisë dhe mbulimin e nevojave të qeverisë për financim. Inflacioni në këtë periudhë ishte mbi objektivin e Bankës së Shqipërisë, i ndikuar kryesisht nga faktorët e ofertës.

Duke marrë shkas dhe nga ngjarjet e muajve mars-prill rishikimi i programit monetary u bë i domosdoshëm. Konkretisht:

- u ndryshua parashikimi për rritjen ekonomike, nga 7.0 për qind në 6.0 për qind, dhe parashikimi për inflacionin mesatar, nga 3.0 për qind në 5.3 qind;
- u rrit financimi i buxhetit nëpërmjet huamarrjes së brendshme në përgjigje të mungesës së të ardhurave të privatizimit;
- u ul parashikimi për rritjen e ofertës monetare nga 11.3 për qind në 5.4 për qind;
- u ndryshua parashikimi i rritjes së parasë jashtë bankave nga 11.3 për qind në 15.0 për qind ndërkohë që depozitat parashikoheshin të kishin një rritje të papërfillshme;
- u parashikua të kishte rritje edhe kërkesa e qeverisë për financim të brendshëm të deficitit buxhetor. Mungesa e të ardhurave nga privatizimi, të cilat nga 1.7 për qind e PBB-së u ulën në 0.2 për qind të PBB-së, rriti kërkesën e qeverisë për financim, nga 14.7 miliardë lekë në 17.0 miliardë lekë. Banka e Shqipërisë u detyrua të parashikonte financimin e tij në masën 9.7 miliardë lekë, për t'i krijuar mundësi sistemit bankar të përmirësonte gjendjen e tij të likuiditetit.

Zhvillimet monetare gjatë periudhës prill-tetor janë karakterizuar nga një përmirësim gradual dhe i vazhdueshëm i treguesve monetarë, në veçanti, i gjendjes së likuiditetit në ekonomi. Raporti i parasë jashtë bankave ndaj ofertës monetare, pasi arriti nivelin maksimal në muajin qershor, 33.6 për qind, ka qenë në vazhdimësi në zbritje. Në muajin tetor, raporti i parasë jashtë bankave ndaj M3 kishte zbritur në 31.2 për qind, duke qenë 1.8 pikë përqindjeje nën vlerën e parashikuar të programit. Banka e Shqipërisë, gjatë muajve prill-shtator, financoi deri në nivelin 6 miliardë lekë deficitin buxhetor. Më pas ajo e uli gradualisht këtë financim duke ju krijuar më shumë mundësi bankave për të investuar fondet e tyre në tregun primar. Megjithë gjendjen e rënduar të likuiditetit në sistem, bankat kanë qenë në gjendje të mbështesin mirë me kredi ekonominë. Kreditimi i ekonomisë e ka kaluar vazhdimisht parashikimin e programit monetar, i cili vlerësonte një rritje të këtij treguesi në nivelin e 8.6 miliardë lekëve¹⁸.

Në përgjithësi, programi monetar ka kapur mirë si tendencat kryesore të zhvillimeve monetare dhe madhësinë e tyre. Megjithatë, i hartuar në një situatë të paqëndrueshme monetare, ai ishte disi konservator në parashikimet e veta. Zhvillimet monetare, në veçanti rritja e depozitave në lekë, financimi i deficitit buxhetor nga sistemi bankar dhe injektimi i likuiditetit në sistem nga Banka e Shqipërisë, gjatë tremujorëve të dytë dhe të tretë, ishin më mirë se parashikimet e programit.

Duke u nisur nga këto konsiderata, Banka e Shqipërisë rishqyrtoi programin monetar për dy muajt e fundit të vitit. Ndryshimet kishin të bënin kryesisht me përfshirjen e prirjeve më të fundit monetare, me përmirësimin e gjendjes së likuiditetit të bankave dhe me uljen e projeksionit të rritjes ekonomike, nga 6.0 për qind në intervalin 4.5-5 për qind për vitin 2002.

Në fund të vitit 2002 rritja vjetore e ofertës monetare rezultoi 5.9 për qind si rrjedhojë e rritjes së parasë jashtë bankave, e cila ka qenë agregati monetar me normën më të shpejtë të rritjes vjetore. Depozitat në lekë dhe depozitat në valutë janë rritur më pak se parashikimi i programit monetar. Në tërësi, objektivat sasiorë të programit u arritën të respektoheshin.

¹⁸ Programi monetar për vitin 2002 parashikonte që teprica e kredisë për sektorin publik do të ulej në 0.4 miliardë lekë dhe ajo për sektorin privat do të rritej në 9.0 miliardë lekë.

Tabelë 22: Realizimi i objektivave sasiorë të Bankës së Shqipërisë gjatë vitit 2002, në miliardë lekë.

	Dhjetor'01	Mars	Qershor	Shtator	Dhjetor'02
Mjetet valutore neto (milionë dollarë)					
Objektivi	542.6	536.6	530.6	546.6	558.6
Aktuale	542.6	547.5	550.1	570.9	562.2
Diferenca	0.0	10.9	19.5	24.34	3.55
Mjetet e brendshme neto					
Objektivi	78.1	83.6	89.1	90.1	95.1
Aktuale	78.1	84.8	87.6	83.5	87.1
Diferenca	0.0	1.2	-1.6	-6.60	-7.97
Kredia e brendshme neto për qeverinë					
Objektivi	237.5	238.5	244.2	247.0	257.0
Aktuale	237.5	240.5	246.8	247.0	259.6
Diferenca	0.0	2.0	2.6	0	2.6


Objektivi i kredisë së brendshme neto për qeverinë u tejkalua në tre tremujorë. Ky objektiv është përmbushur në muajin shtator, i cili ishte dhe kriter performance për ecurinë e programit të rritjes ekonomike dhe të zhvillimit social.

III.2. Zhvillimet në Ofertën e Parasë.

III.2.1 PARAJA JASHTË BANKAVE.

Gjatë vitit 2002 treguesi i parasë jashtë bankave ka patur një ecuri jo të qëndrueshme. Në periudhën mars-prill niveli i saj u rrit me 16.4 miliardë lekë. Norma vjetore e rritjes në muajin prill arriti në 35.6 për qind, e cila është norma më e lartë e rritjes gjatë pesë viteve të fundit. Pas muajit prill tendenca e këtij treguesi ka qenë në ulje dhe në fund të vitit norma vjetore e rritjes arriti në 9.82 për qind.

Grafik 28: Ecuria e normës vjetore të rritjes të PJB, të M3 si dhe raporti PJB/M3.



Ulja e nivelit të parasë jashtë bankave ishte rrjedhojë e politikës së shtrënguar monetare të Bankës së Shqipërisë nëpërmjet rritjes së normave të interesit si dhe e financimit të ulët të deficitit buxhetor nga Banka e Shqipërisë. Kontributi


i këtij treguesi në rritjen e ofertës monetare është rritur shumë krahasuar me vitet e mëparshme.

III.2.2 ECURIA E AGREGATIT M1.

Ecuria e parasë jashtë bankave ka përcaktuar edhe ecurinë e M1. Në periudhën e tërheqjes së depozitave, norma vjetore e rritjes së M1 arriti në 29.3 për qind në muajin prill. Megjithatë, si pasojë e rritjes së normave të interesit dhe e kthimit të parasë në sistem, norma e rritjes vjetore e M1, në fund të vitit, arriti 6.7 për qind.

Përbërësi tjetër i M1, depozitat pa afat në lekë, ka qenë përgjithësisht i qëndrueshëm gjatë vitit. Ai ka patur tendencë uljeje në dy muajt e fundit të vitit, kur rritja e normës reale të interesit rrit koston e tyre oportune kundrejt depozitave me afat në lekë.

Grafik 29: Ecuria e agregatit M1 gjatë vitit 2002.



Banka e Shqipërisë e ka ndjekur me vëmendje ecurinë e M1. Niveli i M1 real ka patur një peshë të rëndësishme në përcaktimin e qëndrimit të politikës monetare, pasi studimet ekonometrike kanë treguar se ai luan rol të rëndësishëm në përcaktimin e nivelit të çmimeve. Norma e rritjes vjetore e M1 real është ulur poshtë nivelit të trendit historik në muajin gusht. Kjo ndikoi në uljen e inflacionit në tremujorin e fundit.


III.2.3 DEPOZITAT.

Niveli i depozitave në sistemin bankar u rrit me 10.6 miliardë lekë ose 4 për qind, nga 32 për qind që llogaritet norma mesatare vjetore historike e rritjes së depozitave për nëntë vitet e fundit. Kontributin kryesor në rritjen e depozitave e kanë dhënë ato në lekë, me 7.7 miliardë lekë, kundrejt një rritjeje prej 2.9 miliardë lekësh të depozitave në valutë. Ritmi mesatar mujor i rritjes së depozitave arriti vlerat 0.89 miliardë lekë, nga 3.8 miliardë lekë një vit më parë.

Ecuria e depozitave gjatë vitit ka paraqitur dy situata të kundërta. Kështu, pas rritjes me 7.8 miliardë lekë në dy muajt e parë të vitit, gjatë periudhës mars –

prill, gjendja e depozitave në sistem u pakësua me 23.4 miliardë lekë, e cila përbënte rreth 8.3 për qind të depozitave gjithsej të sistemit në fund të muajit shkurt. Ndërsa pjesa tjetër e vitit u karakterizua nga rritja e depozitave në sistem me 26.2 miliardë lekë.


Grafik 30: Rritja vjetore e depozitave gjithsej, në përqindje.



III.2.3.1 DEPOZITAT NË LEKË.

Gjatë vitit 2002, depozitat në lekë shënuan norma të ulta vjetore të rritjes të cilat, me përjashtim të dy muajve të parë të vitit, u luhatën në shifrat 2.0 – 6.0 për qind. Në fund të vitit rezultoi që, në terma vjetorë, këto depozita u rritën 4.16 për qind. Burimin kryesor të rritjes së depozitave në lekë e përbëjnë depozitat me afat, me 9.6 miliardë lekë, ndërkohë që depozitat pa afat ndikuan negativisht me 1.8 miliardë lekë. Rritja mesatare mujore e depozitave në lekë u ul në nivelin 0.6 miliardë lekë, kundrejt nivelit 1.7 miliardë lekë një vit më parë. Po të përjashtohet periudha mars - prill, rritja mesatare mujore për vitin 2002, llogaritet në 2.4 miliardë lekë, duke qëndruar ndjeshëm mbi nivelin e dy viteve të fundit ose e krahasueshme me vitin 1999.


Grafik 31. Rritja vjetore e depozitave në lekë, në përqindje.



III.2.3.2 DEPOZITAT NË VALUTË.

Norma vjetore e rritjes së depozitave në valutë me 3.3 për qind, shënoi vlerën më të ulët gjatë tre viteve të fundit. Ndryshimi mesatar mujor i depozitave në lekë u ul në nivelin 0.25 miliardë lekë dhe është i krahasueshëm me atë të vitit 1997. Zhvillimi i këtyre depozitave u ndikua nga procesi i prezantimit fizik të euros në treg në fillim të vitit 2002, nga paniku i depozitave dhe nga ulja e vazhdueshme e interesave për depozitat në valutë gjatë vitit.

Grafik 32: Rritja vjetore e depozitave në valutë, në përqindje.



Futja fizike e monedhës euro në tregun shqiptar në fillim të vitit 2002, kishte nxitur gjatë muajve të fundit të vitit 2001, futjen e monedhave të shportës së euros në formën e depozitave në sistemin bankar, për konvertimin e tyre pa komision. Intensiteti me të cilin u shfaq ky fenomen në muajin dhjetor të vitit 2001, vazhdoi për inerci edhe gjatë muajit janar 2002, ku depozitat në valutë u rritën me 2.3 miliardë lekë. Përgjatë periudhës shkurt – qershor, me përjashtim të muajit maj, gjendja e këtyre depozitave u ul në mënyrë të qëndrueshme. Kryerja e procesit të konvertimit u shoqërua që në muajin shkurt me tërheqjen e depozitave në euro. Intensiteti i tërheqjes së depozitave në valutë u rrit edhe më shumë nga paniku i përhapur në rradhët e depozituesve në dy muajt në vazhdim.

Rritja e shpejtë e depozitave në valutë, gjatë muajve korrik dhe gusht, çoi në rikthimin e nivelit të mëparshëm. Muaji gusht shënoi edhe pikun e rritjes mujore të këtyre depozitave me 5.8 miliardë lekë ose një normë vjetore të rritjes prej 17.8 për qind, nga 28.6 për qind e normës historike vjetore të rritjes në këtë muaj. Në përgjithësi, depozitat në valutë paraqesin një normë të lartë vjetore të rritjes në muajt korrik dhe gusht, që motivohet nga hyrjet e valutave prej emigrantëve.

Për pjesën tjetër të vitit, gjendja e depozitave në valutë u paraqit e qëndrueshme, me luhajtje të vogla. Fundi i prires rritëse u ndikua edhe nga ulja e mëtejshme e interesave në dollarë amerikanë dhe e interesave në euro në tregun e brendshëm, të diktuar nga uljet e interesave bazë të këtyre dy monedhave.

III.2.3.3. DEPOZITAT SIPAS KONTRIBUTIT TË SEKTORËVE TË EKONOMISË.

Individët vazhdojnë të jenë përcaktues në rritjen e depozitave në sistem, ndërsa sektorët e tjerë të ekonomisë, që ndikojnë kryesisht në depozitat me likuiditet të lartë, kanë dhënë një kontribut të papërfillshëm me tendencë të lehta rënëse.

Pjesa e depozitave të individëve në sistem paraqitet me një rritje të qëndrueshme gjatë tre viteve të fundit. Krahasuar me vitin e kaluar, depozitat e individëve u rritën me 1.4 pikë përqindjeje. Ndërsa depozitat e sektorit publik dhe të bizneseve private rezultojnë me një rënie prej 0.52 dhe 0.88 pikë përqindjeje përkatësisht.

Tabelë 23: Depozita sipas sektorëve ndaj depozitave gjithsej, në përqindje.

	1998	1999	2000	2001	2002
Sektor publik	10.72	9.76	7.60	6.22	5.70
Biznes privat	10.13	11.91	12.80	13.03	12.15
Individë	79.15	78.34	79.60	80.76	82.16

Depozitat e individëve janë rritur si në lekë me 9.4 miliardë lekë, ashtu edhe në valutë me 3.0 miliardë lekë.

Tabelë 24: Depozitat sipas origjinës së krijimit, në përqindje.

	Depozita pa afat në lekë			Depozita me afat në lekë			Depozita në valutë		
	Sektor publik	Biznese private	Individë	Sektor publik	Biznes privat	Individë	Sektor publik	Biznes privat	Individë
1998	4.70	3.91	0.38	0.07	0.41	67.32	5.94	5.81	11.45
1999	4.69	3.84	0.74	0.13	1.21	63.02	4.94	6.86	14.58
2000	2.80	6.90	1.10	0.40	0.30	60.70	4.40	5.60	17.80
2001	2.25	5.43	0.99	0.16	0.82	58.01	3.80	6.78	21.76
2002	1.85	4.86	0.98	0.30	0.69	59.16	3.55	6.59	22.02


Sjellja e depozitave të bizneseve private dhe të sektorit publik nuk paraqet ndryshime të dukshme nga njëri muaj në tjetrin.

Përsa i përket peshës së bankave të ndryshme në tregun e depozitave, vërejmë që Banka e Kursimeve ende ruan pozita dominuese për depozitat në lekë. Përsa i përket depozitave në valutë tregu priret drejt një konkurrence të pastër.


Box 10: PËRQENDRIMI I DEPOZITAVE, VITI 2002.

Përqendrimi i tregut të depozitave në përgjithësi, paraqet një reduktim gradual dhe të qëndrueshëm.


Grafik 33: Indeksi Herfindalit për totalin e depozitave si sistem bankar.



Grafik 34: Indeksi Herfindalit për depozitat në lekë dhe në valutë.



Grafik 35: Indeksi Herfindalit për depozitat gjithsej në lekë dhe për depozitat me afat.




III.3 KËRKESA PËR PARA.

III.3.1 ZHVILLIMET NË MJETET VALUTORE NETO.

Sistemi bankar gjatë vitit 2002 ka përmirësuar pozicionin e tij valutore duke rritur nivelin e rezervave valutore me rreth 37 milionë dollarë ose 3.5 miliardë lekë krahasuar me një vit më parë. Rritja e rezervës valutore neto ka dhënë një kontribut prej 15 për qind në rritjen e ofertës monetare.

Gjatë gjithë vitit 2002, rezerva valutore ka qëndruar poshtë nivelit të muajit dhjetor 2001.¹⁹ Rritja e rezervave valutore neto shpjegohet me mbiçmimin e euros kundrejt dollarit gjatë vitit 2002 në tregun ndërkombëtar.

Grafik 36: Ecuria e rezervës valutore të sistemit gjatë vitit 2002, në milionë dollarë.



Rezerva valutore neto e Bankës së Shqipërisë, gjatë vitit 2002, përgjithësisht ka patur një ecuri pozitive duke u rritur me 80 milionë dollarë. Ndërkohë që depozitat në valutë kanë patur një rritje vjetore me rreth 36 milionë dollarë, pozicioni valutore neto i bankave të nivelit të dytë është përkeqësuar me 43.5 milionë dollarë.

Banka e Shqipërisë ka qenë aktive në tregun bankar gjatë periudhës mars-maj 2002, duke shitur valutë në treg rreth 5 milionë dollarë, si dhe gjatë muajit dhjetor duke blerë rreth 2 milionë dollarë. Këto ndërhyrje kishin për qëllim të parandalonin luhajtjet e mëdha të kursit të këmbimit të lekut.

III.3.2. KREDITI I BRENDSHËM.


Kredia e brendshme përfaqëson pjesën e financimit të brendshëm të deficitit buxhetor nga sistemi bankar²⁰, si dhe mbështetjen e ekonomisë me kredi nga bankat e nivelit të dytë.

¹⁹ Për efekte llogaritjeje është përdorur kursi fiks i muajit dhjetor 2001, i cili në ditën e fundit të vitit ishte 136.6 lek/usd.

²⁰ Banka e Shqipërisë dhe bankat e nivelit të dytë.

Kredia e brendshme në fund të vitit 2002 arriti 304 miliardë lekë, duke u rritur 10.4 për qind, krahasuar me një vit më parë. Rreth 58 për qind e kësaj rritjeje ka ardhur si rezultat i kreditimit të buxhetit të qeverisë nga sistemi bankar. Ritmi i rritjes së kreditimit të ekonomisë është më i lartë sesa ritmi i rritjes së financimit të buxhetit. Kështu, struktura e kreditit të brendshëm vazhdon të pësojë ndryshime në favor të kreditimit të ekonomisë dhe kjo më e theksuar në tremujorin e katërt të vitit 2002.

Grafik 37: Struktura e kredisë së brendshme.



III.3.2.1. KREDIA PËR EKONOMINË.


Gjatë vitit 2002, teprica e kredisë për ekonominë arriti në 47.4 miliardë lekë. Kredia e re u lëvrua në masën 62.6 miliardë lekë ose 54.2 për qind më shumë se në vitin 2001. Në fund të vitit 2002 kredia për ekonominë përbën 11.4 për qind të kërkesës për para, tregues i cili ka pasqyruar tendenca në rritje të vazhdueshme. Këta tregues dëshmojnë për një pjesëmarrje më aktive të bankave në tregun e huadhënies. Akoma më domethënës bëhet ky konkluzion po të krahasojmë kredinë e re të dhënë nga sistemi bankar për periudhat 1993-2000 dhe 2001-2002. Në tetë vitet e para të tranzicionit sistemi bankar ka dhënë kredi në masën 79.5 miliardë lekë ose 9.9 miliardë lekë mesatarisht për çdo vit. Për dy vitet e fundit, kredia e re e dhënë arrin në 103.2 miliardë lekë. Kjo do të thotë që kreditimi mesatar vjetor për vitet 2001-2002 është rreth 5 herë më shumë se sa për periudhën 1993-2000.

Tabelë 25: Ecuria e disa treguesve kryesorë.

	2000	2001	T-1 '02	T-2 '02	T-3 '02	T-4 '02
Oferta e parasë (në miliardë lekë)	328.1	393.6	396.4	395.4	406.4	416.7
Kredi e brendshme (në % ndaj M3)	76.3	70.1	70.3	72.5	71.7	72.9
-Kredi për qeverinë (në % ndaj M3)	68.4	60.8	60.7	61.9	60.8	61.5
-Kredi për ekonominë (në % ndaj M3)	7.9	9.3	9.6	10.6	10.9	11.4
Kredi për ekonominë (në % ndaj PBB)	4.8	6.2	5.9	6.4	6.7	7.2*
Kredi për ekonominë (në % ndaj totalit të aktiveve)	9.5	11.3	11.8	13.1	13.3	13.7
Raporti kredi/depozita (në %)	11.3	13.3	14.2	15.9	16	16.5

* Ky raport është ndërtuar ndaj PBB në nivel vjetor për vitin 2002.

Grafik 38: Ecuria e kredisë për ekonominë në vite.



Tabelë 26: Ecuria e treguesve të kreditit, në përqindje.

Treguesit	Viti 2000	Viti 2001	Teprica e kredisë gjatë vitit 2002			
			Trem. I	Trem. II	Trem. III	Trem. IV
Kredi afatshkurtër	40	53	52	51	48	49
Kredi afatmesme	31	25	26	28	29	28
Kredi afatgjatë	29	22	22	21	23	23
Sektori shtetëror	6	5	4	3	2.7	2
Sektori privat	94	95	96	97	97.4	98
Lekë	40	35	32.5	32	33.1	34
Valutë	60	65	67.5	68	66.9	66
Teprica e kredisë (në mld lekë)	25.9	36.6	38.2	42	44.3	47.4²¹

Gjatë vitit 2002 veçojmë këto zhvillime në strukturën e tepricës së kredisë:

- *Sipas afatit.* Gjatë tre viteve të fundit kredia në terma kohorë afatshkurtër ka qenë mbizotëruese në portofolin e kredisë si sistem bankar. Në fund të vitit 2002, kredia afatmesme dhe afatgjatë, të marra së bashku, përbëjnë 51.3 për qind të tepricës së kredisë.
- *Sipas monedhës.* Ritmi i rritjes vjetore të tepricës së kredisë në valutë nga 52.6 për qind që ishte në fund të vitit 2001, ka rënë në 32.4 për qind në fund të vitit 2002. Ndërsa, kreditimi në lekë u rrit 24.3 për qind sa edhe një vit më parë. Rreth 30 për qind e rritjes së tepricës së kredisë si sistem bankar ka ardhur nga rritja e tepricës së kredisë në lekë.
- *Sipas sektorëve.* Teprica e kredisë në sektorin publik ka ardhur në rënie si pasojë e shlyerjeve të vazhdueshme të saj dhe e moskreditimit

²¹ Teprica e kredisë e përfshin tepricën e kredisë të kaluar pranë ATK-së nga BK, BKT, BTA. Në total, teprica e kredive të kaluara në ATK arrin vlerën 8.7 miliardë lekë. Kështu duke zhveshur tepricën e kredisë si sistem bankar në fund të vitit 2002 nga kreditë e kaluara në ATK, kjo tepricë është 38.7 miliardë lekë.

të këtij sektori. Në fund të vitit 2002, 97.7 për qind e tepricës së kredisë i takon sektorit privat.

Gjatë vitit 2002, në nivel mesatar mujor është akorduar kredi e re për sektorin privat dhe për individët, 5.2 miliardë lekë. Në strukturën e kredisë së re mbizotëron kredia afatshkurtër (71 për qind), kredia në valutë (67 për qind) dhe kredia për sektorin privat²². Megjithatë, viti 2002 është karakterizuar nga rritja e interesimit të bankave drejt investimeve afatgjata, drejt kreditimit për biznesin e mesëm dhe të madh (industria përpunuese si prodhimi i vajit, i ujrave mineralë, i reçelave etj.), drejt blerjes së apartamenteve nga individët.

Tabelë 27: Ecuria e kredisë së re në vite, në miliardë lekë.

Treguesit	Viti 2000	Viti 2001	Viti 2002	Kredi e re gjatë vitit 2002			
				Trem. I	Trem. II	Trem. III	Trem. IV
Kredi afatshkurtër	12.9	27.6	44.8	9.5	10.7	11.4	13.2
Kredi afatmesme	10.0	10.4	13.0	2.4	3.1	3.5	4.0
Kredi afatgjatë	1.3	2.6	4.8	0.6	1.6	1.3	1.3
Sektori shtetëror	0.2	0.5	0.05	0.02	0.03	-	0.00
Sektori privat	24.0	40.1	62.59	12.5	15.4	16.2	18.50
Lekë	4.4	10.0	20.9	2.1	4.3	6.6	7.9
Valutë	19.8	30.6	41.7	10.4	11.1	9.6	10.6
Kredi e re (në mld lekë)	24.2	40.6	62.6	12.5	15.4	16.2	18.5

Gjatë periudhës dhjetor 2001- dhjetor 2002 sektori i tregtisë vazhdon të mbetet sektori më i preferuar për kreditim. Ndërsa, preferenca për ndërtimin ka shfaqur rënie të ndjeshme. Megjithatë, vihet re se struktura e kreditimit sipas sektorëve mbetet ende larg strukturës së ekonomisë.

Tabelë 28: Teprica e kredisë sipas degëve të ekonomisë, në përqindje.


Nr	Degët e ekonomisë	Viti 2000	Viti 2001	Viti 2002			
				Trem. I	Trem. II	Trem. III	Trem. IV
1	Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura	0.9	1.0	0.9	0.9	1.0	0.8
2	Peshkimi	1.4	0.1	0.1	0.2	0.2	0.2
3	Industria nxjerrëse	0.7	1.6	2.1	0.2	0.3	0.2
4	Industria përpunuese	16.9	19.5	18.8	17.7	17.4	17.0
5	Prodhimi, shpërndarja e energjisë elektrike e gazit dhe e ujit	9.0	3.0	2.9	3.4	3.1	3.3
6	Ndërtimi	25.0	12.5	11.9	8.4	8.7	8.6
7	Tregtia, riparimi i automobilave dhe artikujve shtëpiakë	26.7	41.3	41.1	43.5	41.8	40.4
8	Hotele dhe restorante	4.5	4.3	4.9	5.9	5.1	6.0
9	Transporti dhe telekomunikacioni	3.2	4.6	3.1	1.7	1.6	2.4
10	Aktivitetet financiare	0.0	0.1	0.9	1.5	0.1	-
11	Pasuritë e patundshme	5.4	6.3	6.5	3.4	8.1	9.1
12	Shëndeti dhe veprimtaritë sociale	3.2	1.2	1.2	5.3	0.6	0.5
13	Shërbime kolektive, sociale dhe personale	3.0	3.3	4.4	2.0	5.0	4.2

²² Vetëm 58 milionë lekë është kredi e akorduar për sektorin publik.

Box 11. PËRQENDRIMI I TREGUT TË HUADHËNIES BANKARE, 2002.

Gjatë vitit 2002 përqendrimi në tregun e huadhënies ka ardhur në zbutje, pasi numri i pjesëmarrësve aktivë në këtë treg ka ardhur në rritje.

Grafik 39: Indeksi Herfindalit për disa tregues të tepricës së kredisë.




Përsa i takon lëvrimin të kredive të reja, në dy vitet e fundit niveli i tyre vjen duke u rritur ndjeshëm. Pjesëmarrja aktive e bankave ka bërë që fenomeni i përqendrimit në treguesin kredive të reja afatmesme dhe afatgjata të shoqërohet me tendencë rënieje, duke e krahasuar me fundin e vitit 2001. Numri i bankave që kreditojnë në afate të gjata kohore ka ardhur duke u shtuar. Me rritje vërehet ky fenomen në treguesin e kredive të akorduara në lekë.

Tabelë 29: Ecuria e indeksit N, në përqindje (pesha e 4 bankave më aktive në akordimin e kredive të reja).

Periudha	Totali i kredive	Kredi afatshkurtër	Kredi afatmesme	Kredi afatgjatë	Kredi ne sek. Publik	Kredi në sek. privat	Kredi në lekë	Kredi në valutë
dhjetor'00	83	81	90	51	94	83	90	81
mars'01	83	80	92	82	100	82	91	81
qershor'01	77	72	90	72	60	78	84	75
shtator'01	80	77	88	72	61	80	87	78
dhjetor'01	83	83	87	72	64	84	92	81
mars'02	87	90	74	70	100	87	94	85
qershor'02	82	94	35	99	100	81	93	78
shtator'02	82	87	73	60	100	82	94	77
dhjetor'02	82	85	75	54	100	82	94	74

Grafik 40: Ecuria e treguesit N.



Box 12: VROJTIM PËR AKTIVITETIN KREDITUES TË BANKAVE TË NIVELIT TË DYTË DHE TË SUBJEKTEVE JOBANKA GJATË VITIT 2002.

Gjatë vrojtimit të zhvilluara pranë bankave të nivelit të dytë u vu re se, biznesi i mesëm është biznesi më i preferuar në kreditim përgjatë gjithë vitit 2002. Krahasuar me një vit më parë, preferenca për këtë biznes është rritur ndjeshëm.

Në fillim të vitit 2002, niveli mesatar i realizimit të kredisë paraqet një rritje të moderuar, ndërsa në gjashtëmujorin e dytë u vu re një përmirësim i ndjeshëm i këtij treguesi. Kjo ecuri e nivelit mesatar të kreditimit u ndikua nga situata politike në vend, nga kriza energjitike si dhe nga masat shtrënguese fiskale.

Për vitin 2002, mund të themi se rreziku i kredisë mbetet në kufijtë mesatarë, me një tendencë të lehtë në rritje krahasuar me një vit më parë. Kjo tendencë disi e qëndrueshme e rrezikut, argumentohet me kushtet e mjedisit ekonomik dhe politik që kanë mbetur pothuajse të njëjta.

Niveli i rrezikut të kreditit në të ardhmen do të mbetet i njëjtë. Kjo sepse nuk pritet të ketë ndryshime në situatën politike dhe ekonomike të vendit.

Aktualisht në Shqipëri veprojnë një numër jo i vogël organizmash dhe fondacionesh të huaja, të përbashkëta dhe shqiptare që ushtrojnë aktivitetin kreditues në mbështetje të biznesit të vogël.

Në vrojtimin e kryer gjatë vitit 2002 për subjektet jobanka u vu re se niveli mesatar i realizimit të planit të kredisë ka ruajtur të njëjtat nivele sikurse edhe një vit më parë. Ndër arsyet kryesore, të cilat nuk e kanë përshpejtuar procesin e kredidhënies, përmenden kriza energjitike, politikat tepër të shtrënguara të kredidhënies nga fondacionet si dhe rritja e konkurrencës në këtë treg.

Kriza energjitike, ka ndikuar pak në reduktimin e kërkesës për kredi të subjekteve jobanka. Ndërkohë, që ajo ka patur një ndikim më të madh në vonesën e shlyerjeve të kredive.

Rreziku aktual vlerësohet të ketë mbetur në të njëjtat nivele sikurse edhe një vit më parë. Kjo është argumentuar me një situatë të njëjtë makroekonomike, me politika të kujdesshme kreditimi, me rritjen e përvojës së anëtarëve të shoqërive të kursim -kreditit etj.. Parashikimet për gjashtëmujorin e ardhshëm janë për një nivel të njëjtë rreziku.

Box 13: TENDENCA E TREGUT JOFORMAL TË KREDISË.

Tregu joformal i kredisë vlerësohet të ketë rënë në vitin 2002. Forcimi i mëtejshëm i institucioneve bankare si dhe rënia e normave të interesit për huatë mendohen se janë faktorët kryesorë që kanë ndikuar në këtë zhvillim. Rritja e konkurrencës së tregut zyrtar të kredive si dhe rritja e cilësisë së shërbimit të institucioneve të kreditit duke ju përshtatur nevojave të bizneseve, mendohen se ushtrojnë presion për tkurrjen e këtij tregu. Veprimtaria e tregut joformal mendohet se favorizohet nga “lehtësia në procedura” që ofron ky treg.

Të njëjtin konkluzion mbështesin rreth 600 biznese, kryesisht të klasifikuara si të mëdha dhe të mesme, nga sektorët e prodhimit, të ndërtimit dhe të shërbimeve. Arsyeja kryesore, sipas tyre, e tkurrjes së kredisë joformale është interesi i lartë për kreditë e akorduara nga ky treg.

Rënia e preferencës për kreditim nga tregu joformal përforcohet edhe po t'i referohemi burimeve të financimit të bizneseve. Ashtu sikurse edhe në vitin 1999 mund të themi se burimi kryesor i financimit për bizneset shqiptare vazhdon të jetë fitimi i mbajtur. Por në ndryshim nga viti 1999, rëndësi ka marrë financimi nga parapagimet e porosive si dhe kredia nga sistemi bankar. Gjithësesi, burimet e financimit prej individëve, që nënkuptojnë tregun jozyrtar përbëjnë një burim financimi larg preferencave të bizneseve.

Shih: “Sistemi Bankar në Shqipëri, Probleme të zhvillimit të tij” (Analizë vrojtimi), 1999, Sh. Cani, M. Muço dhe T. Baleta.

III.4. INSTRUMENTET E POLITIKËS MONETARE.


Banka e Shqipërisë, për të dytin vit rradhazi, e mbështeti zbatimin e politikës së saj monetare në operacionet e tregut të hapur, të realizuara përmes instrumenteve indirekte. Përdorimi i instrumenteve indirekte dhe i lehtësive të ofruara nga Banka e Shqipërisë pasqyroi kushtet e tepricës ose të mungesës së likuiditetit në tregun e parasë. Kuadri i instrumenteve indirekte të përdorura prej saj paraqitet në linjë me standardet e Bankës Qendrore Europiane.

Viti i kaluar vlerësohet si një vit i suksesshëm i zbatimit të politikës monetare me anë të instrumenteve indirekte, në drejtim të sinjalizimit të qëndrimit të politikës monetare e të administrimit të situatës së likuiditetit në treg.

III.4.1. ANKANDET DHE NORMAT E INTERESIT TË MARRËVESHJEVE TË RIBLERJEVE NJËJAVORE.

Në ndryshim nga viti 2001, sistemi bankar u karakterizua, në pjesën më të madhe të vitit nga mungesat e likuiditetit, ku ndikuan tërheqjet masive të depozitave.


Grafik 41: Ndryshimi i kushteve të likuiditetit bankar nga teprica në mungesa.



Gjatë vitit 2002, është zbatuar një model për parashikimin e likuiditetit në sistemin bankar. Ky model po përpunohet më tej për të matur masën e ndikimit të faktorëve mbi ecurinë e likuiditetit në të ardhmen e afërt. Modeli aktualisht përdoret për të parashikuar ecurinë e *cash*-it deri në një muaj në të ardhmen. Ky model është i bazuar vetëm mbi lëvizjen historike të *cash*-it për tre vitet e fundit. Metodologjia e përdorur e bazon parashikimin mbi trendin dhe lëvizjet ciklike që vihen re në serinë kohore të *cash*-it. Rezultatet e përfuara nga parashikimi kanë demonstruar një devijim statistikisht të pranueshëm nga të dhënat aktuale.

Në përputhje me ndryshimin e situatës së likuiditetit në treg u kalua nga përdorimi i ankadeve javore të marrëveshjeve të riblerjes, në ankande të marrëveshjeve të anasjelltë të riblerjes.

Grafik 42: Vëllimi mesatar dhe norma e interesit në ankandet e marrëveshjeve të riblerjes/ të anasjellta të riblerjes njëjavore.



(Shkalla majtas në milionë lekë, shkalla djathtas në përqindje.)

Tabelë 30: Treguesit e ankandeve javore të repove/anasjelltë të repove.

Periudha	Numri i ankandeve	Vëllimi (në milionë lekë)		Numri i pjesëmarrësve		Lloji i ankandit
		Gjithsej	Mesatarisht për ankand	Gjithsej	Mesatarisht për ankand	
Janar- mars	13	19,812	1,524	67	5	REPO
Prill – dhjetor	39	67,393	1,728	70	2	R/REPO

Pjesëmarrës kryesor në ankandet e **marrëveshjeve të riblerjeve/të anasjellta të riblerjeve njëjavore**, ka qenë Banka e Kursimeve.

Për shkak të peshës që ka kjo bankë në këto ankande ajo është bërë:

- përcaktuesja kryesore e normës së interesit në ankandet me shumë çmime; si dhe
- përcaktuesja kryesore e vëllimit të transaksioneve në ankandet me çmim fiks.

III.4.2. INSTRUMENTET RREGULLUESE DHE STRUKTURE.

Gjatë vitit të kaluar u përdorën marrëveshjet e anasjellta të riblerjes njëmuajore dhe transaksionet e shitblerjes me të drejta të plota për të bërë rregullime me afat më të gjatë sesa një javë, të likuiditetit në sistemin bankar. Pjesëmarrës në ankandet e marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes njëmuajore ka qenë vetëm Banka e Kursimeve.

Tabelë 31: Ankandet e anasjellta të marrëveshjeve të riblerjes me afat njëmuajor gjatë vitit 2002.

Ankandet e anasjellta të marrëveshjeve të riblerjes me afat njëmuajor	Ofruar në treg (mln lekë)	Kërkuar nga tregu (mln lekë)	Pranuar (mln lekë)	Interesi (%)
Ankandi 1	1,000	1,000	1,000	9.2
Ankandi 2	1,000	1,000	1,000	9.2
Ankandi 3	1,000	1,000	1,000	9.2
Gjithsej	3,000	3,000	3,000	


Tabelë 32: Ankandet e shitjeve me të drejta të plota gjatë vitit 2002.

Ankande të shitjeve me të drejta të plota	Ofruar në treg (mln lekë)	Kërkuar nga tregu (mln lekë)	Pranuar (mln lekë)	Interesi (%)
Ankandi 1	1,300	800	800	9.50
Ankandi 2	2,000	2,300	2,000	11.21
Gjithsej	3,000	3,100	2,800	


III.4.3. REZERVA E DETYRUESHME, LEHTËSITË E PËRHERSHME DHE KREDIA LOMBARD.

Instrumenti i rezervës së detyrueshme, gjatë vitit të kaluar, nuk pësoi ndryshime. Tendenca e rezervës së detyrueshme në lekë dhe në dollarë amerikanë, gjatë vitit të kaluar, pasqyron zhvillimet në gjendjen e depozitave.

Grafik 43: Rezerva e detyrueshme në lekë dhe interesi i remunerimit.
(Majtas në miliardë lekë, djathtas në për qind.)




Grafik 44: Rezerva e detyrueshme në valutë dhe interesi i remunerimit.
(Majtas në miliardë lekë, djathtas në për qind.)



Niveli mesatar vjetor neto i përdorimit të lehtësive të përhershme llogaritet - 1.39 miliardë lekë. Gjatë vitit 2002, në krahasim me vitin e kaluar²³, vëllimi total kumulativ i kredisë njëditore është rritur nga 9,8 miliardë lekë në 487 miliardë lekë (50 herë më shumë).

Grafik 45: Përdorimi mesatar ditor i lehtësive të përhershme, përdorimi mujor neto dhe përdorimi mesatar vjetor, në milionë lekë.



Depozita njëditore nga një lehtësi mjaft e përdorur gjatë vitit 2001²⁴, nuk pati përdorim të madh gjatë vitit 2002, madje, ka patur ditë, që kjo lehtësi nuk është përdorur nga asnjë bankë. Niveli kumulativ i depozitës njëditore është përgjysmuar në krahasim me një vit më parë nga 252 miliardë lekë në 121,3 miliardë lekë. Për herë të parë, për një periudhë dhjetëditore, në fillim të muajit prill, Banka e Shqipërisë i refuzoi bankave pranimin e depozitave njëditore.

Për vitin 2002, kredia lombard, u përdor vetëm një herë në muajin prill. Me qëllim që t'i sigurohej Bankës së Kursimeve përballimi i nevojave më afatgjata për likuiditet, kredia lombard u akordua në masën 2.5 miliardë lekë, për një periudhë njëmuajore.

III.5. TREGJET.


III.5.1. TREGU NDËRBANKAR.

Tregu ndërbankar, i njohur si tregu ku bankat tregtojnë tepricat dhe marrin hua pa vendosur kolateral, njohu zhvillime pozitive gjatë vitit të kaluar. Rritja e kërkesës për likuiditete në treg ndërbankar sidomos nga Banka e Kursimeve, ndërprerja e përkohshme nga Banka e Shqipërisë e pranimit të depozitave njëditore, shtrëngimi i politikës monetare, ndikuan në rritjen e aktivitetit të tregut ndërbankar. Në vitin 2002, vëllimi i transaksioneve në treg ndërbankar paraqitet në nivelin e tij më të lartë që nga viti 2000.

²³ Lehtësia e kredisë njëditore filloi të përdoret për herë të parë në vitin 2001 si pjesë e kuadrit operacional të Bankës së Shqipërisë.


²⁴ Lehtësia e depozitës njëditore filloi të përdoret për herë të parë në vitin 2001 si pjesë e kuadrit operacional të Bankës së Shqipërisë.

Grafik 46: Vëllimi vjetor i transaksioneve në treg ndërbankar, në milionë lekë.




Vëllimi mujor i transaksioneve njohu rritje duke filluar që nga muaji prill, pikërisht atëherë kur u rrit edhe kërkesa në treg ndërbankar nga Banka e Kursimeve.

Grafik 47: Vëllimi mujor i transaksioneve në treg ndërbankar, në për qind.



Ndarja sipas maturiteteve konfirmon se shumica e transaksioneve të tregut midis bankave u përqendrua në segmentin e njëditoreve, të cilat njohin një rritje prej 57.2 për qind krahasuar me vitin 2001. Tkurrje njohin transaksionet me afat 7-26 ditë, ndërsa transaksionet në maturitetet e tjera janë ulur ndjeshëm ose nuk janë zhvilluar të tilla.

Grafik 48: Vëllimi i transaksioneve sipas maturitetit, në për qind.



III.5.2. TREGU PRIMAR I LETRAVE ME VLERË TË QEVERISË.


Tregu primar i bonove të thesarit të qeverisë ishte forma kryesore e financimit të deficitit buxhetor për vitin 2002. Vëllimi i transaksioneve në treg primar ka patur tendencë të rritet nga njëri vit në tjetrin.

Pjesëmarrës në tregun primar kanë qenë bankat e nivelit të dytë, institucionet e ndryshme financiare jobanka dhe individët. Për vitin 2002, portofoli i bankave tregtare është reduktuar me 1.25 pikë përqindjeje, ndërkohë që portofoli i individëve është rritur me 1.82 pikë përqindjeje. Pjesa kryesore e kësaj rritjeje i përket individëve që veprojnë drejtpërdrejt në sportelet e Bankës së Shqipërisë dhe të filialeve të saj në rrethe. Pjesëmarrja e individëve në këtë formë investimi u rrit dukshëm, kryesisht, pas periudhës së tërheqjes masive të depozitave nga dy bankat kryesore.

Tabelë 33: Investimet nga individët, në milionë lekë.

	Viti 2001	Viti 2002
Në sistemin bankar & Bankën e Shqipërisë	2,505	7,810
Në Bankën e Shqipërisë	373	5,065

Grafik 49: Vëllimi i transaksioneve të kryera në treg primar në vite, në milionë lekë.




Tipar dallues i këtij tregu gjatë vitit 2002 ishte kërkesa më e lartë për fonde e buxhetit të shtetit. Rezulton se mesatarisht, në çdo anka të vitit të kaluar, qeveria ka kërkuar 1.2 miliardë lekë më shumë se maturimet. Kjo ndodhi në kushtet e mosrealizimit të të ardhurave nga privatizimi, të ecurisë së realizimit të të ardhurave dhe të nivelit të kryerjes së shpenzimeve nga ana e qeverisë.

Rritja e kërkesës në tregun primar u ballafaqua me përkeqësimin e shpejtë të gjendjes së likuiditetit në sistemin bankar. Ky ishte edhe tregu i investimeve ku u pa dukshëm mungesa e likuiditetit të sistemit bankar. Në disa raste, niveli i lartë i mosplotësimit të shumave të shpallura nga Ministria e Financave për bono thesari krijoi mungesa likuiditeti në llogarinë e qeverisë duke e bërë të nevojshme ndërhyrjen e Bankës së Shqipërisë me kredi direkte. Kjo gjë solli

zhvendosjen e financimit të deficitit, nga bankat tregtare në Bankën e Shqipërisë. Për pasojë u rritën pretendimet neto të Bankës së Shqipërisë ndaj qeverisë dhe u devijua nga programi i miratuar, i cili nuk parashikonte financim të deficitit buxhetor nga Banka e Shqipërisë. Në periudhën qershor-korrik u bë konvertimi i plotë i kredisë direkte të qeverisë me anë të blerjes së bonove të thesarit prej Bankës së Shqipërisë. Një situatë e ngjashme u përsërit edhe në fund të vitit, kur për të mbuluar pjesën e financimit të brendshëm të paplotësuar nga tregu u akordua kredi direkte. Megjithatë, nuk u shkel limiti i përcaktuar për financimin e brendshëm të deficitit buxhetor.

Ndonëse situata e likuiditetit të qeverisë, në përgjithësi për vitin 2002, ka qenë e ekuilibruar, përsëri u vunë re momente të përqendrimit të shpenzimeve, veçanërisht në fund të vitit. Gjatë muajve nëntor dhe dhjetor, Ministria e Financave emtoi përkatësisht rreth 1.6 dhe 3.4 miliardë lekë bono thesari më tepër se maturimet. Për të plotësuar nevojat për likuiditete të qeverisë, në fillim të muajit dhjetor, me vendim të Komitetit të Huave të Brendshme, është derdhur për llogari të buxhetit fitimi i muajit dhjetor, në masën 503 milionë lekë. Në vijim të përpjekjeve për të krijuar tepricën e nevojshme në llogarinë e saj për të realizuar shpenzimet e fundvitit, Ministria e Financave i është drejtuar Bankës së Shqipërisë me kërkesën për kredi direkte si edhe për derdhjen e fitimit mbi plan të Bankës së Shqipërisë në masën e përgjithshme 1.95 miliardë lekë. Në fund të vitit 2002, Banka e Shqipërisë i ka akorduar Ministrisë së Financave kredi direkte në masën 1,1 miliardë lekë. Në vijim, pas njohjes së saktë të vlerës së fitimit për vitin 2002, Banka e Shqipërisë ka transferuar në llogarinë e Ministrisë së Financave pjesën e vlerës së fitimit në datën 14 janar 2003. Të gjitha këto veprime, mundësuan kalimin e shpenzimeve të nevojshme për fundin e vitit dhe mbylljen e veprimeve të datës 31 dhjetor, rreth mesit të muajit janar 2003.

Grafik 50: Plotësimi i kërkesës së qeverisë për bono thesari nga tregu, në për qind.



Tabelë 34: Emetimet dhe maturimet e bonove të thesarit në ankandet e tregut primar dhe kredia direkte e Bankës së Shqipërisë, në miliardë lekë.

	Vlera nominale e emetuar nga qeveria	Vlera nominale e maturimeve	Kredia direkte për qeverinë
Tremujori i parë	142.41	136.26	5.50
Tremujori i dytë	137.01	133.50	3.90
Tremujori i tretë	139.01	128.60	-
Tremujori i katërt	140.01	133.88	1.14
Gjithsej	558.47	532.25	10.54

Për herë të parë gjatë vitit të kaluar, u hodhën në treg obligacione të qeverisë me afat dyvjeçar. Për emetimin e tyre u përdor forma e ankandit dhe çmimi u vendos uniform për të gjitha kërkesat. Kuponi i obligacionit është përcaktuar fiks dhe është i pagueshëm çdo gjashtë muaj. Këto obligacione janë të tregtueshme para afatit të maturimit.

Tabelë 35: Ankandet e obligacioneve të qeverisë me afat dyvjeçar.

Ankandet e obligacioneve dyvjeçare	Ofruar në treg (në milionë lekë)	Numri i bankave pjesëmarrëse	Interesi i ofruar (%)	Interesi (%)
Ankandi 1	300	1	14.5	14.5
Ankandi 2	300	3	14.3	14.1
Ankandi 3	400	4	14.1	14.0

Ndonëse, shumica e ofruar e obligacioneve dyvjeçare ka qenë relativisht e vogël, interesimi i bankave dhe konkurrenca ndërmjet tyre për të marrë pjesë në këto ankande erdhi gjithnjë e në rritje. Kjo u mundësua dhe nga ofrimi i depozitave dyvjeçare nga bankat.

III.5.3. TREGU VALUTOR.

Gjatë vitit 2002, kursi i këmbimit të lekut ndaj valutave kryesore ka ndjekur kryesisht prirjet sezonale të faktuara edhe në vitet e mëparshme, si edhe ecurinë e valutave kryesore në tregun ndërkombëtar të këmbimit. Në fund të vitit 2002, për të blerë një dollar amerikan dhe një euro duheshin përkatësisht, 133.8 lekë dhe 140.2 lekë. Duke krahasuar kurset e këmbimit të fundit të vitit 2002 me fundvitin 2001, leku u nënçmua 18.3 pikë përqindjeje në raport me euron dhe u mbiçmua 2.2 pikë përqindjeje në raport me dollarin amerikan.

Situata e vështirë e likuiditetit të sistemit bankar në pjesën e parë të vitit, përkoj me një moment delikat në raportet midis kërkesës dhe ofertës për valutë në tregun e brendshëm valutor. Tërheqja e depozitave (kryesisht në lek) nga një pjesë e bankave të nivelit të dytë, rriti më tej likuiditetin jashtë sistemit, i cili paraqitej i lartë si rezultat ofertës (shitjeve) së shtuar të njësive monetare kombëtare (DEM, ITL dhe GRD) përbërëse të euros, në periudhën e fundit të vitit 2001 dhe në fillimin e vitit 2002, kur u krye zëvendësimi fizik i tyre me euron. Efekti i kombinuar i këtyre zhvillimeve, shkaktoi një nënçmim të shpejtë të lekut në muajt mars, prill dhe maj.

Situata politike në vend, zhvillimet në normën e inflacionit si edhe flukset valutore të kundërta me ato të fundit të vitit (e lidhur me elemente sezonale), nxitën një dobësim të lekut në pjesën e parë të vitit. Për këtë arsye, gjatë muajit prill dhe fillimit të muajit maj, veprimet e Bankës së Shqipërisë në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore kanë synuar dhe kanë arritur frenimin e një nënçmimi të shpejtë të lekut. Por në periudhën e fundit të muajit maj, kufizimet në veprime si rezultat i zhvillimeve të padëshiruara në treguesin e NFA, si edhe forcimi i shpejtë i euros në tregun ndërkombëtar krijuan kushtet për një dobësim të fortë të lekut ndaj saj (3.0 për qind brenda një jave).

Kërkesa për valutë nga sistemi bankar ka qenë mjaft e lartë dhe e përqendruar në këtë periudhë. Ky fakt, ka krijuar presione të forta disaditore, shpesh të konsideruara të ekzagjeruara. Ndërkohë, rëniet e vlerave në periudhat që pasonin, janë shfrytëzuar për të krijuar pozicione të reja në valutë nga ana e operatorëve të tregut të brendshëm valutë.

Fenomeni i varësisë së lartë të kurseve të këmbimit nga aktiviteti i bankave të nivelit të dytë është një fenomen në rritje në vitet e fundit dhe i mirëpritur, pasi krijon mundësi më të mira për transmetimin e mesazheve të Bankës së Shqipërisë në tregun e këmbimeve valutore. Për t'iu përgjigjur këtij niveli më të lartë të zhvillimit të tregut, Banka e Shqipërisë është përpjekur të përmirësojë vazhdimisht kapacitetin analizues si edhe procedural në drejtim të identifikimit në kohë të zhvillimeve të padëshirueshme në kursin e këmbimit dhe përcaktimin e mënyrave më të përshtatshme për trajtimin e tyre. Në çdo rast kur ndërhyrja është konsideruar e nevojshme, është synuar arritja e objektivit me sa më pak veprime.

Gjatë vitit 2002, Banka e Shqipërisë ka ndërhyrë²⁵ në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore, në dy periudha: mars-prill-maj dhe dhjetor. Kahu i ndërhyrjes ka qenë i ndryshëm për të dyja periudhat. Në periudhën e parë janë shitur gjithsej 4.94 milionë dollarë amerikanë, me një nivel mesatar të kursit të këmbimit prej 145.02 lekësh, si edhe 0.4 milionë euro me një nivel mesatar të kursit të këmbimit prej 131.4 lekësh. Në muajin dhjetor, janë blerë 1.8 milionë dollarë amerikanë me një nivel mesatar të kursit të këmbimit prej 133.74 lekësh dhe 0.2 milionë euro me një nivel mesatar të kursit të këmbimit prej 136.2 lekësh.

III.5.4. TREGU I KAPITALEVE.

Tregu i kapitaleve mbeti elementi më i pazhvilluar në bashkësinë e tregjeve. Viti 2002 përbën të tretin vit rradhazi që në sesionet e Bursës së Tiranës nuk regjistrohet asnjë transaksion në letrat me vlerë dhe nuk u kuotua asnjë shoqëri aksionere.


Përfundimisht Bursa e Tiranës u shkëput administrativisht nga Banka e Shqipërisë në qershor të vitit 2002. Më pas, në muajin nëntor 2002, Komisioni i Letrave me Vlerë vendosi dhënien e licencës provizore për treg letrash me vlerë Bursës së Tiranës.

²⁵ Në formën e veprimeve të kryera me bankat e nivelit të dytë, në mënyrë aktive ose pasive, sipas vendimit të mbledhjes javore.

III.6. NORMAT E INTERESIT NË EKONOMI.

Banka e Shqipërisë gjatë vitit 2002 rriti dy herë normën bazë të interesit. Rritjet ishin përkatësisht 0.5 dhe 1 pikë përqindjeje në bazë të vendimeve të Këshillit Mbikëqyrës të datës 21 mars dhe 10 prill 2002. Për pasojë, ecuria e normave të interesit në ekonomi gjatë vitit të kaluar pasqyron shtrëngimin e politikës monetare nga Banka e Shqipërisë. Në tërësi, tendenca ka qenë rritja e normave të interesit. Por, shkalla e pasqyimit të vendimeve të politikës monetare si në kohë dhe në madhësi është e ndryshme për tregje të ndryshme. Po kështu, në varësi të shpejtësisë së reagimit, disa tregje kanë reaguar më shpejt dhe menjëherë duke u karakterizuar më pas nga qëndrueshmëria e normave të interesit. Tregjet e tjera kanë patur ndryshime graduale deri sa i janë përafëruar shkallës së ndryshimit të normës bazë nga banka qendrore.

Grafik 51: Reagimi i bankave ndaj sinjaleve të politikës monetare.




Tabelë 36: Periudha kur u evidentua reagimi më i madh i bankave, në përqindje.

Pesha që zuri rritja e interesave në këtë periudhë, ndaj rritjes gjithsej			
Në tregun e depozitave	maj - korrik 2002		tetor 2002
Depozita 1-mujore	82		
Depozita 3-mujore	96		
Depozita 6-mujore	56		25
Depozita 12- mujore	61		20
Në tregun primar	11 prill - 2 maj 2002	5 shtator	27 nëntor
Bono thesari 3-mujore	46	15	15
Bono thesari 6-mujore	60	20	
Bono thesari 12-mujore	58	16	


Kështu, rritja e *yield*-it mesatar të ponderuar, ka qenë 1.2 pikë përqindjeje më e lartë se rritja e sinjalizuar nga Banka e Shqipërisë.

Grafik 52: Yield-i mesatar i ponderuar në treg primar.



Tregu ndërbankar ka reaguar shpejt ndaj sinjaleve të politikës monetare.

Grafik 53: Normat e interesit në treg ndërbankar, në përqindje.



Në tregun e depozitave në lekë reagimi ndaj ndryshimit të politikës monetare ishte fillimisht i vonuar e më pas gradual dhe i vazhdueshëm.

Tabelë 37: Hapësira e pashfrytëzuar nga sistemi bankar për rritjen e interesave të depozitave në lekë, në përqindje.


Interesi i depozitave me afat	Rritja e interesave mesatarë të ponderuar të depozitave në lekë janar- dhjetor 2002	
		Ndryshimi me rritjen e normës bazë të interesit
3-mujor	1.05	-0.45
6-mujor	1.52	0.02
12-mujor	1.49	-0.01
Totali ²⁶	1,17	-0.33

Karakteristikë e tregut të depozitave është se:

- ndryshimi i normave afatshkurtra të interesit transmetohet në normat e interesit të depozitave ngadalë dhe në mënyrë jo të plotë;
- nga vlerësimet e simulimeve verifikohet se vetëm 70 për qind e efektit të ndryshimit të normave të interesit, transmetohet tek normat e interesit të depozitave brenda një tremujori. Pjesa tjetër e efektit transmetohet më vonë dhe për pasojë më ngadalë.

²⁶ Llogaritur në bazë të interesit mesatar të ponderuar për depozitat me afat 3, 6 dhe 12-mujor.

Grafik 54: Krahasimi i interesave të depozitave në valutë me interesat bazë të Fed-it dhe të BQE-së.




Tendenca e kundërt në ecurinë e interesave të depozitave në lekë dhe në valutë kanë ndikuar në nxitjen e popullsisë për të investuar në lekë.

Tabelë 38: Interesi mesatar vjetor për depozitat me afat dymbëdhjetëmujor në lekë dhe interesi dymbëdhjetëmujor në valutë i konvertuar në lekë, në për qind.


Viti	Mesatar vjetor i sistemit në lekë	Interesi në usd i konvertuar në lekë në nivel mesatar vjetor	Interesi në euro i konvertuar në lekë në nivel mesatar vjetor
1999	12.38	8.28	6.79
2000	7.99	4.45	-0.30
2001	7.72	1.12	7.17
2002	8.54	1.00	4.37

Grafik 55: Diferenca midis interesit të depozitave 12-mujore në lekë dhe në usd e euro dhe mesatarja historike, në pikë përqindjeje.




Niveli real i interesave²⁷ për depozitat në lekë, për vitin e kaluar, rezultoi në terma pozitive. Rritja e të ardhurave reale të depozituesve nga depozitat në lekë, u ndikua nga rritja e interesit nominal të depozitave me afat dymbëdhjetëmujor në lekë në tregun e depozitave nga 7.74 për qind në muajin janar, në 9.25 për qind në muajin dhjetor dhe nga tendenca rënëse nga një muaj në tjetrin e nivelit vjetor të inflacionit, nga 6.5 për qind në muajin janar, në 2.1 për qind, në muajin dhjetor.

Grafik 56: Interesi real për depozitat me afat dymbëdhjetëmujor në lekë dhe niveli mesatar vjetor, në përqindje.



Interesi mesatar i ponderuar për kreditë e akorduara në lekë si sistem bankar në fund të vitit 2002 shënoi një rritje me 2.91 pikë përqindjeje, krahasuar me muajin dhjetor të vitit 2001.


Grafik 57: Ecuria e normave të interesit të kredisë sipas afateve të maturimit, në përqindje.



Diferenca e interesit mesatar të ponderuar për kreditë e akorduara dhe depozitat e pranuar në lekë në fund të vitit 2002 është 7.87 pikë përqindjeje. Edhe pse numri i bankave që kreditojnë në lekë vjen duke u rritur, përsëri një ose dy banka bëhen përcaktuese në interesin mesatar të ponderuar për kreditë e lëvruara në lekë si sistem bankar. Lulatshëmëria e kësaj difference është pothuajse e njëjtë me atë të interesit të kredive në lekë.

²⁷ Niveli i pritshëm i interesave realë në lekë është llogaritur duke marrë për bazë nivelin e parashikuar të inflacionit vjetor për vitin 2003, sipas metodës së mesatareve historike.

Grafik 58: Ecuria e interesit mesatar të ponderuar për kreditë e lëvruara në valutë, në përqindje.



KAPITULLI IV: MBIKËQYRJA BANKARE

Mbikëqyrja bankare gjatë vitit 2002 është përpjekur të sigurojë zbatimin e ligjeve dhe të rregulloreve të vendosura nga Banka e Shqipërisë, të ndihmojë në krijimin e një sistemi bankar efikas dhe konkurrues, të sigurojë depozituesit dhe aksionerët për një administrim sa më të mirë të mjeteve të tyre. Ajo ka luajtur një rol të rëndësishëm në evidentimin dhe në zgjidhjen e problemeve të bankave të veçanta.

IV.1. LICENCIMI DHE KUADRI RREGULLATOR.

IV.1.1. LICENCIMI.

Politika e licencimit të bankave dhe subjekteve të tjera, gjatë vitit 2002 në krahasim me një vit më parë, nuk ka ndryshuar. Banka e Shqipërisë ka ruajtur të njëjtën kërkesë për shumën e kapitalit minimal të kërkuar për hapjen e një banke. E veçanta e këtij viti është paraqitja e kërkesës për marrjen e licencës për të kryer veprimtari bankare nga persona juridikë dhe fizikë shqiptarë.

Në vitin 2002:

- Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë mori vendimin për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë “Bankës së Kreditit të Shqipërisë”.
- Banka e Shqipërisë ka shqyrtuar paraprakisht kërkesat e bankave për hapjen e 9 degëve dhe 1 agjencie të reja.
- Është miratuar licenca për subjektin jobankë “Fondi i Financimit të Zonave Malore”, si subjekt për të ushtruar veprimtarinë e dhënies së kredive. Nga subjektet jobanka të licencuara, “Posta Shqiptare sh.a” ka zgjeruar veprimtarinë e saj, me aktivitetin për të shërbyer si agjente ose si këshilltore financiare si dhe është pajisur me licencën për kryerjen e aktivitetit të këmbimit valutor në disa rrethe të vendit.
- Mbi bazën e rregullores “Për licencimin e shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre” në bashkëpunim me Fondin e Financimit Rural dhe me fondacionin “Lëvizja për zhvillimin e shoqërive të kursim-kreditit” u licencuan 113 shoqëri të kursim-kreditit dhe 2 unione të shoqërive të kursim-kreditit.
- Bankat dhe degët e bankave të huaja bëjnë ndryshimin e administratorëve dhe të aksionerëve të tyre vetëm pas marrjes së miratimit paraprak të Bankës së Shqipërisë. Banka e Shqipërisë ka dhënë miratimin paraprak për rreth 40 administratorë të rinj të bankave dhe të degëve të bankave të huaja, ku përfshihen anëtarë të këshillit drejtues, anëtarë të komitetit të kontrollit, drejtorë të përgjithshëm, drejtorë departamentesh dhe drejtuesit e degëve të bankave.
- Banka e Shqipërisë, gjatë vitit 2002, në zbatim të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” miratoi paraprakisht pjesëmarrjen e Commerzbank AG, me 20 për qind të kapitalit të Bankës FEFAD.

Tabelë 39: Lista e subjekteve të licencuara nga Banka e Shqipërisë.

Nr.	Subjektet	Viti 2000	Viti 2001	Viti 2002
1	Banka dhe degë të bankave të huaja	13	13	14
2	Subjekte financiare jobanka	2	4	5
3	Zyra të këmbimit valutor	19	38	58
4	Shoqëri të kursim-kreditit			113
5	Unione të shoqërive të kursim-kreditit			2

IV.1.2. KUADRI RREGULLATOR MBIKËQYRËS.

Gjatë vitit 2002 kuadri rregullator i mbikëqyrjes bankare u plotësua me akte të reja rregullatore të rëndësishme, që kishin të bënin me formalizimin dhe me rregullimin e shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre dhe me kujdestarinë e likuidimin e bankave. Po gjatë vitit 2002, kuadri rregullator ekzistues u përmirësua me ndryshimin e disa rregulloreve për t'iu përshtatur ndryshimeve aktuale në tregun e produkteve dhe të shërbimeve bankare.

1. Aktet e reja rregullative:

a) *Rregullorja “Për licencimin e shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre”, miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 11, datë 27.02.02.*

Licencimi i shoqërive të kursim-kreditit dhe unioneve të tyre është një hap cilësor drejt kthimit të këtyre institucioneve të mikrofinancës në institucione formale të mbikëqyrura nga një autoritet përgjegjës si Banka e Shqipërisë. Ligji “Për shoqëritë e Kursim- Kreditit”, përcaktoi Bankën e Shqipërisë si autoritetin mbikëqyrës edhe të shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre. Mbi këtë bazë, Banka e Shqipërisë nxori aktet e brendshme rregullative lidhur me licencimin dhe me mbikëqyrjen e këtyre subjeteve të mikrofinancës. Format i rregullores është i ngjashëm me formatin standard të disa dokumenteve të tjera të licencimit për subjekte të tjera.

b) *Rregullorja “Për mbikëqyrjen e shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre”, miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 67, datë 28.08.02.*

Rregullorja “Për mbikëqyrjen e shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre” është dokumenti i dytë, i cili plotëson kuadrin rregullativ mbikëqyrës për shoqëritë e kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre. Ndërsa, me miratimin e rregullores “Për licencimin e shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre” bëhet formalizimi i këtyre institucioneve në tregun financiar.

c) *Udhëzimi “Mbi kujdestarinë dhe likuidimin e bankave”, miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 45, datë 12.06.02.*

Udhëzimi “Mbi kujdestarinë dhe likuidimin e bankave” nxirret në zbatim të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”. Procedurat që trajtohen në këtë udhëzim kanë të bëjnë me situata në të cilat bankat, si rezultat i aktivitetit të tyre ose si rezultat i zhvillimeve jashtë tyre, përballen me probleme financiare, të cilat kanë nevojë për ndërhyrje nga jashtë.

2. Përmirësimi i akteve rregullative ekzistuese:

a) *Ndryshim në rregulloren “Për menaxhimin e riskut të kredisë”, miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 31, datë 08.05.02.*

Ndryshimet e propozuara në rregulloren “Për menaxhimin e rrezikut të kredisë”, u diktuan nga përvoja praktike për përdorimin e kredisë kufi. Ato janë saktësime dhe plotësime në kuadrin rregullativ për të rritur efektivitetin e mbikëqyrjes bankare për këtë veprimtari të veçantë.

b) *Për një ndryshim në rregulloren “Për mjaftueshmërinë e kapitalit”, miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 72, datë 11.09.02.*

IV.2. ECURIA E SISTEMIT BANKAR²⁸.

Gjendja financiare e sistemit bankar në fundvitin 2002 vlerësohet e mirë, sistemi bankar evidenton të ardhura neto pozitive prej 3,9 miliardë lekësh ose rreth 0,6 për qind e PBB-së. Niveli i këtij treguesi, krahasuar me fundvitin 2001, është më i ulët për 0,4 miliardë lekë ose 9,4 për qind (në terma realë rënia llogaritet 11 për qind). Janë pikërisht rezultatet e politikave dhe të vendimeve administruese të institucioneve financiare dhe aftësitë e tyre në konvertimin e aktiveve në të ardhura neto, të cilat reflektohen në treguesit e rentabilitetit. E ndërsa ROA tregon aftësinë e institucionit për të operuar në tërësi me fitim, ROE tregon mundësinë e rritjes së investimeve. Këta tregues evidentohen brenda niveleve normale²⁹.

Tabelë 40: Tregues të rentabilitetit për vitin 2002, në përqindje.

Treguesi	Sistemi bankar	G1	G2	G3
ROA*	1.2	1.2	0.6	1.3
ROE*	19.1	47.6	3.4	13.1
Të ardhurat neto nga interesat /aktive mesatare gjithsej	2.7	2.2	3.2	3.5
Shpenzime të veprimtarisë /aktive mesatare gjithsej	1.7	1.1	2.9	2.4
Shpenzime për provigjone / aktive mesatare gjithsej	0.3	0.1	2.0	0.5

*Kthyeshmëria nga aktivet.

**Kthyeshmëria nga fondet e veta.

Tabelë 41: Tregues të rentabilitetit, ecuria në vite.

Treguesi në %	Dhjetor '99	Dhjetor '00	Dhjetor '01	Dhjetor '02
ROA	0.5	2.1	1.5	1.2
ROE	15.7	20.6	21.6	19.1

²⁸ Pjesa e tregut financiar të licencuar nga Banka e Shqipërisë po njih zhvillime modeste nga një periudhë në tjetrën. Në vend operojnë gjithsej pesë institucione financiare jobanka. Totali i aktiveve të këtyre institucioneve përbën rreth 0,9 për qind të totalit të aktiveve të sistemit bankar. Pësia modeste e këtyre institucioneve vërteton në të njëjtën kohë që sistemi financiar shqiptar ende identifikohet me sistemin bankar. Gjithashtu, në këtë të fundit, vlen të përmendet dhe veprimtaria e 59 zyrave të këmbimeve valutore, 109 shoqërive të kursim-kreditit dhe të 2 unioneve të tyre.

²⁹ Niveli normal i ROA konsiderohet 0.5 – 1.6 për qind, ndërsa për ROE 10 – 20 për qind.

E ardhura neto nga aktiviteti kryesor i sistemit bankar rezulton 11,2 miliardë lekë pothuajse në të njëjtat nivele sa edhe në vitin 2001. Nga këto të ardhura rreth 78,7 për qind e përbëjnë të ardhurat neto nga interesat, të cilat vazhdojnë të japin dhe kontributin kryesor në të ardhurën neto, ndërsa pjesa tjetër e të ardhurave rrjedh kryesisht nga komisionet dhe nga veprimtaria valutore.

Tabelë 42: Ecuria e të ardhurave dhe e shpenzimeve financiare, rezultati financiar.

Treguesi në miliardë lekë	Dhjetor '99	Dhjetor '00	Dhjetor '01	Dhjetor '02
Totali i të ardhurave	39.1	31.0	29.2	28.0
Totali i shpenzimeve	37.9	25.7	24.9	24.1
E ardhura neto (fitimi)	1.2	5.3	4.3	3.9

Tabelë 43: Ecuria e të ardhurave dhe e shpenzimeve nga aktiviteti kryesor, e ardhura neto.

Treguesi në miliardë lekë	Dhjetor '99	Dhjetor '00	Dhjetor '01	Dhjetor '02
Të ardhurat nga veprimtaria kryesore	37.5	27.0	26.1	26.9
Shpenzime për veprimtarinë kryesore	31.1	17.1	15.0	15.7
E ardhura neto	6.4	9.9	11.1	11.2
Nga kjo: e ardhura neto nga interesat	5.2	7.7	8.7	8.8

Shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë për sistemin bankar rezultojnë 5,5 miliardë lekë duke evidentuar një rritje për rreth 0,7 miliardë lekësh krahasuar me vitin 2001, ndërkohë që edhe shpenzimet për provigjone evidentojnë rritje për rreth 0,04 miliardë lekë. Niveli relativisht i konsiderueshëm i këtyre shpenzimeve ndonëse ndikon negativisht në të ardhurën neto të sistemit, i shërben zgjerimit të aktivitetit të bankave, përmirësimit të teknologjisë dhe informacionit, si dhe mbulimit të humbjeve të mundshme nga moskthimi i kredive (kërkesë rregullatore).

Tabelë 44: Raporti i efikasitetit.

Treguesi në miliardë lekë	Dhjetor '99	Dhjetor '00	Dhjetor '01	Dhjetor '02
Shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë	3.2	4.0	4.8	5.5
Të ardhurat bruto të veprimtarisë	4.8	11.5	10.4	10.5
Raporti i efikasitetit (në %)	65.9	34.5	46.3	52.7

Aktivet e sistemit bankar janë rritur për 20,9 miliardë lekë ose 6,5 për qind në terma nominalë, ndërkohë që rritja reale llogaritet 3,4 për qind. Krahasuar me vitin e kaluar, i cili evidentoi rritje nominale të totalit të aktiveve të sistemit bankar për 17,6 për qind ose 46,7 miliardë lekë, duhet të përmendim se shkak i ritmit më të ulët rritës, është ngjarja e tërheqjes së konsiderueshme të depozitave nga Banka e Kursimeve dhe nga Banka Kombëtare Tregtare gjatë muajve mars-prill. Kështu, ndërsa në muajin shkurt sistemi evidentoi rritje për 7,3 miliardë lekë krahasuar me fundvitin 2001, në muajin mars rënia evidentohet 7,6 miliardë lekë krahasuar me muajin shkurt dhe 385,6 milionë lekë krahasuar me fundvitin. Në muajin prill evidentohet tërheqje më e madhe e depozitave nga këto banka, e cila jep efekt në një rënie të totalit të aktiveve të sistemit bankar në muajin qershor për 3,9 miliardë lekë krahasuar me fundvitin 2001. Ndërkohë, është muaji gusht në të cilin sistemi bankar

prezanton rritje krahasuar me fundvitin, rritje kjo që vazhdon të shfaqet edhe në muajt e tjerë të vitit 2002.


Tabelë 45: Totali i aktiveve, ecuria në vite.

Treguesi në miliardë lekë	Dhjetor '99	Dhjetor '00	Dhjetor '01	Dhjetor '02
Totali i aktiveve	249.5	270.8	318.5	339.3
Në % ndaj PBB	51.1	49.1	53.5	51.6

Në analizën sipas grupbankave të sistemit, grupi i bankave me kapital shtetëror (që aktualisht përbëhet vetëm nga Banka e Kursimeve) evidenton rënie të totalit të aktiveve për 4,9 miliardë lekë, grupi i bankave me kapital të përbashkët një rritje për 447 milionë, ndërkohë që rritja në grupin e bankave me kapital privat për 25.4 miliardë lekë konfirmon rëndësinë e këtij të fundit në rritjen e aktiveve të sistemit bankar gjatë vitit 2002.

Zgjerimi i aktivitetit të bankave private (G3) po e përfron kontributin e këtij grupi në aktivitetin bankar me atë të grupit të bankave me kapital shtetëror. Peshë e aktiveve të G3 ndaj sistemit bankar prej 40,3 për qind është vetëm 13.8 pikë përqindjeje më e ulët se peshë e G1.

Grafik 59: Peshë e grupbankave në vite në sistemin bankar sipas totalit të aktiveve.



Tabelë 46: Peshë e grupeve bankare sipas disa treguesve ndaj totalit të sistemit bankar (në përqindje).

Treguesi	G1		G2		G3	
	2001	2002	2001	2002	2001	2002
Llogaritë rrjedhëse dhe depozitat	63.5	58.1	4.8	4.9	31.7	37.0
Kapitali aksioner	20.9	24.7	18.6	16.3	60.5	59.0
Kredia neto	3.2	1.3	22.8	16.1	74.0	82.6
Bono thesari	81.2	78.2	0.9	1.4	17.9	20.4
Vendosje në banka	40.0	36.7	10.5	11.5	49.5	51.8
Totali i aktiveve të grupit (miliardë lekë)	188.5	183.6	18.6	19.1	111.3	136.7

Gjatë vitit 2002 aktiviteti kreditues i bankave të sistemit prezantoi ecuri të kënaqshme, si në aspektin sasior ashtu dhe në atë cilësor. Kështu, teprica e kredisë evidentoi rritje për 10,9 miliardë lekë, e përqendruar kryesisht në kredinë afatshkurtër megjithëse me një tendencë në rënie gjatë vitit 2002.

Treguesi i cilësisë së këtij portofoli (raporti i kredive me probleme ndaj tepricës së kredisë) llogaritet 5,6 për qind nga 6,9 për qind në fundvitin 2001. Niveli më i ulët i këtij treguesi evidenton përmirësim të cilësisë së kreditimit.

Tabelë 47: Tregues të portofolit të kredive në përqindje ndaj kredive të klasifikuara.

Treguesi	Sistemi bankar		G1		G2		G3	
	2001	2002	2001	2002	2001	2002	2001	2002
Kredi të klasifikuara*	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0
Standarde	88.3	89.9	72.3	79.8	66.4	70.1	96.0	94.4
në ndjekje	4.6	4.6	20.3	5.4	14.4	8.4	0.8	3.8
nënstandarde	4.0	3.0	0.6	1.6	14.0	11.9	1.1	1.1
të dyshimta	1.7	0.7	0.2	0.4	4.8	3.0	0.8	0.2
të humbura	1.3	1.8	6.6	12.7	0.3	6.6	1.3	0.6
Mbulimi me provigjone	4.4	4.2	8.5	14.3	7.4	11.6	3.3	2.4

* Kreditë standarde dhe ato në ndjekje klasifikohen si kredi të rregullta, ndërkohë që tre grupet e tjera të kredive trajtohen si kredi me probleme.

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit, si treguesi që vlerëson fuqinë e një banke, bën në të njëjtën kohë dhe vlerësimin e mbarëvajtjes dhe të sigurisë së sistemit bankar në tërësi. Edhe në fund të vitit 2002, raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit për sistemin bankar shqiptar vazhdon të evidentojë një nivel relativisht të lartë prej 31,5 për qind³⁰, ndonëse krahasuar me vitin 2001 ky raport evidenton rënie.

Tabelë 48: Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit sipas grupbankave në fund të vitit 2001.

Treguesi	Sistemi bankar	G1	G2	G3
Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit	35,3	29,9	40,4	35,7

Dy janë elementet e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit – *kapitali rregullator* dhe *aktivet e klasifikuara sipas rrezikut*, të cilët japin ndikim edhe në këto nivele të raportit. E ndërsa kapitali rregullator rritet me 6,9 për qind ose rreth 1,2 miliardë lekë krahasuar me fundvitin 2001, aktivet e klasifikuara sipas rrezikut relatojnë një rritje për 19,4 për qind ose rreth 9 miliardë lekë (kryesisht kredidhënia). Është pikërisht grupi i bankave private, që duke e zgjeruar shumë shtrirjen në aktivet me rrezik, jep ndikim kryesor në rënien e raportit të sistemit. Kështu, raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit për grupin e bankave me kapital privat evidenton nivelin më të ulët 28,9 për qind, për grupin e bankave me kapital shtetëror 33,3 për qind dhe për grupin e bankave me kapital të përbashkët 43,6 për qind. Pra, analiza e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit sipas grupbankave të sistemit dallon grupin e bankave private me rënie të raportit, ndërkohë që dy grupet e tjera evidentojnë rritje. Kjo vlerëson edhe një herë kontributin në rritje të bankave private në investimet më me rrezik, kontribut i cili parashikohet të jetë më i

³⁰ Norma minimale e kërkuar e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit është 12 për qind.

madh duke marrë në konsideratë kapacitetet e brendshme dhe nivelet e kënaqshme të kapitalit që kanë këto banka.

Tabelë 49: Struktura e aktiveve të klasifikuara sipas shkallës së rrezikut, në përqindje ndaj totalit të aktiveve dhe zërave jashtë bilancit të klasifikuara sipas rrezikut.

Treguesi	Sistemi bankar	G1	G2	G3
Aktive pa rrezik	65.1	85.2	18.2	43.0
Aktive me rrezik të ulët	21.3	12.6	38.1	31.4
Aktive me rrezik të mesëm	3.0	0.1	23.3	4.0
Aktive me rrezik të lartë	10.6	2.1	20.5	21.6

Analiza e treguesve kryesorë të likuiditetit evidenton nivel të kënaqshëm të tij edhe për vitin 2002. Situata e krijuar në periudhën mars-prill nga tërheqja e depozitave të individëve, ndonëse u përballua me sukses nga lehtësirat e ofruara nga Banka e Shqipërisë, bëri që edhe gjatë gjithë periudhës në vazhdim sistemi të reflektonte një situatë asimetrike likuiditeti. Nga njëra anë u pozicionua Banka e Kursimeve si kërkuese likuiditetesh, duke shfrytëzuar në mënyrë të konsiderueshme lehtësirat e Bankës së Shqipërisë dhe tregun ndërbankar, dhe nga ana tjetër, bankat e tjera të sistemit të cilat përgjithësisht u paraqitën me tepricë likuiditetesh. Niveli i kënaqshëm i aktiveve likuide në tërësinë e aktiveve të bankave (mbi 37 për qind) dhe ndaj pasiveve afatshkurtra (mbi 100 për qind), si dhe lehtësirat e ofruara nga Banka e Shqipërisë për likuiditetin, bënë që edhe gjatë këtij viti bankat të mos ekspozohen ndjeshëm ndaj rrezikut të likuiditetit.

Gjatë vitit 2002 sistemi bankar shqiptar vazhdoi të konsolidojë gjendjen e tij të shëndoshë financiare.

Tabelë 50: Tregues për sistemin bankar.

Bankat*	Nr. i degëve	Nr. i agjencive	Kapitali paguar / Totali i bilancit (%)	Totali i depozitave / Totali i bilancit (%)	Totali i kredive (neto) / Totali i bilancit (%)	Kredi me probleme / Totali i kredive (%)	Bono thesari në % ndaj sistemit bankar
GRUPI I: BANKAT SHTETËRORE							
1. Banka e Kursimeve	37	91	0.4	92.4	0.5	16.2	78.2
GRUPI II: BANKAT E PËRBASHKËTA							
2. Banka Italo Shqiptare		3	10.5	76.0	37.0	22.5	1.4
3. Banka Arabo Shqiptare Islamike	1		63.4	36.0	6.3	0.0	0.0
GRUPI II: BANKAT E TJERA							
4. Banka Kombëtare Tregtare	10	1	4.9	92.5	0.3	0.0	9.5
5. Banka Dardania			56.4	17.6	0.0	0.0	0.0
6. Banka Tirana	11		5.5	77.2	17.4	1.4	4.8
7. Banka Kombëtare Greke – dega Tiranë		3	12.9	83.4	3.4	4.6	0.9
8. Banka Tregtare Ndërkombëtare	1		43.4	55.9	33.5	10.5	0.2
9. Banka Alfa – dega Tiranë	5		7.7	49.7	51.0	1.6	0.4
10. Banka Amerikane e Shqipërisë	2		3.8	92.4	13.1	1.9	3.0
11. Banka Fefad	7	1	8.7	84.1	26.2	2.0	1.4

12. Banka e Parë e Investimeve – dega Tiranë			61.0	13.7	0.2	0.0	0.0
13. Banka Tregtare e Greqisë			48.6	55.2	54.0	0.0	0.3

*Ndarja e bankave në grupe bëhet sipas kriterit të pronësisë së kapitalit. Në grupin e parë përfshihen bankat me kapital tërësisht shtetëror, në grupin e dytë përfshihen bankat me kapital të përbashkët, vendas dhe të huaj, në grupin e tretë përfshihen bankat e tjera.

IV.3. NDËRMJETËSIMI BANKAR.

Shkalla e ndërmjetësimit për sektorin bankar megjithë zhvillimet pozitive të vërejtura gjatë vitit 2002, mbetet e ulët.

Tabelë 51: Treguesit kryesorë të ndërmjetësimit në një analizë krahasuese për vitin 2001.

Treguesit	Shqipëri*	Bullgari	Kroaci	Maqedoni	Rumani	Siloveni	Turqi	Greqi
Rap. dep. me afat/PBB	40.1	31.6	48.6	16.5	8	47.1	73.7	90.7
Rap. kred.i brendsh/PBB	35.1	27.2	51.9	20.6	12.4	49.5	99.4	109.3
Rap. kred.sek.priv/PBB	7.2	16.9	41.3	21.6	7.8	40	28	63.3
Rap. kredi sek. priv/Depozita me afat	17.5	53.4	85.1	136*	99.8	85.1	37.3	69.78
Kred sek priv/ Kreditit të brendshëm	20.0	62.2	79.7	78.3	63.2	81.0	28.1	57.9
Diferenca e normave të interesit	7.9	9.8	6.3	8.8		5.2		5.3
Nr. i bank. për 100 000 banorë	0.45	1.13	1.0	1.9		1.3	0.1	
Nr. i degëve & agjenc. për 100 000 banorë	2.7	69.23	18.1	76.4		29.8	10.7	31.2
Nr. i punonjësve të bankave për 100 000 banorë	74.9		371.4	191.5		566.2	220.0	592.7

Burimi: IFS Qershor 2002 dhe Raportet Vjetore të Mbikëqyrjes Bankare.

*Treguesit për Shqipërinë i referohen vitit 2002.

Box 14. ANALIZË KRAHASUESE E TREGUESVE TË NDËRMJETËSIMIT TË SHQIPËRISË ME VENDET E RAJONIT.

Në analizën krahasuese të treguesve për matjen e shkallës së ndërmjetësimit financiar në Shqipëri, me vendet e rajonit dalin në pah këto tipare kryesore:

- Shqipëria renditet në vendet me nivel të mirë të raportit të depozitave ndaj PBB-së (36.4 për qind për vitin 2001);
- raporti i kreditimit të ekonomisë ndaj PBB-së ka nivelin më të ulët ndërmjet vendeve të rajonit;
- efikasiteti i ndërmjetësimit është në nivele shumë herë më të ulëta se në vendet e tjera;
- kostoja e ndërmjetësimit në Shqipëri është relativisht e lartë;
- raporti i kredisë së sektorit privat ndaj kreditit të brendshëm është në nivelin më të ulët ndërmjet të gjitha vendeve të marra në analizë;
- madhësia e sistemit është relativisht e vogël.

Karakteristikat e mësipërme nënvizojnë se bankat në Shqipëri janë aktive në grumbullimin e depozitave. Ato investojnë pjesën më të madhe të depozitave të grumbulluara në bono thesari. Kjo përforcon idenë se shkalla e ndërmjetësimit bankar në Shqipëri është në nivelet më të ulta të të gjitha vendeve të rajonit të krahasueshme me të. Treguesit e madhësisë për sistemin bankar theksojnë se numri i bankave në Shqipëri është i vogël, por nivelet shumë herë më të ulëta për treguesin e degëve dhe të punonjësve në sektorin bankar theksojnë për një shtrirje të kufizuar të sistemit bankar. Kjo ndikon ndjeshëm në konkurrencën bankare si dhe në shkallën e ndërmjetësimit financiar.

Bankat, në pamundësi për t'i investuar fondet e tyre në kredi, vazhdojnë të investojnë kryesisht në bono thesari dhe kjo duket në nivelin akoma të ulët që zë kredia për sektorin privat ndaj totalit të kreditit të brendshëm të bankave.

Tabelë 52: Ecuria e treguesve të ndërmjetësimit për Shqipërinë në vite.

Treguesit³¹	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002
Depozita me afat /PBB (1)	17.0	21.4	15.3	25.9	29.4	32.7	33.2	36.4	40.1
Kreditit i brendshëm /PBB (2)	13.4	17.7	26.0	27.5	28.2	30.4	30.6	32.5	35.1
Kredi sektori privat /PBB (3)	3.8	3.7	3.9	3.8	3.2	3.6	4.5	5.9	7.2
Kredi sektori privat /Depozita me afat	22.5	17.2	25.3	14.6	11.0	11.0	13.6	16.1	17.5
Kredi sektori priv./ kredit të brendshëm	28.6	21.0	14.9	13.8	10.4	10.9	13.4	17.0	20.0
Marzhi i ndërmjetësimit ³²					9.0	7.9	6.4	4.1	4.17
Diferenca midis normës së kredisë dhe të depozitave me afat			10.1	-3.2	10.2	11.4	16.7	7.9	7.9

Viti 2002 nuk ka sjellë ndryshim të dukshëm në koston e ndërmjetësimit duke treguar se bankat vazhdojnë të mbajnë një marzh të njëjtë ndërmjet të ardhurave të tyre nga investimet me koston që ato duhet të paguajnë për grumbullimin e fondeve. Kur kjo diferencë është e madhe, konsiderohet si një pengesë për zgjerimin dhe për zhvillimin e ndërmjetësimit financiar, përdërisa dekurajon kursimtarët e mundshëm me një kthim të ulët për depozitat dhe kufizon financimin për huamarrësit e mundshëm, duke reduktuar mundësinë për investime të parashikuara dhe në këtë mënyrë mundësinë e rritjes të ekonomisë.

IV.4. INSPEKTIMET NË VEND.

Realizimi i inspektimeve në vend bëhet në bazë të planit të miratuar në fillim të vitit. Ai ka si synim kryerjen e inspektimeve të plota të të gjitha bankave gjatë vitit. Ky program është i shoqëruar edhe me inspektime të pjeshme për probleme të veçanta që kanë dalë gjatë vitit.

Disa nga karakteristikat kryesore që u vunë re në sistemin bankar gjatë vitit 2002 janë:

1. Zgjerimi i aktivitetit kreditues është shoqëruar me një përmirësim të portofolit të kredisë, ndonëse evidentohen akoma disa mangësi ku do të veçonim si më kryesoret:

³¹Shënim: Depozita me afat” përfshijnë depozitat me afat në monedhën vendase dhe depozitat në monedhë të huaj. “Kredi sektori privat” përfshin edhe huatë kaluar pranë ATK-së.

³² Në vitin 1998 të dhënat e mbikëqyrjes raportohen sipas një sistemi të ri raportues dhe nuk mund të krahasohen me të dhënat e mëparshme.

- Fillimi i aktivitetit kreditues pa siguruar më parë një ekip të përgatitur, për t'iu përgjigjur kërkesave të këtij sektori si dhe mungesa e përvojës për monitorimin e kredive.
 - Mosmbështetja në politika dhe në procedura të plota dhe të sakta.
 - Ekzistenca e një tregu jo në nivelin e duhur për t'iu përgjigjur detyrimeve të një kredimarrjeje, i cili akoma nuk është familjarizuar sa duhet me parimet e ekonomisë së tregut.
 - Situata e pastabilizuar në disa sektorë jetikë të ekonomisë, si ai i energjitikës.
 - Mosfunksionimi i aspekteve ligjore që kanë të bëjnë me procesin e kreditimit.
2. Është rikthyer besimi i publikut në sistemin bankar pas panikut që mbizotëroi në muajt mars – prill 2002 në Bankën e Kursimeve dhe në atë Kombëtare Tregtare. Gjendja e likuiditetit dhe, në përgjithësi, aktiviteti i këtyre bankave është përmirësuar ndjeshëm duke u rikthyer në rrjedhën normale.

Në sistemin bankar ka patur një gjendje likuiditeti të mirë, përgjithësisht si rezultat i investimit në zëra likuidë si: vendosje në bankat e tjera, në bono thesari të Qeverisë së Shqipërisë apo në letra me vlerë të qeverive të tjera të vendeve të Zonës A.

3. Drejtimi i lartë, në përgjithësi, ka reaguar pozitivisht ndaj problemeve të ngritura në ekzaminimet e kryera, por nuk ka treguar kujdesin e duhur për:
- përmirësimin e politikave dhe të procedurave të aktivitetit të bankës;
 - plotësimin e kuadrit rregullativ të aktivitetit të bankës;
 - zbatimin e planbiznesit të bankës.

Gjatë vitit 2002 u realizuan 13 inspektime të plota dhe 11 të pjesshme. Gjatë inspektimeve të kryera janë konstatuar shkelje të natyrave të ndryshme si:

- Shkelje të ligjit “Për kontabilitetin” dhe moszbatim me korrektësi i “Manualit të kontabilitetit bankar” për mbajtjen e kontabilitetit dhe të rezultatit financiar në monedhën vendase.
- Shkelje të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, neni 6, për mbajtjen e dokumentacionit dhe të korrespondencës në gjuhën shqipe.
- Shkelje të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, neni 20, lidhur me ndarjen e pozicionit të anëtarit të komitetit të kontrollit nga pozicioni i anëtarit të komitetit të administrimit.
- Moszbatim me korrektësi të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, neni 20, lidhur me rritjen e rolit të komitetit të kontrollit dhe të kontrollit të brendshëm të vetë bankës.

➤ Shkelje të rregulloreve të Bankës së Shqipërisë si:

- klasifikimi i portofolit të kredive jo në përputhje me rregulloren e Bankës së Shqipërisë “Për menaxhimin e riskut të kredisë”;
- emërimi dhe fillimi nga detyra i disa administratorëve në disa banka pa marrë miratimin paraprak nga Banka e Shqipërisë;
- dokumentacioni përkatës që duhet të shoqërojë transfertat e kryera nga bankat nuk i përgjigjet kërkesave të rregullores nr. 12, datë 21.02.2001 “Për veprimtarinë valutore”.

Në varësi të shkeljeve të evidentuara, janë përcaktuar masat korrektuese ose ndëshkimore, mbështetur në dispozitat e ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe në aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë.

Masat e zbatuara në vitin 2002 janë:

- rekomandime apo sugjerime për të korigjuar parregullsitë e vogla;
- kërkesa për të paraqitur në Bankën e Shqipërisë një program masash për rregullimin e gjendjes së bankës, në rast të ndeshjes së parregullsive, duke përcaktuar edhe afatet përkatëse;
- masa ndëshkuese ndaj administratorëve që kanë të bëjnë me shkeljet e konstatuara ndaj kuadrit ligjor dhe rregullativ në fuqi.

Bankat, në mbështetje të kërkesave dhe të rekomandimeve të dhëna në raportet e ekzaminimit (në krahasim me vitin e kaluar) i kanë kushtuar kujdes plotësimit të akteve të brendshme të tyre në të gjitha fushat, veçanërisht në veprimtarinë kredituese, në administrimin e rreziqeve të ndryshme etj.. Bankat po familjarizohen me nevojën e respektimit të ligjit, të akteve nënligjore dhe të rekomandimeve të Bankës së Shqipërisë. Këto krijojnë premisa për zhvillimin e marëdhënieve korrekte midis Bankës së Shqipërisë dhe bankave të nivelit të dytë.

Box 15: PLANI AFATMESËM I ZHVILLIMIT TË MBIKËQYRJES BANKARE.

Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me Bankën Botërore, ka hartuar një program për forcimin e aftësive mbikëqyrëse me efekt deri në vitin 2004. Zbatimi i këtij plani ka për qëllim rritjen e shkallës së sigurisë të sistemit bankar në Shqipëri nëpërmjet zbatimit me efikasitet të standardeve për një veprimtari bankare të shëndoshë dhe të sigurtë.

Për të realizuar këtë objektiv themelor u identifikuan nevojat në lidhje jo vetëm me përsosjen e dokumenteve bazë udhëheqëse dhe rregullative, mbi të cilat mbështetet mbikëqyrja, por edhe me zhvillimin dhe me përsosjen e mëtejshme të bazës rregullative për bankat e nivelit të dytë dhe të burimeve njerëzore brenda Departamentit të Mbikëqyrjes.

Në funksion të këtij qëllimi u përcaktuan disa detyra, një pjesë e të cilave kanë përfunduar ose janë në procesin e zbatimit dhe që kryesisht kanë të bëjnë me:

- Ripunimin e deklaratës së misionit të mbikëqyrjes me qëllim rritjen e transparencës dhe të përgjegjësisë në publik si edhe ndërgjegjësimin e publikut dhe të sistemit bankar me rolin e mbikëqyrjes bankare.
- Thellimin e auditimeve të kryera ndaj bankave nga ekspertët kontabël të pavarur dhe përsosjen e procesit të miratimit të tyre nga Banka e Shqipërisë nëpërmjet disiplinimit të disa kriterëve bashkëkohore në kuadrin rregullativ.
- Vlerësimin e cilësisë së punës që kryhet në lidhje me të gjithë ciklin e ekzaminimit të një banke dhe me kryerjen e përmirësimeve në bazë të konkluzioneve.
- Përcaktimin e qartë të niveleve të vendimmarrjes nëpërmjet zhvillimit të një matrice duke filluar nga drejtuesit e departamentit, Zëvendësguvernatori i Parë, Guvernatori dhe Këshilli Mbikëqyrës.
- Zhvillimin e një politike për të përcaktuar veprimet në dispozicion të Bankës së Shqipërisë, në rastet kur kjo e fundit e gjykon të nevojshme marrjen e tyre për zgjidhjen e çështjeve, që kanë të bëjnë me veprimtarinë e sigurtë dhe të shëndoshë bankare ose me çështje të përputhjes me standardet e kësaj veprimtarie.
- Rritjen e bashkëpunimit me industrinë bankare brenda vendit dhe me autoritetet mbikëqyrëse jashtë nëpërmjet hapjes dhe ruajtjes së kanaleve të komunikimit.
- Zhvillimin e një baze të dhënash në formë elektronike për të gjitha bankat me qëllim ruajtjen e historisë së tyre për të realizuar shmangien e një rreziku operacional brenda departamentit, marrjen e informacioneve në kohë dhe ruajtjen e vijueshmërisë së mbikëqyrjes për çdo bankë.
- Zhvillimin e burimeve njerëzore brenda departamentit nëpërmjet hartimit të një politike dhe vendosjes së disa procedurave që do të identifikojnë kërkesat për trajnim të inspektorëve dhe përmbushjen në maksimum të tyre.

KAPITULLI V: PASQYRAT FINANCIARE DHE BUXHETI I BANKËS SË SHQIPËRISË

IV.1. TREGUESIT E BUXHETIT.

Banka e Shqipërisë harton dhe zbaton buxhetin e saj për realizimin e funksioneve që i janë ngarkuar me ligj.

IV.1.1. Parashikimi i buxhetit për vitin 2002.

Aktiviteti financiar i Bankës së Shqipërisë mbështetet në administrimin e rezervës valutore, kreditimin e qeverisë dhe në marrëdhëniet me bankat e nivelit të dytë, në funksion të politikës monetare. Banka e Shqipërisë ka objektivat e saj që gjejnë pasqyrim në treguesit e buxhetit, të cilët miratohen nga Këshilli Mbikëqyrës.

Në treguesit e parashikuar për vitin 2002 është mbajtur parasysh:

- Investimi i rezervës valutore të bëhet kryesisht në letra me vlerë në valutë me shkallë të lartë sigurie, me synim administrimin me eficiencë të saj, ndryshe nga viti 2001 e më parë, kur një pjesë e rëndësishme e saj investohej në depozita pranë bankave të huaja.
- Stabilitetin e arritur në treguesit makroekonomik dhe qëndrueshmërinë në sistemin bankar, të shprehur dhe në programin monetar të miratuar për vitin 2002, duke patur parasysh një ecuri normale të depozitave dhe të likuiditetit në sistemin bankar, si dhe në normat e interesit;
- Rritjen e veprimtarisë operative dhe modernizimin, nëpërmjet përmirësimeve të teknologjisë informative dhe forcimin e sistemeve të sigurisë.

IV.1.2. Realizimi i treguesve të buxhetit.

Treguesit kryesorë të buxhetit për vitin 2002 janë realizuar:

N	Treguesit	Plan	Fakt	Ndryshesa	
				Në vlerë	Në %
1.	Të ardhurat nga interesat	9,489,369	11,635,070	2,145,701	123
	-Të ardhura në valutë	3,194,888	3,783,857	588,969	118
	-Të ardhura nga veprimet me qeverinë	6,294,481	7,484,936	1,190,455	119
	-Të ardhurat nga kreditë përi instit.finan.		366,277	366,277	
2.	Shpenzimet për interesa	1,377,633	1,154,668	(222,965)	84
	-Shpenzimet në valutë	277,017	245,155	(31,862)	88
	-Shpenzime në lekë	1,100,616	909,513	(191.103)	83
3.	Të ardhurat neto nga interesat (1-2)	8,111,736	10,480,402	2,368,666	129
4.	Të ardhurat të tjera (neto)	15,500	43,895	28,395	
5.	Gjithsej të ardhurat (neto) (3+4)	8,127,236	10,524,297	2,397,061	129
6.	Kosto operative	665,400	473,325	(192,075)	71
	-Kosto personeli	372,700	304,410	(68.290)	82
	-Shpenzime administrative	225,450	148,231	(77.219)	66
	-Shpenzime per administ. e aktiveve	67,250	20,684	(46.566)	31
7.	Shpenzime amortizimi	522,000	321,622	(200.378)	62
8.	Fitimi para zbritjeve (5-6-7)	6,939,836	9,729,350	2.789.514	140

V.2.1 Të ardhurat në valutë janë realizuar më shumë nga plani, kryesisht për efekt të rritjes së rezervave valutore, nga 740 milionë usd në 776 milionë usd, por edhe të një norme mesatare interesi më të lartë nga parashikimi (3.23 përqind, nga 2.59 e parashikuar).

V.2.2 Të ardhurat nga veprimet për qeverinë rezultojnë me tejkalim për arsye të rritjes së portofolit të letrave me vlerë, nga konvertimi në borxh të tregtueshëm i kredisë direkte, për 5.8 miliardë lekë dhe të rritjes së *yield*-it të bonove të thesarit, si rrjedhojë e politikës së Bankës së Shqipërisë në lidhje me normat e interesit.

V.2.3 Për të ardhurat nga kreditë për institucionet financiare nuk ka patur parashikim në planin e vitit 2002. Ngjarjet e veçanta të këtij viti me efekte në mungesën e likuiditetit në treg, imponuan edhe qëndrimin e Bankës së Shqipërisë, e cila kaloi në pozitë të huadhënësit për sistemin bankar, ndryshe nga parashikimi.

V.2.4 Shpenzimet në valutë nuk janë realizuar sipas parashikimit, kryesisht për shkak të mosrealizimit të diferencave të rivlerësimit për letrat me vlerë, sipas parashikimeve të Bankës së Shqipërisë, por edhe për shkak të uljes së normave të interesit për llogaritë (detyrimet) me FMN dhe rezervat e detyrueshme të bankave tregtare në Bankën e Shqipërisë në krahasim me parashikimet e bëra.

V.2.5 Shpenzimet ndaj detyrimeve në lekë janë realizuar më pak nga parashikimi, duke reflektuar ngjarjet e periudhës mars–prill të tërheqjes jo të zakonshme të depozitave, ndërsa ishte parashikuar thithja e likuiditeteve të tepërta në sistem, për një shumë monetare mbi 4 miliardë lekë, kryesisht nëpërmjet marrëveshjeve *Repo*.

V.2.6 Shpenzimet administrative janë realizuar më pak nga parashikimi, pothuajse në të gjithë përbërësit, për shkak të mosrealizimit në kohë të disa shpenzimeve nga njëra anë, por edhe për shkak të konceptimit të planit si kufi i sipërm (maksimal). Megjithatë mosrealizimet nuk kanë penguar mbarëvajtjen e punës në institucion.

KAPITULLI VI: AKTIVITETE TË TJERA TË BANKËS SË SHQIPËRISË

VI.1. ZHVILLIMET NË SISTEMIN E PAGESAVE.

Banka e Shqipërisë ka si detyrim ligjor nxitjen dhe mbështetjen e sistemit të pagesave. Për këtë, ajo është e angazhuar si në planin operacional, duke qenë i vetmi institucion pastrimi dhe rregullimi i të gjitha transaksioneve në lekë, ashtu edhe në drejtim të nxitjes së reformave në sistemin e pagesave.

VI.1.1. PROJEKTE PËR ZHVILLIMIN E SISTEMIT TË PAGESAVE.

Banka e Shqipërisë ka vazhduar përpjekjet në drejtim të ndërtimit të një sistemi pagesash eficient dhe të sigurtë, në përputhje me 10 Parimet Themelore për sistemet e rëndësishme të pagesave, të përcaktuara nga BIS/CPSS. Si rezultat, sistemi i pagesave ka njohur përmirësime si në aspektin operacional, ashtu edhe në atë rregullativ.

Gjatë vitit 2002, Banka e Shqipërisë ka kanalizuar punën e saj në drejtim të modernizimit të kuadrit operacional të sistemit të pagesave në tri projekte të rëndësishme.

○ **Projekti ATM**

Në vitin 2002 përfundoi zbatimi i një sistemi të ri kontabël ATM (Accounting and Treasury Management), me qëllim automatizimin e operacioneve në bankën qendrore. Realizimi i këtij sistemi të brendshëm në Bankën e Shqipërisë solli përfitime të rëndësishme për sistemin e pagesave ndërbankare. Së pari, sistemi ofron mundësi dhe mjete të shpejta dhe të sigurta për përpunimin dhe për ekzekutimin e pagesave ndërbankare, për monitorimin e likuiditetit në llogaritë e bankave të nivelit të dytë dhe për shkëmbimin e informacionit për pjesëmarrësit në sistem. Së dyti, sistemi ATM përbën një bazë infrastrukturore të domosdoshme për sistemet e ardhshme që do të zbatohen në Bankën e Shqipërisë e, në mënyrë të veçantë, për sistemin RTGS, që do të realizojë shlyerjen e pagesave në llogaritë e bankave të nivelit të dytë pranë Bankës së Shqipërisë.

○ **Projekti RTGS**

Projkti RTGS (Real Time Gross Settlement) synon zbatimin e një sistemi të Shlyerjes Bruto në Kohë Reale për pagesat ndërbankare me vlerë të madhe. Arritja më e rëndësishme e vitit 2002 në këtë drejtim vlerësohet përfundimi i dizenjimit të sistemit (përcaktimi i cilësive teknike dhe funksionale).

○ **Projekti ACH**

Banka e Shqipërisë ka në planet e saj zbatimin e një Sistemi të Automatizuar Kleringu (ACH- Automated Clearing House). Ky sistem synon automatizimin e shërbimit të kleringut, që Banka e Shqipërisë u ofron bankave të nivelit të dytë për përpunimin e pagesave të klientëve të tyre. Zbatimi i këtij sistemi do të sjellë përfitime të ndjeshme për sistemin kombëtar të pagesave në drejtim të

rritjes së saktësisë, të shpejtësisë dhe të uljes së kostos së përpunimit të tyre. Gjatë vitit 2002, Banka e Shqipërisë përcaktoi fazat në të cilat do të kalojë realizimi i këtij sistemi, kohën dhe mjetet e realizimit të tij. Faza e parë konsiston në përfundimin e një analize të plotë të situatës aktuale, në identifikimin e problemeve dhe të tendencave të perspektivës. Gjatë vitit 2002, u arrit përzgjedhja e një firme konsulence që do të asistojë Bankën e Shqipërisë në realizimin e kësaj faze të projektit. Kjo konsulencë do të mbështetet financiarisht nga Banka Botërore. Faza e dytë e projektit, konsiston në zbatimin e sistemit ACH, i cili do të vihet në punë pas përfundimit të projektit RTGS.

VI.1.2. SHËRBIMI I KLERINGUT.

Banka e Shqipërisë ofron që prej vitit 1997, shërbimin e **kleringut** të instrumenteve të pagesave ndërbankare në lekë. Këto pagesa janë kryesisht, me vlerë të vogël dhe të iniciuara nga klientët.

Në vitin 2002, vlera totale e instrumenteve të kleruara në shërbimin e kleringut, ishte rreth 72.7 miliardë lekë, që shënon një rritje me 17.6 për qind në krahasim me vitin 2001. Kjo tendencë, vazhdimisht në rritje, e përdorimit të instrumenteve *jocash* dëshmon për një afrim përherë e më të madh të klientëve në banka.

Tabelë 54: Vlera e instrumenteve të pagesave të kleruara në shërbimin e kleringut në Bankën e Shqipërisë, në miliardë lekë.

	1998	1999	2000	2001	2002
Urdhërpagesa	22.5	25.6	28.0	32.9	40.9
Çeqe	15.5	24.4	26.3	28.9	31.8

Instrumenti më i përdorur nga klientela dhe me një rritje më të madhe është urdhërpagesa. Gjatë vitit 2002, vlera e urdhërpagesave ndërbankare është rritur 24 për qind në krahasim me vitin 2001.


VI.1.3. PAGESAT NDËRBANKARE.

Banka e Shqipërisë ka vazhduar të ofrojë shërbimin e shlyerjes së pagesave ndërbankare për bankat e nivelit të dytë. Këto pagesa janë me vlerë relativisht të madhe dhe burojnë, kryesisht, nga transaksionet e tregut ndërbankar.

Gjatë vitit 2002, shënohet një rritje e ndjeshme e aktivitetit ndërbankar si në vlerë edhe në volum. Vlera totale e transaksioneve në llogaritë në lekë të bankave të nivelit të dytë pranë Bankës së Shqipërisë, arrin në 2339 miliardë lekë, që përbën një rritje prej 23 për qind krahasuar me atë të vitit 2001. Pagesat e tregut ndërbankar përbëjnë numrin më të madh të këtyre transaksioneve, duke zënë 26 për qind të numrit total të tyre.

Tabelë 55: Transaksionet e shlyera në sistemin e pagesave ndërbankare në lekë, për vitin 2002.

	Numri	Vlera (në miliardë lekë)
Pagesa ndërbankare	3,624	389.8
Kliringu	2,906	42.3
Cashi	1,949	78.2
Qeveria	3,465	1,022.8
Banka qendrore	2,346	804.0



VI.2. EMISIONI I MONEDHËS.

Gjatë vitit 2002, monedha në qarkullim pati një rritje të paparashikuar si pasojë e ngjarjeve të muajve mars-prill 2002. Deri në fund të vitit, me masat e marra, pati një stabilizim gradual të saj në nivelin e parashikuar.

Gjendja e treguesve të monedhës më 31.12.2002 rezulton si më poshtë:

Emisioni 142.500.000.000,00 lekë.

Monedha në qarkullim 133.115.483.581,00 lekë.

Emisioni i monedhës, për vitin 2002, u shtua për 14,5 miliardë lekë, duke mbajtur parasysh plotësimin e nevojave të ekonomisë për para me një strukturë optimale.

Rritja më e madhe i përket muajve mars-prill 2002, përkatësisht me 11,3 miliardë lekë e 5 miliardë lekë. Rritja e muajit dhjetor prej rreth 4,4 miliardë lekësh, si rrjedhim i pagesave të buxhetit, është një dukuri e zakonshme e kësaj periudhe.

Tabelë 56: Ndryshimet mujore të monedhës në qarkullim për vitin 2002, në miliardë lekë.

Nr.	M u a j t	Mujore	Progresive prej fillimit të vitit
1	Janar	-2.5	-2.5
2	Shkurt	-0.8	-3.3
3	Mars	+11.3	+8.0
4	Prill	+5.0	+13.0
5	Maj	+0.6	+13.6
6	Qershor	+0.6	+14.2
7	Korrik	+0.1	+14.3
8	Gusht	-0.9	+13.4
9	Shtator	-1.5	+11.9
10	Tetor	-3.3	+8.6
11	Nëntor	-1.2	+7.4
12	Dhjetor	+4.4	+11.8

Tabelë 57: Struktura e monedhës në qarkullim, në përqindje.

Prerjet	1999	2000	2001	2002
5000	0.25	0.98	2.23	3.48
1000	21.00	23.30	30.23	35.54
500	33.37	33.23	39.60	38.58
200	14.44	13.02	13.76	11.11
100	9.29	9.43	14.18	11.29
10	4.00	3.68	0.0	0.0
5	3.32	3.06	0.0	0.0
3	3.38	3.13	0.0	0.0
1	10.95	10.16	0.0	0.0
Totali kartëmonedha	100.00	100.00	100.00	100.00
100	0.00	1.98	4.80	3.30
50	7.23	4.04	14.96	13.95
20	10.11	5.92	26.09	27.35
10	10.82	6.57	28.83	29.87
5	7.68	4.51	18.94	18.64
2	0.26	0.12	0.0	0.0
1	10.27	5.00	6.38	6.89
0.5	8.71	4.21	0.0	0.0
0.2	18.84	9.11	0.0	0.0
0.1	22.01	10.65	0.0	0.0
0.05	4.08	1.97	0.0	0.0
Totali monedha metalike	100.00	100.00	100.00	100.00

Gjatë gjithë vitit 2002, në përgjithësi, struktura e monedhës në qarkullim u mbajt rreth nivelit të parashikuar, me përjashtim të prerjes 5000 lekë. Tejkalimi i kësaj prerjeje në qarkullim, për rreth 4 për qind mbi parashikimin e muajit shkurt 2002, është rrjedhim i përbalimit të tërheqjeve masive të depozitave në muajt mars-prill 2002, prerje e cila iu nënshtrua “thesarizimit” nga popullsia.

Përsa i takon falsifikimit të kartëmonedhave, ai ka qenë i pranishëm edhe gjatë vitit 2002, por në përmasa më të vogla. Krahasuar me fundvitin 2001, falsifikimi është ulur ndjeshëm, sidomos në prerjet 500 dhe 1000 lekë.

Tabelë 58: Të dhëna mbi falsifikimin e kartëmonedhave.

Prerjet në lekë	Në copë			Progresive nga viti 1992	Në %	
	2000	2001	2002		2002 / 2001	(1992-2002) / (1992-2001)
1000	747	438	413	11647	94.3	103.6
500	1487	954	484	6188	50.7	108.5
200 lekë	834	259	287	1490	110.8	123.8
100 lekë	6	1	1	8	100.0	114.3
Gjithsej	3074	1652	1185	19333	71.7	106.5

Kartëmonedhat e falsifikuara janë riprodhim në makina fotokopjuese me ngjyra ose në makina shtypi *offset*. Në përgjithësi, ato janë fotokopjuar apo janë shtypur me letër të zakonshme dhe u mungojnë elementet e sigurisë. Më të ekspozuara ndaj falsifikimit vazhdojnë të jenë prerjet 200, 500 dhe 1000 lekë, emetime të vitit 1994 e rishtypje të vitit 1996 dhe veçanërisht këtë vit, prerjet 200 e 1000 lekë, emetim i ri i vitit 1996.

Sa i takon kartëmonedhave të huaja të falsifikuara, kryesisht lireta italiane, dhrahmi greke, marka gjermane dhe dollarë amerikanë, sasia e tyre, krahasuar me disa vite më parë, është e pakonsiderueshme, kjo edhe për faktin e futjes në qarkullim të monedhës europiane *euro*.

VI.3. NDRYSHIMET NË LIGJIN E BANKËS SË SHQIPËRISË.

Banka e Shqipërisë, si banka qendrore e Republikës së Shqipërisë ushtron aktivitetin e saj në bazë dhe për zbatim të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”. Duke parë ligjin në tërësinë e tij, vërehet që Banka e Shqipërisë gëzon pavarësi ligjore. Një hap i rëndësishëm në drejtim të forcimit të kësaj pavarësie ishte përcaktimi i qartë dhe pa ekuivoke në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë (neni 161), miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, i elementeve të tilla që shprehin në mënyrë të drejtpërdrejtë ekskluzivitetin e Bankës së Shqipërisë në:

- Nxjerrjen dhe qarkullimin e monedhës shqiptare - Lek.
- Zbatimin e pavarur të politikës monetare.
- Mbajtjen dhe administrimin e rezervave valutore të Republikës së Shqipërisë.

Përveç sanksionimeve ligjore të bëra në Kushtetutë, një hap i rëndësishëm me synimin drejt rritjes së pavarësisë së bankës qendrore, ishte dhe miratimi nga Kuvendi i Shqipërisë³³ i disa shtesave dhe ndryshimeve në ligjin “Për Bankën e Shqipërisë”. Fushat ku ndryshohet apo saktësohet ligji kanë të bëjnë me:

³³ Ligji nr. 8893, datë 14.05.2002 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”” ndryshuar me ligjin nr.8384, datë 29.07.1998.

- Saktësimin e të drejtës së Bankës së Shqipërisë që të zbatojë politikën monetare të Shtetit Shqiptar në mënyrë të pavarur. Ndryshimi i bërë thekson karakterin e pavarësisë së politikës monetare.

- Dhënien e së drejtës Bankës së Shqipërisë që të përdorë në mënyrë të pavarur mjetet (instrumentet) e politikës monetare. Në këtë mënyrë theksohet pavarësia në zbatimin e politikës monetare.

- Zgjedhjen dhe emërimin e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë. Në nenin e shfuqizuar Guvernatori propozohej nga Kryetari i Këshillit të Ministrave dhe emërohej nga Presidenti. Me ligjin e ri Guvernatori propozohet nga Presidenti i Republikës dhe zgjidhet nga Kuvendi i Shqipërisë. Ky ndryshim i zgjedhjes së Guvernatorit nga Kuvendi bëhet në përputhje edhe me raportet institucionale të Bankës së Shqipërisë me Kuvendin të përcaktuara në ligjin “Për Bankën e Shqipërisë”.

- Shmangien e konfliktit të interesit të pozicionit të anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës. Me shtesën e bërë në ligj, përcaktohet papajtueshmëria e funksionit të anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë me atë të punonjësit, të administratorit dhe të aksionerit me pjesëmarrje ndikuese në bankën e nivelit të dytë ose në subjektet që licencohen nga Banka e Shqipërisë. Qëllimi i kësaj shtese është i lidhur me shmangien e konfliktit që mund të krijohet midis pjesëmarrjes së anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës nëpër banka apo subjekte që licencohen nga Banka e Shqipërisë, dhe vetë pozicionit që ai ka në Bankën e Shqipërisë. Kjo sepse në bazë të ligjit “Për Bankën e Shqipërisë”,³⁴ Këshilli Mbikëqyrës merr vendime që janë të lidhura direkt me interesat e atyre subjekteve që kryejnë veprimtari bankare dhe financiare në bazë të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, vendime që fillojnë që nga marrja e licencës, nga miratimi i akteve rregullative të mbikëqyrjes dhe deri tek revokimi i licencës.

- Ndryshimin përkatës që lidhet me autoritetin që i jepet Bankës së Shqipërisë për të mbajtur dhe për të administruar jo vetëm rezervën e saj valutore (siç ishte dispozita e shfuqizuar), por të gjithë rezervën valutore të Republikës së Shqipërisë.

VI.4. ZHVILLIMET NË FUNKSIONIN E KONTROLLIT TË BRENDSHËM.

Funksioni i kontrollit të brendshëm të Bankës së Shqipërisë ushtrohet në zbatim të kërkesave ligjore, më konkretisht të nenit 54 të ligjit “Për Bankën e Shqipërisë”. Në të gjitha kontrollet e ushtruara gjatë vitit 2002 janë përmirësuar dokumentet paraprake të kontrollit, duke përcaktuar procedurat dhe hapat e zhvillimit të kontrolleve, duke kontrolluar e pasuruar dokumentet e paraqitjes së sistemeve të kontrollit të brendshëm ekzistues, duke bërë krahasimet dhe duke evidentuar ndryshimet që ka pësuar vlerësimi i rrezikut të kontrollit, duke hartuar për këtë edhe një histori të vlerësimit të rrezikut, për çdo funksion të bankës.

³⁴ Shiko nenin 43 gërma “c” dhe gërma “e” të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”.

Gjatë vitit 2002 është realizuar një numër total prej 45 kontrollesh, me një mesatare mujore prej 3,8 kontrollesh në muaj. Prej tyre 37 kontrolle kanë qenë të programuara në planin vjetor të punës së departamentit dhe vetëm 4 janë procedura të realizuara me sugjerim të administratorëve të bankës, që kryesisht kanë të bëjnë me kontrolle të specializuara me temë të veçantë. Nga ana e Departamentit të Kontrollit, sipas një programi shtesë u realizuan edhe 3 kontrolle të kërkuara nga Departamenti i Thesarit në FMN. Ndërkaq, në këtë numër nuk përfshihen informacione të përgatitura për rakordime të llogarive të veçanta, ato të përgatitura për kontrollin e pasqyrave financiare, për realizimin e programeve të Këshillit Mbikëqyrës, si edhe verifikime të kryera për gjendje fizike të vlerave monetare.

Në vitin 2002, është realizuar raportimi në Këshillin Mbikëqyrës i rezultateve të kontrolleve, për çdo tremujor, në ndryshim nga raportimet vjetore të realizuara në periudhat e mëparshme.

Në kontrollet e ushtruara, krahas mospërputhjeve të konstatuara e rekomandimeve përkatëse për to janë dhënë mendime për plotësime ose për përmirësime të rregulloreve, të manualeve të punës e të procedurave të ndjekura. Të gjitha rekomandimet e dhëna kanë pasur synim zbatimin korrekt të ligjit, të akteve nënligjore, të vendimeve të Këshillit Mbikëqyrës dhe të rregullave të tjera të vendosura. Këtu është për t'u theksuar se nga kontrollet e ushtruara, në veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë nuk janë vënë re shkelje të akteve ligjore. Për shkelje të rregullave të vendosura, gjatë kontrolleve të ushtruara në vitin 2002 janë propozuar edhe masa disiplinore si dhe për një rast me dëm ekonomik është nxjerrë aktzhdëmtimi përkatës.

VI.5. INTEGRIMI DHE BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR.

VI.5.1. PROCESI I INTEGRIMIT NË Bashkimin Europian.

Viti 2002 ishte një vit i rëndësishëm për Shqipërinë në kuadrin e përpjekjeve për fillimin e bisedimeve për nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit me Bashkimin Europian (BE). Pas sugjerimit të delegacionit të Bashkimit Europian për fillimin e një procesi studimi e vlerësimi të hollësishëm sektorial, në raportin e Komisionit Europian të prillit 2002 u identifikuan problemet e masat lidhur me zhvillimet e ndryshme sektoriale të vendit, në bazë të një matrice të hartuar për ndjekjen e detyrave dhe ecurinë e realizimeve nga çdo institucion.

Box 16: PROCESI I STABILIZIM-ASOCIIMIT PËR EUROPËN JUGLINDORE – pjesë nga Raporti Vjetor i Komisionit Europian, prill 2002.

Procesi i Stabilizim-Asocimit, si një angazhim afatgjatë në rajonin e Ballkanit Perëndimor, kombinon marrëdhënie kontraktuale (Marrëveshjet e Stabilizim Asocimit) dhe një program asistence (CARDS), i cili ndihmon çdo vend për të përparuar me ritmin e tij drejt kërkesave për anëtarësimin në Bashkimin Europian. Marrëveshjet e Stabilizim Asocimit (MSA) janë marrëveshje të detyrueshme ligjore ndërkombëtare. Ato mbështeten plotësisht në marrëveshjet e Europës me vendet candidate dhe në eksperiencën e procesit të rritjes së bashkësisë europiane. Ato janë ambicioze, kërkuese dhe kanë si bazë parimet udhëheqëse që përcaktojnë anëtarësimin në Bashkimin Europian. MSA kërkojnë respektimin e parimeve demokratike, të të drejtave të njeriut dhe zbatimin e ligjit; ato parashikojnë krijimin e një zone të lirë tregtie me Bashkimin Europian; ato vendosin rregulla dhe detyrime në fusha si konkurrenca dhe ndihma e shtetit, pronësia intelektuale dhe krijimi i ndërmarrjeve, gjë që i lejon ekonomitë e rajonit të fillojnë integrimin me Bashkimin Europian.

Në muajin qershor, Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme të Bashkimit Europian theksoi se, Këshilli Europian e konsideron Shqipërinë si një kandidat të mundshëm për anëtarësim në Bashkimin Europian, ndërkohë që në 21 tetor u miratua në Bruksel projektmandati për Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit me Shqipërinë. Ky i hap rrugën fillimit të bisedimeve për nënshkrimin e marrëveshjes dhe është një shans që i jepet Shqipërisë, krahas vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor për të treguar mundësitë dhe aftësitë e partneritetit me vendet e Bashkimit Europian.

Problemet e shtruar për zgjidhje dhe përparimet e shënuara nga institucionet në sektorë të ndryshëm, i nënshtrohen një procesi raportimi me bazë mujore. Në këtë kuadër, Banka e Shqipërisë, si banka qendrore e vendit, gjatë vitit 2002 ka dhënë kontributin e saj jo vetëm në hartimin e politikës monetare për të realizuar objektivin e saj kryesor të stabilitetit të çmimeve, por edhe në përpjekjet për forcimin e mbikëqyrjes bankare nëpërmjet zhvillimit afatmesëm të Departamentit të Mbikëqyrjes me mbështetjen e organizmave ndërkombëtarë, miratimit të ligjit dhe më vonë krijimit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, konsolidimit dhe rritjes së sistemit bankar dhe të atij financiar jobankar, rritjes së transparencës së aktivitetit të saj, përmirësimit të sistemit të pagesave etj..

Ndërkohë, duke vlerësuar kërkesat e Bashkimit Europian për integrimin financiar, u kërkua një bashkëpunim më i ngushtë me një nga vendet anëtare të komunitetit, gjë e cila u realizua nëpërmjet Zyrës së Kooperimit Teknik me Gjermaninë (GTZ). Për këtë u vendosën lidhje bashkëpunimi me Bankën Qendrore të Gjermanisë dhe me Bankën Qendrore Europiane dhe projektet e ndryshme do të koordinohen nga një grup 'ad hoc' drejtuesish në Bankën e Shqipërisë, që është krijuar për Europën.

Me krijimin e grupit që mori emrin "Europa" u rrit rëndësia e kooperimit me vendet europiane, duke caktuar edhe një koordinator që realizon lidhjet dhe kontaktet e Bankës së Shqipërisë për projektet europiane dhe ndjek prezantimin e saj në grupin e bisedimeve për nënshkrimin e marrëveshjes së Stabilizim Asocimit me Bashkimin Europian. Synimi i Bankës së Shqipërisë është që të orientohet nga modeli i Bankës Qendrore Europiane. Për këtë u

vendosën ura lidhjeje me Bankën Qendrore Europiane dhe me Bankën Qendrore të Gjermanisë.

Integrimi europian është i rëndësishëm kur kuptohet dhe njihet ajo që synohet. Kjo vlen për Bankën e Shqipërisë dhe për publikun shqiptar. Për këtë, me propozimin e grupit “Europa” u vendos të hapej një dhomë për Europën në Bankën e Shqipërisë, e cila të përmbajë informacione, të dhëna ekonomike, financiare, lidhje me faqe interneti, aktivitete të ndryshme dhe, në kuadër të transparencës së përgjithshme të aktivitetit të saj, të jetë e vizitueshme nga publiku.

VI.5.2. MARRËDHËNIET ME FONDIN MONETAR NDËRKOMBËTAR.

Bashkëpunimi me Fondin Monetar Ndërkombëtar njohu, gjatë vitit 2002, zhvillime e intensifikime të mëtejshme në drejtim të këmbimit të informacionit e mbështetjes së ofruar nga FMN.

Në cilësinë e agjentit fiskal të Republikës së Shqipërisë, Banka e Shqipërisë trajton të gjitha operacionet financiare me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Ajo mban në librat e saj llogaritë e Fondit dhe kryen rregullisht e në kohë shërbimin e shlyerjes së detyrimeve të Republikës së Shqipërisë, që rrjedhin nga marrëveshjet me të: dy Marrëveshje Huaje për Rritjen Ekonomike dhe Zhvillimin Social (PRGF) dhe Huaja e Ndihmës Emergjente Post-Konfliktit (EPCA).

Viti 2002 shënoi një hap tjetër të rëndësishëm në marrëdhëniet e Shqipërisë me Fondin Monetar. Në vijim të konsultimeve të fundvitit paraardhës me misionin e Departamentit për Çështjet Europiane, Bordi Ekzekutiv i Fondit Monetar Ndërkombëtar miratoi një marrëveshje të re huaje trevjeçare (2002-2004) për Rritjen Ekonomike dhe Zhvillimin Social (PRGF) në shumën totale prej 28,000,000 sdr. Transhi i parë prej 4,000,000 sdr u lëvrua më 28.06.2002.

Në kuadër të asistencës teknike që Fondi Monetar Ndërkombëtar ofron për vendet anëtare dhe me kërkesë të Bankës së Shqipërisë, Departamenti i Çështjeve Monetare dhe Këmbimit, asistoi gjatë vitit 2002 disa departamente të Bankës së Shqipërisë në çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen bankare e politikën monetare.

Nga ana tjetër, kanë vijuar edhe kontaktet me Departamentin e Thesarit të Fondit Monetar, veprimtaria e të cilit synon në vlerësimin e sigurisë së bankave qendrore dhe të rrezikut.

VI.5.3. MARRËDHËNIET ME GRUPIN E BANKËS BOTËRORE.

Shqipëria është anëtarësuar në Grupin e Bankës Botërore në tetor të vitit 1991. Që nga ajo kohë Banka Botërore ka qenë e përfshirë aktivisht në hartimin dhe në zbatimin e programit të reformës në Shqipëri nëpërmjet politikave të këshillimit, të mbështetjes financiare e asistencës teknike në sektorë të ndryshëm.

Në këtë kuadër, kontaktet kanë vazhduar edhe këtë vit, nëpërmjet misionëve, me Bankën Botërore nga e cila Banka e Shqipërisë ka siguruar mbështetjen dhe asistencën teknike në lidhje me ndjekjen e planit të zhvillimit afatmesëm e afatgjatë të mbikëqyrjes bankare. Ky projekt do të shtrihet edhe vitin e ardhshëm në drejtim të ndjekjes dhe të trajtimit të çështjeve teknike të projekteve të RTGS, të sistemit kontabël dhe të ngritjes së Zyrës së Informacionit të Kredive. Veç kësaj, për tre projektet e fundit dhe për projektin e sistemit të automatizimit të kleringut, Banka Botërore ka ofruar mbështetjen e vet financiare në lidhje me konsulencën, me zbatimin dhe me përgatitjen e specifikimeve tekniko-funksionale.

Me Korporatën Financiare Ndërkombëtare (IFC), Banka e Shqipërisë mban lidhje të rregullta nëpërmjet takimeve, tryezave të rrumbullakta e letërkëmbimeve për çështje të rëndësishme, siç janë privatizimi i Bankës së Kursimeve etj..

VI.5.4. MARRËDHËNIET NDËRRAJONALE.

Gjatë vitit 2002, marrëdhëniet e Bankës së Shqipërisë me bankat simotra njohën zhvillime e intensifikime të mëtejshme në drejtim të institucionalizimit të marrëdhënieve dhe të hedhjes së hapave konkretë.

Kështu, në muajin prill, u nënshkruan në Prishtinë Marrëveshja Kuadër si dhe Memorandumi i Mirëkuptimit në fushën e mbikëqyrjes bankare midis Bankës së Shqipërisë dhe Autoritetit për Banka dhe Pagesa të Kosovës. Marrëveshjet parashikojnë shkëmbim të rregullt informacioni mbi zhvillimet në sistemet bankare dhe në tregjet financiare përkatëse, mbi zbatimin e politikës monetare, të mbikëqyrjes bankare, mbi administrimin e rezervës valutore etj.. Nëpërmjet tyre nxitet zgjerimi i kontakteve midis bankave tregtare në të dyja drejtimet si dhe i ofrimit të asistencës teknike nga ana e Bankës së Shqipërisë në fushat e analizave dhe të statistikës, të pagesave me jashtë, të funksionimit të *clearing-house*, të tregut financiar e të letrave me vlerë etj., në përputhje me standardet europiane e ndërkombëtare.

Nga ana tjetër, bashkëpunimi në kuadër të Memorandumeve të Mirëkuptimit në fushën e mbikëqyrjes bankare, të nënshkruara tashmë me Bankën e Greqisë dhe me Autoritetin e Mbikëqyrjes Bankare të Turqisë, u konkretizua përkatësisht me zhvillime inspektimesh të përbashkëta të disa bankave greke që operojnë në Shqipëri e organizime tryezash pune dhe marrje përvoje në fusha të tilla si: likuidimi apo marrja në kujdestari.

Viti 2002 mund të përmendet për një ecuri të kënaqshme të marrëdhënieve me bankat qendrore jo vetëm në rrafshin rajonal, por dhe në atë ndërrajonal, në fushën e bashkëpunimit teknik e trainimeve, të këmbimit të informacionit e thithjes së përvojës më të spikatur. Gjatë këtij viti, janë përfituar trainime nga vendet e G-10, të cilat përbëjnë dhe pjesën më të madhe të donatorëve të Bankës së Shqipërisë si: Banka Federale e Gjermanisë, Banka e Francës, Banka e Anglisë, Banka e Italisë, Banka e Rezervës Federale të Nju Jorkut si dhe nga vende të tjera si: Austria, Zvicra, Turqia, Sllovenia, Çekia dhe nga institutet e trainimit të institucioneve ndërkombëtare: Fondi Monetar Ndërkombëtar, Grupi i Bankës Botërore, Banka e Rregullimeve Ndërkombëtare.

VI.5.5. MARRËDHËNIET ME BANKAT E HUAJA TREGTARE.

Në përputhje me politikën “Mbi mënyrën e administrimit të rezervës valutore” miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës, organit drejtues të Bankës së Shqipërisë, nga Banka e Shqipërisë ndiqet një politikë e kujdeshme në drejtim të përzgjedhjes së bankave partnere, duke vendosur kritere të forta përzgjedhëse për investimin e rezervës valutore. Vendimmarrja dhe miratimi i bankave të reja partnere janë procese që realizohen nëpërmjet Komitetit të Investimit. Kështu, nga Banka e Shqipërisë, në kuadrin e përpjekjeve për diversifikimin e portofolit të investimit të rezervës valutore për vitin 2002, krahas përpjekjeve për shtimin e instrumenteve në të cilat investohet, janë shtuar përpjekjet për zgjerimin e institucioneve partnere, qofshin këto në nivel bankash qendrore apo bankash tregtare.

Përpjekjet për vendosjen e marrëdhënieve e reja janë përqendruar në hapjen e llogarive për tregtimin e letrave me vlerë dhe ruajtjen e tyre, ndërkohë që për mbajtjen e depozitave janë preferuar bankat korrespondente me të cilat kemi pasur marrëdhënie historike.

Në këtë kuadër, preferencat e përzgjedhjes së bankave të reja partnere, ashtu sikurse edhe më parë, duke patur parasysh kthimet nga investimi, sigurinë që ato ofrojnë dhe përshtatshmërinë gjeografike, kanë qenë bankat në Europë dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dhe kryesisht ato me qendër në qytete të rëndësishme të botës financiare si në Berlin, Londër, Zyrih, Milano, Nju Jork. Këto banka janë në krye të listave të renditjes së agjencive të klasifikimit të kreditit.

VI.6. PLANI AFATMESËM I ZHVILLIMIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË.

Në vitin 1999, Banka e Shqipërisë përpunoi dhe bëri publik, për herë të parë, dokumentin e titulluar “Strategjia e zhvillimit të Bankës së Shqipërisë në afatin e mesëm”. Ky dokument u përgatit me qëllim që të përcaktoheshin objektivat afatshkurtër dhe afatmesëm për zhvillimin e Bankës së Shqipërisë; të përcaktoheshin afatet kohore për të realizuar këta objektiva si dhe për të përcaktuar prioritetet në zhvillimin e institucionit. Në përgjithësi, vlerësohet se

Banka e Shqipërisë arriti të përmbushë objektivat afatmesëm të përcaktuar për periudhën 1999-2002. Kjo i ka krijuar bazën për të konsoliduar më tej arritjet e saj dhe për të përcaktuar objektiva edhe më ambiciozë.

Plani i zhvillimit për Bankën e Shqipërisë për periudhën 2003-2005 synon të ofrojë një plan veprimi të harmonizuar për të siguruar përmirësimin e punës në të gjitha drejtimet. Prioritetet më kryesore për këtë institucion në periudhën afatmesme janë:

Përgatitja për regjimin e ri të politikës monetare. Kjo nënkupton forcimin e aftësive analizuuese dhe parashikuuese, të cilat do të ndihmojnë në përcaktimin e objektivave realistë të politikës monetare, në marrjen e vendimeve të duhura dhe në kohën e duhur. Ky aspekt do të mbështetet nga përmirësimi i sistemeve të grumbullimit, të përpunimit dhe të shpërndarjes së të dhënave.

Forcimi dhe zhvillimi i aftësive mbikëqyrëse. Rëndësia e zhvillimit të këtij funksioni rritet në kushtet kur po shtohet numri i operatorëve në treg, po forcohet konkurrenca midis tyre, po rritet roli i sistemit bankar në ekonominë e vendit si dhe po zhvillohen produkte të reja e po zgjerohet aktiviteti.

Rritja e përgjegjshmërisë institucionale dhe e transparencës për aktivitetin e saj. Këto dy elemente do të sigurojnë jo vetëm zbatimin e detyrave ligjore të Bankës së Shqipërisë, por edhe rritjen e cilësisë në zbatimin e këtyre detyrave si dhe do të mbështesin Bankën e Shqipërisë në përpjekjet e saj për të forcuar pavarësinë reale.

Zhvillimi i burimeve njerëzore dhe krijimi i kushteve të përshtatshme të punës. Këto dy elemente vlerësohen të nevojshme për të siguruar përmbushjen e objektivave afatmesëm të përcaktuar në planin e zhvillimit.